Muharrem BLAKAJ

THESARET E HUMBURA

roman

Prishtinë, 2005

Muharrem BLAKAJ

THESARET E HUMBURA

Roman

Prishtinë,
2005

Muharrem BLAKAJ

THESARET E HUMBURA

Roman

Redaktor
Mustafë Xhemaili

Ballina dhe faqosja
Infograph Visual Solutions
www.info-graph.com

Botues
MKRSDÇJ
- Departamenti i Çështjeve Jorezidente i Kosovës
Prishtinë

Copyright 2005
Autori

I

Në qytezën e huaj vazhdonte të binte shi. Ky mot i lig i kishte përcjell gjatë gjithë rrugës. Vende-vende kishte pasur mjegull të dendur që i kishte fshehur konturet e kullave bashkë me frëngjitë e tyre të rrezikshme. Për kullat e shqiptarëve kishte lexuar. Ishte hera e parë që ndodhej përballë tyre. Ndoshta nga moti i lig, kullat i dukeshin edhe më të rrezikshme! Në pamje të jashtme dukeshin të qeta, madhështore dhe krenare, kurse në brendi, prapa frëngjive të errëta sigurisht se fshiheshin tytat e pushkëve.

Makina lëvizte ngadalë duke u tundur, pasi rrotat futeshin nëpër pellgjet e mbushura me ujë. Edhe pse e dinte se edhe kjo qytezë e humbur ishte pjesë e Mbretërisë Serbo Kroate- Sllovene, prapë se prapë, Van Joviq e kishte të vështirë ta emëronte ndryshe, përveçse

e huaj. Pas emërimit të tij në këtë qytezë provinciale, kishte qenë i shtrënguar që të ndiqte një seminar parapërgatitorë në lidhje me vendasit, dhe kulturën e tyre. Gjatë asaj kohe, jo njëherë, kishte dëgjuar se këta njerëz kishin karakteristika të tjera. Veshjet e larmishme, plisat e bardhë, gjuha e tyre që… nuk përngjante me asnjë nga gjuhët e buta e të kapshme evropiane, gjuhë e egër, e vrazhdë dhe e frikshme, disi si gjuhët e demoduara nomade të fiseve mongole, kineze apo dreqi e di se çfarë! Zakonet e tyre, të lidhura me vese e karakteristika të veçanta, jashtë çdo rregulle regjionale që nuk kishin asnjë ngjashmëri me rregulla kodike të popujve të civilizuar. Për mikun, edhe i huaj qoftë ai, mjaftonte të ishte paqësorë, shqiptarët ishin zemërgjerë dhe të sinqertë, kurse për armiqtë e tyre ishin të ashpër e këmbëngulës. Edhe pse jetojnë në bashkësi fisnore, të ndarë në tri religjione, kur të vijë puna për atdheun e tyre, janë gati të shuhen me gjithë çfarë kanë! Zakonet e tyre sikur kanë ngjashmëri me fiset Glenfruine, të cilët ngatërresat ndërmjet tyre i zgjedhin me dyluftim, kurse shqiptarët, ngatërresat në mes tyre i zgjedhin me ligjet e tyre të gjakmarrjes, duke bërë vrasje mizore. Këto parime të trashëguara nga të parët, ata ua mësojnë brezave; gjak për gjak, dhe gjakmarrja vazhdon me vite e decenie. Viktima ruhet me xhelozi deri sa të bije në kurthe, dhe ekzekutohet. Vrasjet bëhen me paramendim e gjakftohtësi të jashtëzakonshme!... prandaj, larg çdo kontakti me ta! Kështu i kishin thënë!

Stili i ndërtimit të shtëpive të tyre prej guri, të tipit ‚kullë' karakterizohet me një lloj fortifikate familjare, që shërben jo vetëm për t'u mbrojtur, por edhe për

‚ngujim' për ata që kishin radhën për të dhënë gjak. Pastaj armët? Edhe pse pushteti i kishte çarmatosur, çdo ditë vriteshin me armë zjarri dhe kapeshin në kontrabandë me to. Thuhej se armët i prodhonin vet duke filluar nga baroti e deri të fishekët. Ishte e pabesueshme por, gjithsesi e rrezikshme.

Misioni i tij nuk kishte karakter luftarak por, thjeshtë hulumtues. Në fillim kishte menduar se duhej të ishte sa më kooperativë me vendasit, me ndihmën e të cilëve do të binte në gjurmët e lashtësisë, por kjo gjë ishte e pamundur. Prandaj, duhej të përdoreshin skicat e punuara më parë nga ekspertët e arkeologjisë. Në ndihmë do t'u vinin një grup njerëzish të besuar që do t'i caktonte naçallniku, si dhe skuadra ushtarësh, të cilët do t'i mbronin nga çdo e papritur.

Thuhej se qeveria kishte bërë shpenzime marramendëse për t'i shpërngulur shqiptarët nga tokat e Serbisë së Vjetër. Kjo taktikë e shpërnguljes së shqiptarëve zinte fill para dy shekujsh, gjatë një marrëveshje sekrete në mes arqipeshkvit Visk Zmajeviqit dhe Venedikut, për t'u zvarritur e shpërndarë më marrëveshje e elaborate tinëzare edhe me shumë shtete të tjera, deri në ditët e sotme. Për pastrimin e këtyre zonave merreshin shumë dijetarë. Po thuaj se të gjithë ishin në një mendje se vetëm terrori, vrasjet, dhuna dhe përzëniet e vazhdueshme do të bënin të mundur pastrimin e tokave serbe nga elementët jo serb. Kishte pasur edhe nga ata dijetarë që kishin preferuar që popullsinë jo sllave ta fusnin në qendër të tokave serbe dhe t'i shpërndanin në mes popullsisë vendase. Kështu do t'i vihej kapak njëherë e përgjithmonë elementit jo sllav në Ballkan. Edhe të huajt, jo që nuk do të kundërshtonin këtë plan-

projekt ambicioz por, ata do të ishin aleatët besnik, dhe do të merrnin pjesë drejtë për së drejti në zbatimin e tij. Kundërshtarët e kësaj ideje ishin kategorik që një gjë e tillë nuk duhej të ndodhte kurrsesi. Ata kishin frikë se kjo metodë do të ishte surrogat, që do ta dëmtonte rëndë pastërtinë e popullit hyjnorë serb.

*

Makina ndalojë para ndërtesës së porsandërtuar të komunës. Van Joviq zbriti i pari. Pas tij zbriti eksperti francez i arkeologjisë, Fransua Roger. Nga dera tjetër e makinës zbriti specialisti i gjeologjisë Dushko Jevtiq i shoqëruar nga eksperti rus i gjeologjisë Sergej Ivanov. Dhe krejt i fundit zbriti, etnografi Dragomir Marjanoviq. Dan Mujani, siç dukej i porositur nga naçallniku lëvizi në drejtim të makinës. Pasi mori një arkë druri u nis drejt hyrjes. Para hyrjes së ndërtesës kishin dalë për t'i pritur veç naçallnikut edhe patriku, komandanti i zonës operative të Metohisë majori Dushan Miqiq, vojvoda Miliq Kërrstiq, si dhe komandanti i xhandarmërisë bashkë me drejtorin e shkollës dhe drejtorin e postës.

Pas përshëndetjeve të rëndomta ata u drejtuan nga dera e hyrjes. Në korridorin e gjerë naçallniku ju dha shenjë mysafirëve të hynin në kantinë. Dera e kantinës ishte e hapur. Pas tyre hyri patriku, pastaj majori, naçallniku e të tjerët me radhë, ashtu siç kishin qenë të radhitur gjatë pritjes. Pasi zunë vend, kantinjeri ju solli pije.

Pasi ju urojë mirë se ardhje, e posaçërisht të huajve, majori në pika të shkurtra dha një raport për gjendjen aktuale në provincë. Me pak fjalë tregoj se

malet ishin mbushur plot kaçak. Ata, herë pas here i sulmonin postat e xhandarmërisë. Ushtria përdorej për ndëshkimin e banditëve dhe për të vënë qetësinë dhe rendin, aty ku plaste sherri në mes të organizatës çetnike "Dora e zezë" dhe kaçakëve. Pastaj, i përsëriti të njëjtat fjalë që me dhjeta herë i kishte dëgjua Van Joviqi: sa më larg kontakteve me vendësit. Janë të rrezikshëm! Lëvizjet t'i kenë të kufizuara. Ju ndalohej dalja jashtë vendbanimeve të kolonëve.

Në pika të shkurtra ai u tregoj të porsa ardhurve se edhe vet, edhe pse ishte ushtarak, merrej me kërkime arkeologjike dhe gjeologjike. Kishte marrë shënime me vlera të çmuara për shumë zona të pasura arkeologjike dhe gjeologjike të pazbuluara më parë, dhe ishte i gatshëm që në këtë drejtim të jepte një kontribut të vlefshëm si në mbrojtjen e këtyre gjetjeve, ashtu edhe në kërkimet që do të pasonin. Të gjitha këto do tua afronte kur do t'i kërkonin zotërinjtë e nderuar, gjithsesi në një fazë të dytë!

Van Joviqi i përshëndeti të pranishmit për pritjen e ngrohët dhe për gatishmërinë e tyre për ta ndihmuar projektin. Pastaj, i falënderojë ekspertët e huaj për ndihmesën që kishin dhënë në përpilimin e skicave planimetrike në degën e arkeologjisë dhe të gjeologjisë. Në pika të shkurtra ai përmendi disa vende ku duhej të fillonin gërmimet.

– Gospodine Joviq, kemi informacione të sakta së gjatë luftërave ballkanike këto anë i ka vizituar një grup arkeologësh, dhe në shumë vende kanë bërë gërmime dhe matje. Se çfarë kanë shënuar ata në defterët e tyre askush nuk e di!... – ndërhyri vojvoda Miliq Kërrstiq.

– E dimë ne! – ia ndërpreu fjalën Van Joviqi, – dhe

pikërisht shënimet e tyre mbi qendra arkeologjike të zbuluara, si dhe një mori gjetjesh të rastit na kanë detyruar të merremi me rishikimin e atyre gjetjeve dhe shënimeve të tyre. Së pari ne duhet të merremi me qendrat arkeologjike që janë sipërfaqësore, t'i bëjmë matjet e nevojshme dhe përpilimin e skicave planimetrike, pastaj të fillojmë nga gërmimet. Edhe për gjetjet arkeologjike të rastit që i kanë lënë të shënuara ekspeditat e huaja, ne duhet t'i bëjmë skicat planimetrike dhe parapërgatitjet e tjera. Si fazë e parë, nevojitën emërtimet topografike të vendeve, qofshin edhe shqip ato, si dhe plotësimi i të dhënave gojore dhe mitike nga vendësit për objektet në fjalë. Unë, kaq kisha! Nëse ka dikush ndonjë pyetje, le të urdhëroj!

Pasi i shikoj me radhë të gjithë të pranishmit, Van Joviqi u ul në karrigen e tij. Ndjehej i lodhur. Sytë ju kishin skuqur nga pagjumësia. Qysh në rini të hershme kishte pasur probleme me gjumin, sidomos kur ndërronte vend. Gjatë gjithë rrugës nuk kishte bërë me tepër se dy orë gjumë, dhe atë, jo gjumë të mirëfilltë por, vetëm dremitje. Nga të pranishmit askush nuk foli. Heshtja kishte filluar të trashej. Van Joviqi e ndjeu se koha ishte e përshtatshme për t'u larguar, sa pa filluar një bisedë e re. U ngrit në këmbë duke i kujtuar edhe të tjerët se biseda kishte marrë fund. Naçallniku disi i lehtësuar e përcolli deri në dhomën e tij. Sergej Ivanov i shoqëruar nga majori dolën jashtë, ndërsa Fransua Roger i shoqëruar nga gjeologu Dushko Jevtiq, të patrazuar vazhduan bisedën.

Me përcjellje të naçallnikut, Van Joviqi u gjend në dhomën e tij. Naçallniku, pasi i urojë ditën e mirë, doli. Pasi u lirua nga pesha e palltos të cilën gjatë gjithë kohës

e kishte mbajtur veshur, Van Joviqi u ul mbi shtrat. Tani çuditërisht e ndjente vetën të lodhur. Akoma i uturinin veshët nga zhurma e hekurt e monotone e motorit të makinës. Qetë, u shtri mbi shtrat. E ndjeu vetën të lodhur, të këputur. Për një çast ju duk e pabesueshme që kishte hyrë në ditën e katërt që nga koha kur ishte larguar nga shtëpia.

Ju bë se pa të shoqen, të frikësuar dhe me sy të përlotur kur e kishte përcjellë në stacionin e trenit me dorën lartë duke e tundur deri sa ishte zhdukur. Assesi nuk kishte mundur t'ia mbushte mendjen, se puna që e kishte marrë përsipër nuk sillte ndonjë rrezik, sepse nuk kishte të bënte fare me kaçakët apo me bandat e tjera që vërtiteshin maleve kundër shtetit. Pamjen kërcënuese të atyre maleve që i kishte kaluar gjatë rrugës ishte përpjekur ta zbuste sado pak me krenarinë e detyrës së tij. Kurse kullat që i gjeti në këtë provincë të humbur ju dukën të frikshme dhe kërcënuese. Mirëpo prania e majorit, e naçallnikut, e komandantit të xhandarmërisë, e vojvodës, rojet në çdo skaj të qytezës sikur e kishin qetësuar pak. Pastaj ju kujtua takimi i fundit që kishte pasur me ministrin e kulturës dhe me njërin nga këshilltarët e tij. Takimin me punëtorët e konsullatave të huaja të akredituara në Mitrovicë. Bisedat dhe përpilimi i skicave planimetrike paraprake, si dhe ndihma e pakursyer, sidomos e konsullit francez dhe atij rus të cilët kishin përgatitur edhe ekspert që do të merrnin pjesë gjatë ekspeditës së tij në rrafshin e Dukagjinit e veçanërisht në Podgur. Ju sollën nëpër mend copa bisedash për gërmime, emra vendesh, harta topografike, skica, themele të vjetra kalash, manastiresh e kishash, pastaj veshjet karakteristike të

shqiptarëve me larmi ngjyrash, e në fund edhe këngët e tyre të çuditshme!...

*

Zilja e telefonit binte me ngulmë. E pikëlluar e mori dëgjuesen, duke shpresuar se kësaj radhe do të dëgjonte një lajm që do ta bënte të gëzuar bile për orët e pasdites që nuk i kalonte dot. Si gjithnjë, edhe kësaj radhe nga dëgjuesja erdhi zëri i mërzitshëm e zhgënjyes i të shoqit. Fjalët e tij tani më i dinte përmendësh, si je, çfarë bën, çfarë kemi andej, me përgatit sot për drekë këtë apo atë lloj ushqimi, përgatite rakinë dhe mezet se do të vij me këtë apo me atë... dhe asgjë e jashtëzakonshme. Vetëm kah fundi i bisedës ai e njoftonte se sot sa kishin arritur pesë ekspert. Tre vendas, dhe dy të huaj. Njëri është francezë kurse tjetri rus.

– Ekspert? Çfarë kërkojnë ata këtu?... – pëshpëriti e hutuar si të ishte duke folur vet me vete. Nuk u përmbajt dot, dhe pyeti për të dytën herë? – Ekspert the?

– Po, po ekspert thash! – u dëgjua zëri nervozë i të shoqit nga ana tjetër e telefonit. – Pse çuditësh?

– Sa mirë! – tha më në fund pa e përmbajtur vetën dhe vazhdoj: – të ne do të vijnë ata?

– Jo te ne! Ç'do të kërkojnë ata të ne?... ata do të bëjnë gërmime arkeologjike, dhe kërkime gjeologjike në mbarë krahinën!

– Ashtu!?... – bëri si me vete, krejt e hutuar nga lajmi. I shoqi foli edhe diçka tjetër por ajo as që e dëgjoi. Ishte e tretur në mendimet e saj fantastike. Sa herë që dëgjonte ndonjë lajm interesant, për një kohë të gjatë humbte nën peshën e kujtimeve të ëmbla... dhe krejt si

papritur dëgjoj zërin e të shoqit kur i uroj ditën e mirë! Nga dëgjuesja e telefonit u dëgjua toni i ndërprerë i sinjalit: tit-tit-tit...

Edhe këtë mëngjes, Mila ishte zgjuar nga gjumi e pikëlluar. Pikat e shiut vazhdonin ritmin e njëjtë sikurse edhe ditëve të tjera. Jashtë asgjë nuk kishte ndryshuar. Pjeshkat në kopsht me gjethe të rëna, lulishtja e tharë krejt në fundin e oborrit, pjergulla e zhveshur si dhe dritëhijet e përhirta të kullave matanë lumit, dukeshin të ftohta akull, e të frikshme, sikur i ndillnin kob. O zot, ja edhe sot një ditë e tmerrshme, kishte menduar me dëshpërim duke e larguar vështrimin nga dritarja.

– Sa mirë! – pëshpëriti me vete Mila, – pesë ekspert! Njëri është francez, me tha! Do të bëjnë gërmime! Ah, si nuk e pyeta se ku do t'i bëjnë ato gërmime? Pastaj pse duhet të gërmojnë? Ani, s'ka gjë. Do ta pyes pastaj!

Para se të martohej kishte qenë e dashuruar marrëzisht pas Dushanit. E kishte njohur gjatë një ekspedite ushtarake ku kishte qëndruar për disa ditë në shtëpinë e saj! Pas martesës kishin vendosur që muajin e mjaltit ta kalonin në brigjet e bukura të bregdetit dalmat. Sa shpejt kishte kaluar ai muaj. Kishte qenë muaji më i shkurtër dhe më i bukur në jetën e saj. Ah, të kisha pasur mundësi që këtë muaj ta shndërroja në një vit të mjaltit dhe të kënaqesha për një kohë të gjatë në hotelet luksoze, më mbrëmje vallëzimi, e me plot muzikë. Por ja që edhe ai muaj kishte kaluar pa u ndje duke lënë prapa vetëm kujtime të këndshme.

Pasi ishin kthyer në kryeqytet, në kutinë e postës kishin gjetur fletemërimin e tij në një provincë të humbur diku në Kosovë, që as emrin nuk ia kishte dëgjuar ndonjëherë. Fill pas leximit të njoftimit,

Dushani kishte marrë hartën e "perandorisë" siç i pëlqente ta quante Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene, dhe duke e lëvizur gishtin mbi të e kishte gjetur vendin ku e kishin emëruar. Nga ky sihariq ai ndjehej krenar. Vetëm oficerët e zotë i dërgojnë atje, kurse ata që janë të dobët i mbajnë afër sepse këtu nuk ka hajdut, as kaçak, ndaj nuk ka karrierë, nuk ka as lavdi! Mila e kishte ndjerë mbi shpatulla zhgënjimin e parë pas muajit të mjaltit. Asnjëherë nuk kishte pasur dëshirë të largohej nga kryeqyteti. E zbritur nga një fshat malor, vetëm sa kishte filluar ta thithte nektarin plot luks të kryeqytetit. Gjatë muajit të mjaltit kishte arritur që të mësohej me sjelljet e shoqërisë moderne. Assesi nuk kishte dëshiruar të shkëputej nga ai mondanitet, edhe pse Dushi i saj e kishte bindur se në provincë ku e kishin emëruar, nuk do të qëndronin gjatë, dhe prapë do t'i ktheheshin luksit dhe jetës mondane. Pas arritjes në provincë i kishin vendosur në një kullë dy katëshe me frëngji të një kaçaku. Kishte pasuar zhgënjimi i dytë por, tani ky zhgënjim ishte i mbështjellë me një frikë tinëzare nga kaçaku, që në gjuhën e saj ishte hajduti i tmerrshëm, që zbret natën nga malet dhe, si hije e zezë nate, futët në shtëpinë-kullë dhe dashurohet marrëzisht në tiparet e saj dhe pastaj, pason vrasja e Dushit dhe rrëmbimi i saj… bërr ishte rrëqethur tërë frikë, dhe në memorien e saj e kishte skicuar një burrë kaçak flokëgjatë, i veshur me tirq e xhamadan, shokë shumëngjyrëshe, ku i vareshin jatagani dhe koburja… disi në pamjen e Dan Mujanit por më i bukur, më i fuqishëm!... O Zot, si në legjendë!... Zhgënjimi tjetër kishte ndodhur shpejt dhe shumë më tragjik për zemrën e saj, por tani i mbështjellë jo si më parë me frikë nga kaçaku, por me

dhembje shpirti. Kishte qenë e stepur kur në shtratin bashkëshortor të rregulluar bukur e kishte gjetur Dushin e saj lakuriq duke bërë dashuri me shërbyesen e tyre, vajzën e një koloni serb. Kohë të gjatë pas këtij skandali, ajo kishte pasur depresion psikik. Një kohë të gjatë shërbyesja nuk ishte dukur. Pastaj, porsa kishte filluar të këndellej pak dhe t'i afrohej prapë Dushit të saj, pas kërkim falje dhe miklimit të pambarim me fjalë të mëdha të dashurisë, kishte ndodhur skandali tjetër sikurse i pari por, kësaj radhe me gruan e re e të bukur të drejtorit të postës.

Kupa ishte mbushur. Kishte vendosur të hakmerrej kundër tij. Në shumë raste kishte pasur kërkesa nga burra të pashëm dhe me pozitë. Kishte pasur kërkesa nga ushtarë të ri dhe të bukur që vetëm shikimet e zjarrta të tyre e kishin bërë të mbushej me epsh. Por qe do, ju kishte larguar të gjithëve në mënyrë të prerë duke mos lënë asnjë shteg për një provë të dytë. Pavarësisht nga kjo, e ndjente se shumë prej tyre vazhdonin ta lakmonin. Ndaj, gjatë netëve të gjata të festave shtetërore, Mila, ndonjërit me qëllim ia hidhte ndonjë vështrim të prushtë dhe pastaj tërhiqej duke e lënë tjetrin të shastisur pas saj. Kurse sot? Ja një ditë që të bënë të mendosh. Një ditë që të jap shpresë dhe zemër bashkë, dhe në çast, në trurin e saj e skicoj vetën duke u afruar drejt shtratit me pelerinën hedhur krahëve, që pa dashur i zbuloheshin flladitshem kofshët e saj të plota e të bardha, kurse ai me pamjen e Dan Mujanit, e shikonte plot epsh!... Cili është ai vallë? Pyeti vetën, dhe si në rastësi pa vetën lakuriq pranë dushit që assesi nuk i kujtohej se kur dhe si kishte arritur deri aty. Më këtë mendim nuk u zgjat shumë, sepse nuk dëshironte

t'ia largonte vetës ato mendime që e bënin të lumtur në këtë ditë të mugët shiu, e plot trishtim.

Duke e fërkuar trupin me sapun, ju kujtua doktori që e kishte kontrolluar kur kishte qenë e ftohur. Kishte pasur një kollë të rëndë dhe të gjatë sa për një kohë kishte menduar se e kishte kafshuar sëmundja e rëndë e tuberkulozit. Mendjen e kishte top, se vetëm ajo sëmundje vinte në këtë mënyrë dhe, pas pesë apo gjashtë muajve çdo gjë do të mbaronte. Ja kështu, deri këtu e kishte pasur jeta e saj! Pastaj do të vdiste dhe... o zot! Ofshani! Deri sa doktori i kishte bërë të gjitha analizat dhe ia kishte kumtuar lajmin e gëzuar se nuk ishte e infektuar por vetëm e ftohur keq, ajo kishte pësuar shumë. Kishte humbur në peshë, sytë ju kishin futur thellë në kocka. Ju kishte larguar oreksi. Dushi nuk largohej assesi nga puna. Ikte në mëngjes dhe kthehej vonë në mbrëmje, apo nuk kthehej fare për disa ditë me radhë, pa e qarë fare kokën për sëmundjen e saj! Nga ilaçet që ia kishte caktuar doktori, kishte filluar ngadalë të këndellej. Kur kishte ardhur koha të shkonte për vizitën e dytë, kishte ndryshuar krejt. Doktorit i kishin mbetur sytë si dy thëngjij të ndezur, të ngulitur në fytyrën e saj të freskët dhe të bukur. Pastaj i kishte thënë të zhvishej. E kishte pikasur se ai e shikonte me zjarr, dhe për pak sa nuk ju kishte lëshuar në dorë e le të bënte ai ç'të donte me trupin e saj tani më lakuriq. Por, në momentet e fundit kishte ndërruar mendje. Nuk i pëlqente aspak fytyra mbrehuce e tij, me atë hundë të gjatë dhe me syzet në majën e saj që e bënin edhe më të çoroditur dhe… më mirë të pres një rast tjetër! Pastaj, disi me naze ju kishte larguar doktorit, dhe pa lejen e tij kishte filluar të vishej.

Doli nga dushi dhe u mbështoll me peshqir. Qetë ju afrua pasqyrës dhe, për një copë herë mbeti duke vështruar me ngulmë fytyrën e vet të freskët. Tani, pas lajmit të këndshëm që ia kishte kumtuar i shoqi, fytyra ju duke edhe më e ferskët se nga hera. Mori të kuqtë dhe filloj t'i lyente buzët, pastaj vuri rimelin e kaltër rrotull syve dhe krejt në fund, i leu faqet me kremin e bardhë të markës „Francuska." Një copë herë ndenji pran dollapit duke kërkuar se cili fustan do t'i përshtatej kësaj dite të trisht, e me plot mistere. Vallë a ka ndonjë fustan që do t'ju shkonte për shtat mistereve? Pyeti vetën. Pasi u vesh, i krehu flokët butësisht duke i lidhur valëvitshëm me një fjongo ngjyrë kafeje. Veshi pallton dhe doli. Cak ishte gruaja e komandantit të xhandarmërisë, të cilës do t'ia jepte të parës sihariqin për ardhjen e ekspertëve.

II

Fërfëllaza i përplasi furishëm pikat e shiut mbi xham. Kekë Ymeri ktheu kokën prituesshëm. Pa nga xhami që ishte mbuluar me avull, dhe prapë u kthye nga pasqyra e varur në mur. Pa hetueshëm fytyrën e vet. Ju duk edhe më brengosëse. Veshi pallton qejfprishur dhe filloj t'i mbërthente kopsat njërën pas tjetrës. Në fund, me të dy duart ngriti jakën duke e ngjeshur pëlqyeshëm pas shallit. Pas kaq shumë muajsh që kishte ardhur nga qyteti ku kishte përfunduar gjimnazin, ishte hera e parë që dilte nga shtëpia me një brengë të madhe në shpirt. Krenaria për të vetmin shkollar të këtyre anëve ju kishte fashitur me kohë. As veshja allafrënga, që dikur e kishte bërë të dukej i lehtë si pendël, sot nuk i bënte ndonjë përshtypje, bile përkundrazi e kishte brengosur edhe më keq. Po të kishte mundësi ta ndërronte me dikë tjetër shkollimin dhe veshjen e tij allafrënga, në

këto momente krize, do ta kishte bërë me gjithë dëshirë por, ishte gjë e pamundur.

Mugëtira e atij mëngjesi pranveror ju duk e pazakontë, e rëndë dhe e mërzitshme. Era e përzier me borë ju përplas ftohtësisht në fytyrë. Ishte një dimër i zgjatur dhe i rëndë, disi dimër gënjeshtarë. Sa dukej se do të bënte mot i mirë e me diell, zogjtë të gëzuar fillonin të këndonin, pa pritur ia fillonte erë e fortë e përzier me borë e me sqotë, sa që, dukej se koha ecte prapa duke u futur në ditët e acarta të janarit. Ja, edhe sot një ditë e tillë e mistershme dhe e ftohët, dhe me ngjarje të ngatërruara! Me kujdes filloj t'i hidhte hapat mbi pellgjet me ujë që ishin ngrirë krejt. Gjatë gjithë rrugës, deri të kulla e Jashar efendiut nuk takoj njeri. Kur Jashar efendiu po kthehej nga xhamia, që po sa e kishte falë sabahun, aty të bërryli i rrugës, vetëm sa nuk u përplas fytyrë për fytyre me të. Phu, i paudhë, m'i shtinë ethët në bark, kishte shfryer ai duke kërcyer i trembur në anën tjetër.

Në at motin e rëndë, kur baba mbret ishte larguar me gjithë ushtri dhe në vendin e tyre kishte ardhur ushtria serbe e malazeze, Jashar efendiu kishte marrë shumë reforma të reja në zbatimin e kuranit të Allahut. Njerëzit ishin penduar rëndë që nuk ishin kënaqur duke u falur e duke ju lutur allahut që t'u vinte në ndihmë sa e kishin pasur pranë hijen e babës mbret. Kishin gabuar! Ja tani shkau! Allahu ju ka mallkuar edepsëzë, i thoshte Jashar efendiu xhematit të tij! Kurse ky i paudhi shkon edhe në shkollat e tyre! Phu, edepsëzi! Jazëk! Edhe katundarët kishin mbajtur anën e Jashar efendiut. Pa dyshim kishte edhe prej atyre që e adhuronin fshehurazi Kekë Ymerin. Por, kishte edhe nga ata që ia kishin nevojën,

dhe porsa binte terri, fshehurazi i trokisnin në derë. Këndoma këtë letër që ma dërgoj djali nga ushtria! Jashar efendiu nuk dëshiron t'i këndojë shkrolat e kaurit. Disa i kishin thënë që të hiqte dorë sa më parë nga ato libra të mallkuara e të kthehej në udhën e zotit. Të merrej me Kuranin e Allahut. Të kthehej në xhami e mos të merrej me ato shkarravina të sllavit! Dhe se voni, nga Jashar efendiu kishte ardhur edhe një sihariq tjetër. Keni dëgjuar moj loke, kishin thënë plakat! Vakt i keq ka ardhur! Ku ka bërë vaki që gratë malësore të mbulohen me ferexhe? Hoxha ka thënë moj! Jazëk i qoftë edhe atij, është trenuar në pleqëri! Po ku ke parë moj, ku ke parë? Të prishen veshjet malësore me ato beze të zeza e të dukemi si sorra? Mos, o Zot më keq! Vakt i vështirë ka ardhur!... Unë nuk i veshi ato beze të zezë për të gjallë. Me këtë veshjen time dua të vdes. Gjynahet me mbesin mua. Zoti e marroftë Cenë Drenin që i pari e futi gruan e tij nën atë çarçaf të zi. Kur kalon rrugës duket si kallukanxhë e shkreta… Pfu, Pfu, pfu larg meje! Edhe Deli Turileshin e marroftë zoti, ia fshehu bukurinë Dinorës! Dikur, kur shkonte të Gurra e Sofjes me testi në dorë, rrezatonte dritë nga bukuria, kurse sot? Zi!...

Që larg dalloj oxhakun e ndërtesës së re të komunës. Ai tymonte. Tymi përzihej me erë e pjalm bore, e pastaj zhdukej tutje. Këmbët edhe pse me përtesë, vet e shpinin drejt asaj ndërtese që sa më shumë i afrohej, aq më e mistershme dhe e frikshme i dukej.

Pa dashur ju kujtuan të lehurat e qenve gjatë natës. Llava ujqish kishin mbushur malet dhe katundet si kurrë më parë. Ata endeshin duke ulërirë sa në një katund në tjetrin. Sulmonin tufat e deleve, suleshin

turravrap përgjatë Drinit dhe futeshin në qytet. Gjatë gjithë vjeshtës kishin shpërthyer tufa thish të egjër, të cilët si një ushtri barbare gjatë natës sulmonin arat me misër. Thonin se Tahir Rama ishte bërë mburojë e gjallë e arave, duke u kacafytur me egërsirat. Pleqtë thonin se kiameti nuk ishte larg. Në mos kiameti, luftën e kemi në prag, kishin thënë disa të tjerë.

Kur po kalonte pran hanit të Babit, pa nga jashtë se në brendi kishte pak njerëz. Koha e ftohët dhe dëshira për llafe i ndillte të tuboheshin aty. I ndillte edhe Babi, pronari i porsa kthyer. Më parë hanin ia kishte konfiskuar hyqymeti për shkak të Misin kapedanit, dhe ia kishin dhuruar Radulit, kolon serb. Babin e kishin përzënë. Ishte sorollatur poshtë e lartë nëpër Stamboll pa mundur të gjente strehë. Duke mos gjetur derman, befas një ditë ishte dukur në katund. E kishin vendosur në një të ndarë të mejtepit dhe për çudinë e të gjithëve, e kishin lejuar të punonte si më parë në hanin e tij, por tani bashkë me Radulin.

Bjeshkët e Nemuna ishin mbushur plot kaçak. Të veshur në tirq me gajtanë, xhamadan e japanxhe, të armatosur me mauzerë e kobure, bridhnin sa në një mal në tjetrin duke i përcjellë ushtritë serbe që lëviznin ngadalë me armatime të lehta e topa malor, nën komandën e majorit Dushan Miqiq. Andej nga Rugova bridhte pa pra Kera me malësor. Në malet e Podgurit endej Misin kapedani, Bardhi i Jusufit, Naku i Përkiqit e shumë të tjerë. Bajraktari i Podgurit, i porsa liruar nga burgu, me Jashar efendiun e me kryeplakun, nuk ishin përzier as me kaçakët e as me pushtetin. Ata thoshin se ishin njerëz të zgjedhur dhe duhej që njërën dorë ta mbajnë në milet e tjetrën në pushtet. Flitej

gjithandej, se naçallniku i ri nuk e kishte ndërmend me hy në luftë me kaçakët. Kishte qitë kushte pajtimi. Edhe çetnikët e tyre të veshur komitë i kishte pajtuar. Ju kishte thënë se, askush nuk do të guxonte të zbrazte pushkë kundër kaçakëve që bridhnin nëpër male. Vojvodë Miliqi bashkë me shokët e tij, i zhgënjyer me urdhëratë e Naçallnikut, kishte sulmuar kullat e kaçakëve. Kishte vrarë gra e fëmijë, ua kishte djegur shtëpitë dhe… për t'i larguar sherret, kishte ndërhyrë ushtria për të vënë drejtësinë në vend. Ata që i kishin shpëtuar vdekjes nga sulmet e çetnikëve, nuk i kishin shpëtuar dot internimit nga ushtarët e majorit Dushan Miqiq. I kishin shpallur fajtor dhe i kishin dërguar në burgun e Nishit. Të vrarit e të masakruarit, përveç vajtojcave, i kishte vajtuar edhe Ukë Xhemalbashi. Ai kishte thënë se s'ka sevap më të madh në këtë dynja e në ahiret se me i vajtu dëshmorët. Pastaj, pasi i vendosnin kufomat mbi tabut, me ta merrej Jashar efendiu i cili duke ju këndduar sure nga Kurani i përcillte deri në varr. Thoshin se Naçallniku e kishte zbutur edhe vojvodë Miliq Kërrstiqin, i cili e mbante pranë vetës Selman Kadrinë. Donte që i gjithë mileti të jetë dëshmitar se ishte penduar për të gjitha të këqijat që ua kishte bërë, dhe kërkonte pajtim me shqiptarët!... inshalla, inshalla, kishin thënë shumë burra me dyshim.

Fjala kishte marrë dhen, kur një natë të errët vjeshte, si hije të zeza nate ishin parë dy veta të veshur me japanxhe të zeza e të gjata, me kapolet të vëna në kokë që nuk ju shihej fytyra. Ata kishin shtegtuar nga një katund në tjetrin. Sa ishin parë, si hije nate ishin zhdukur, edhe një të premte, kur sekti i rufainjve kishte dhënë një shfaqje ngjethëse pran teqesë së madhe, ku

dervish të rreckosur e nën tringëllimën e teneqeve dhe dam-dumeve të daulleve ishin shpuar me biza e gjilpëra. Ishin njoftuar xhandarët. Edhe kaçakëve ju kishte shkuar fjala. Kishin vënë njerëz në ndjekjen dhe zbulimin e tyre por, nuk kishte qenë e mundur. Ata sa shfaqeshin në një katund e sa në tjetrin e pastaj, si hije nate zhdukeshin. Ishin parë pranë varreve të vjetra, pranë rrasës së mermerit, ku edhe kishin gërmuar. Çfarë kërkonin aty vallë!? Thuhej se me të aguar të ditëve të kthjellëta, disa herë ishin parë nga barinjtë duke bërë matje rrëzë Shkëmbit të Kuq. Kishin bërë edhe disa gërmime ku kishin mbetur disa gropa të hapura. Askush nuk dinte saktësisht se kush ishin dhe çfarë kërkonin në këto anë. Thuhej se ishin dervish tebdil nën urdhrin e Sheh Rexhepit, që bredhin sa në një katund në tjetrin, duke shpërndarë magji kundër atyre që nuk i besonin fjalës dhe fuqisë së Shehut të tyre çudibërës. Kurse disa të tjerë kishin thënë se ishin njerëz të shenjtë që kishin zbritur nga Allahu për t'u treguar njerëzimit se kiameti nuk ishte larg. Keni kujdes e mos i ngini, kishte thënë Jashar efendiu një ditë kur xhemati kishte falur xhumanë. Ata janë njerëz të mbërrimë, të porositur nga Hasreti Muhameti! Mjerë ai që i lëndon me fjalë të këqija, apo i përgjon në udhën e tyre të shenjët! Allah, në dorën tënde jarabi! Amin!

Me t'u parë xhubletëzinjtë ishte përhapur fjala se më në fund kishin dalë në skenë banditët, të cilët kishin bërë një krim të padëgjuar në këto anë, kur njerëz të panjohur kishin bërë hapjen e varrezave të freskëta serbe dhe zhdukjen e kufomave. Pas dy ditë kërkimesh, ushtria i kishte gjetur kufomat e masakruara buzë lumi. Trishtuese, dhe tepër e dhembshme kishte qenë se në

mesin e kufomave të çvarrosura ishin gjetur të vrarë e të masakruar edhe katër anëtarë të familjes Galiç. Miomiri i vrarë me armë zjarri, pastaj i masakruar. Nëna e tij plakë e masakruar me thikë. Nusja e tij me të birin e vetëm në gji, që kishte qenë me të meta fizike po ashtu, të coptuar. Thuhej se Miomiri kishte qenë një bujk i mirë që kishte jetuar në tokat e tij të trashëguara nga të parët. Ai nuk i kishte bërë askujt ndonjë të keqe që të pësonte në atë mënyrë. Pastaj kishin shkruar gazetat dhe fajet ua kishin hedhur kaçakëve që bridhnin maleve. Ishin organizuar ekspedita ushtarake për t'i zënë dhe për t'u hakmarrë kundër tyre. Kaçakët, këto të pabëra i kishin hedhë poshtë me përbuzje. Ne nuk luftojmë kundër grave e fëmijëve por, i mbrojmë familjet tona nga xhandarët dhe ushtarët serb, ishin deklaruar ata përmes një komunikate. Pastaj, patriku në shenjë pabesie e tradhtie i kishte larguar nga puna rojet tradicionale shqiptare, që brez pas brezi e kishin ruajtur me besnikëri Manastirin. Njëri nga rojet, që atë natë tmerri kishte qenë në detyrë, kishte deklaruar se gjatë natës në Manastir ishte parë të futej Miomiri me fëmijën e sëmurë. Pastaj kishte dalë i vetmuar dhe pas pak ishte kthyer me të shoqen. Ajo ishte futur në Manastir duke qarë me kuje. Kishte dëgjuar të shtëna, brenda mureve të Manastirit. Vonë, pas mesit të natës, Patriku i kishte thënë të shkonte në shtëpi. Se çfarë kishte ndodhur atë natë të errët, me shi e vetëtima, brenda mureve të Manastirit nuk dihej. Por, dihej se brenda javes, të gjitha rojet shqiptare të Manastirit, ishin gjetur të vrarë!

Dy të bijtë e Dautit Shaipi e Naipi, edhe këtë dimër e kishin kaluar të fshehur diku në një shpellë sekrete

në bjeshkët e Podgurit. Thuhej se ata, nuk e ndjenin vetën fajtor, prandaj nuk donin t'i paguanin gjobat që i kishte paditur në gjyq rojtari i malit. Ngulnin këmbë se drutë i kishin prerë në zabelet e tyre. Rrinin të pa armatosur dhe nuk përziheshin me kaçakët. Thuhej se ishin të shkathtë si dhitë e egra. Ngjiteshin nga shkëmbi në shkëmb, dhe xhandarët nuk i kapnin dot. Duke u endur nga mali në mal, kishin zbuluar shumë shpella ku për shkaqe të erozionit grykat e tyre ishin mbyllur me kohë. Pasi i gërmonin dhe i hapnin hyrjet, me urët e ndezura pishe futeshin në brendi duke nxjerrë gjëra të moçme. Gjatë dimrit i përgatisnin pykat dru bredhi dhe gozhdët katërkëndëshe e dredhore të punuara të farkëtari, që kur të vinte vera, të futeshin në ndonjë shpellë tjetër. Verën e kaluar ata ishin parë të futeshin në shpellën e Hutit. Nuk dihej se çfarë kishin nxjerrë që andej. Thuhej se Van Joviqi i kishte garantuar se nuk do t'i ndëshkonte askush nëse ata do t'i sillnin gjërat e gjetura, bile edhe do të shpërbleheshin. Edhe francezi ju kishte garantuar pafajësinë, dhe i kishte shpërblyer në punën e tyre. Akoma nuk ishte marrë vesh se çfarë përgjigje kishin dhënë ata.

Në kohën e Austrisë, kur ushtrija serbe kishte qenë e detyruar të largohej nga këto anë, kishin ndodhur disa gërmime interesante. Në shumë vende kishin gërmuar duke nxjerrë në sipërfaqe mure kalash të vjetra. Kishin gërmuar edhe rrëzë mureve të një kishe të vjetër, pastaj i kishin hapur disa varreza. Njerëzit kishin qenë të irrituar nga këto gërmime. Nuk ka ndodhur ndër ne që të hapen varret e vjetra. Ata kishin bërë matje duke përsëritur gjithë ditën numra e shifra me gjuhën e tyre të shkurtër dhe me "c" – et e bollshme, "zweihundert

zweiundzwanzig und zehn meter!...” Kur kishin ikur ata, të gjithë kishin thënë se shënimet e gërmimeve i kishin lënë të fshehura në një të ndarë të kullës se kryeplakut.

Me t’u dhënë lajmi se po kthehej ushtria serbe, Misin Kapedani nga gratë dhe fëmijët ishte ndarë aty buzëmbrëmjes në oborrin e madh të kullës, pa lot e pa të qara. Kush të dojë, le të qajë pastaj kishte thënë ai i mërzitur. Kur kishin kaluar pran kullës së kryeplakut, ishin ndalur për ta ftuar edhe atë në luftë kundër ushtrisë serbe që po avitej. Misin Kapedani kishte trokitur fort në derën e tij. Ai kishte dalë me dyshim e frikë bashkë. Ishte tmerruar kur i kishte parë të armatosur. Ku dreqin po e thyeni qafën? Kishte thirr gjithë frikë. Jam ngopë me luftëra e me gjak! Nuk dua më luftë. Jeni qu peshë para taksirati… Në luftë po shkojmë, a po e sheh se po vijnë ushtritë serbe! ia kishte prerë fjalët Misin Kapedani. Nuk vi kurrë mbas jush! Qafen e thefshi! Atëherë bjeri armët… edhe municionin! Nuk ua jap asnjë kokërr!... Misin kapedani e kishte nxjerrë alltinë dhe ia kishte rrasë në fyt. I verdhë dyllë, nga frika ua kishte dhënë krejt çka kishte pasur. Mos ua mbërrittë ymri me u kthye të gjallë jarabi o zot! Kishte murmuritë kryeplaku i molisur dhe, duke ju dridhur këmbët nga frika, ishte ulur mbi një gurë buzë rruge. Pastaj, si me vete ishte dëgjuar të thoshte: Keni me ma pa sherrin qe besa! Se kush ia kishte futur në tru Naçallnikut nuk dihej por, dihej se marrja e armëve të kryeplaku, ishte thënë gabim: „marrja e shënimeve të arkivuara.” Kërkesa e parë dhe e fundit e Naçallnikut kishte qenë: shënimet e arkivuara i dua nga Misin Kapedani, edhe pse e dinte se në kullën e kryeplakut nuk kishte pasur

kurrfarë shënimeve, përveç armëve dhe municionit që vet e kishte fshehur dikur nga ushtarët austriakë! Pasi nuk ju kishte përgjigjur thirrjes, Naçallniku ia kishte syrgjynosur vëllain, nënën plakë dhe gruan me fëmijë! Thuhej se një kohë të gjatë i kishte mbajtur të mbyllur në burgun e Nishit, pastaj, kur i kishte liruar, i kishte përzënë matanë kufirit!

Dan Mujani, korrieri i katundit që të gjithë e quanin „polic" befas një ditë kishte hapur lajmin se me makina të ngarkuara rëndë, kishin ardhur pesë ekspertë me arka e hallate. Në mesin e tyre një rus dhe një francez. Ai kishte thënë se ata kishin ardhur për gërmime, tamam si në kohën e Austrisë por, në dallim prej tyre këta me vete kishin sjellë edhe disa qyngje hekuri. Që kurë ndodhej në atë detyrë, naçallniku i kishte dhënë pushkë që ta mbronte vetën, bashkë me letrat e lajmet që ia sillte. Kur kalonte shtigjet e gjerdheve, hidhej lehtas duke thirr: „hop he polic!" Ai kishte bërë be se ekspertët mund të kenë ardhur për çfarëdo pune tjetër por vetëm për gërmime jo! I njeh mirë baca ata të gërmimeve. Ata me vete sjellin disa arka me karta, qysqi, kazma, lopata fshesa e brusha! Pastaj, punët i fillojnë me beharin e parë!... Po qyngjet? Ç'ju duhen qyngjet pra? Allah, Allah!

Me këto mendime, me sy të trishtuar Kekë Ymeri vuri këmbën në shkallën e parë të ndërtesës. Shkallët kishin zënë një shtresë të hollë akulli. Me kujdes filloj t'i ngjiste njërën pas tjetrës. Ishte hera e parë që shkelte në këtë ndërtesë. Korridoret ju dukën të gjëra dhe të lëmuara që shkëlqenin në atë pak dritë që depërtonte nga jashtë. Për një çast mbeti në mes të korridorit pa ditur se në cilën derë duhej të trokiste. Tamam në

kohën kur bëhej gati të trokiste nga krahu i djathtë u hap një derë dhe, që andej bashkë me dritën që e mbushi korridorin doli një burrë.

– Paskeni ardhur? – pyeti ai dhe u nis drejt tij. – Keni pritur gjatë gospodine Keko?

– Jo, tani sa erdha! – u përgjigj Kekë Ymeri i çuditur. – Erdha për ftesën që më keni bërë… të paraqitem… – vazhdoj Kekë Ymeri duke e ndjekur pas zyrtarin dhe duke e nxjerrë letrën nga xhepi.

Pa e kuptuar as vet, e pa vetën në një zyre të gjerë. Përballë ishte një tryezë e madhe dhe pas saj pa një burrë ulur me shikimin e hedhur mbi letra. Ai nuk e shikoi fare. Vetëm kur dëgjoi derën të mbyllej ngriti kokën prituesheëm duke hedhur një shikim të rreptë dhe pastaj, uli prapë kokën duke mbërthyer shikimin mbi letrat që i kishte mbi tavolinë. Me një vështrim të shpejt Kekë Ymeri përlau këndet e zyrës, duke e ndalë vështrimin në mesin e zyrës, ku ishte tangari i mbushur me prush. Mbi prush, pa një kusi të vogël që ziente. Letrën që akoma e mbante në dorë, ia mori zyrtari që e kishte përcjellë deri aty. Me një lëvizje, që Kekë Ymerit ju duk si lëvizje e një të çali, ia hodhi letrën përpara zyrtarit që vazhdonte të lexonte i pa trazuar. Ai vuri dorën mbi letër por nuk e tërhoqi, përkundrazi dora e tij mbeti e shtrirë mbi të. Pastaj ngriti sytë dhe shikoi në drejtim të tij.

Zyrtari që e përcolli Kekë Ymerin doli. Tani kishte mbetur vetëm për vetëm me naçallnikun. Fill, pasi u mbyll dera, naçallniku u ngrit në këmbë. Letrën nuk e mori me vete edhe pse një copë herë e kishte mbajtur dorën të shtrirë mbi të, sikur e kishte ruajtur se mos ia merrte era. Ku ka erë këtu? pyeti vetën Kekë Ymeri.

Naçallniku lëvizi ngadalë drejt tij duke e shikuar ngultas në sy. Kekë Ymeri e ndjeu peshën e atij shikimi, dhe për një çast ju duk i papërballueshëm, por megjithatë vazhdoj t'i qëndronte. Tamam në kohën kur ishte duke menduar se nuk e përballon dot, naçallniku e theu vështrimin duke e hedhur drejt tangarit me prush. Nuk i kujtohej t'i ketë ndodhur ndonjëherë në jetën e tij të kishte pasur vështrim kaq të gjatë me një zyrtarë, e aq më tepër me një naçallnik. Kot jam frikësuar, mendoj me vete, i trimëruar.

– Ju keni ardhur... – foli Naçallniku por nuk vazhdoj më tutje. Pastaj ngriti kokën ngadalë duke ia mbërthyer sytë me vështrim të rëndë dhe tinëzar. Pa e tërhequr vështrimin, u tërhoq vet mbrapsht deri të vendi i tij. Dorën e majtë e vuri mbi mbështetësen e karriges dhe në vend që ta vazhdonte shikimin me ngulmë, gjë që Kekë Ymeri e priste, ai vështrimin e hodhi mbi prushin plak që kishte filluar të shtresohej me hi dhe ta humbte xixëllimën.

Kekë Ymeri kishte mbetur keq. Nuk dinte si të sillej, si t'i përgjigjej. T'i thoshte po zotëri apo, si urdhëro zotëri... por fjalët: „ju keni ardhur..." ashtu të përgjysmuara nuk kishin ndonjë kuptim. Të rrinte akoma aty, të kërkonte falje dhe të dilte jashtë apo të pyeste?!... më mirë të pres edhe pak, mendoj në fund!

– Pra, ju porsa e keni përfunduar gjimnazin? – tha befas naçallniku.

– Po gospodine!

– Në gjuhën tonë apo jo?

– Si urdhëro gospodine!

– Ne i duam dhe i nderojmë njerëzit e shkolluar. Perandoria ka nevojë për njerëz të tillë. Besoj se edhe

ju keni dëshirë që pas kaq shumë vitesh të studimeve, mundi i juaj të kurorëzohet me një vend të mirë pune... për shembull në njërin nga sektorët e komunës! Si thua?

– Si urdhëro gospodine!

– Shumë mirë! Ne kemi mjaft nga njerzit tanë të shkolluar, që janë të përgatitur për kryerjen e çfarëdo pune por, në shumë raste ata kanë probleme me gjuhën. Kurse ti, për bukuri e njeh gjuhën e shqiptarëve?!...

– Si urdhëro gospodine! Edhe unë jam shqiptar!...

– Po, por me shkollë dhe kulturë serbe!... ne jemi të lumtur që në mesin e shqiptarëve ka njerëz të tillë. Keni stilin e të folurit të mrekullueshëm!... E shoh se je pak i hutuar. Tani do të sqaroj se përse ju kemi ftuar!

Naçallniku u ul në karrigen e tij. Pasi shpupurishi nëpër disa shkresa mori një letër në dorë. Me sy të picërruar për disa çaste ndenji pa lëvizur. Pasi lexoi diçka në letër ngriti vështrimin dhe si në kujtim sytë i mbërtheu jo në fytyrën e tij por, diku në mes të gjoksit. Pastaj u ngrit në këmbë duke lënë letrën mbi sipërfaqen e tryezës. Në kohën kur Kekë Ymeri e priste t'ia fillonte bisedës, ai vetëm u kollit, sikur donte ta pastronte zërin para se të mbante ndonjë fjalim festiv.

– Sigurisht se keni dëgjuar për gërmimet që janë bërë në këto anë nga disa të huaj. Ato gërmime kanë ndodhur pa pranin tonë por, edhe pa pranin tuaj, mendoj të ju shqiptarëve. Mbretëria jonë ka pru vendim që ato gërmime të rishqyrtohen nga ekspertët tanë, dhe nga ekspertet e miqve tanë. Besoj se nëntoka do të flasë për praninë tuaj mijëvjeçare në këto anë, ndërsa mbi toka do të tregon të kundërtën... Ju shqiptarët jeni njëri nga popujt më të vjetër të Ballkanit. Pra, jeni popull

i plakur. Dhe njeriu kur plakët, nuk sheh dot nga ardhmëria. Nuk dëshiron ta njoh të ardhmen sepse ajo është e venitur, e shkurtër dhe tragjike. Pra, ardhmëria e plakut është vdekja! Ka me qindra popuj që kanë jetuar, janë zhvilluar, kanë lënë gjurmë, janë plakur dhe tak, një ditë kanë vdekur. Janë zhdukur! Vendet e tyre, varret e tyre, toponimet e tyre dhe gërmadhat e tyre jetojnë. Ato në fshehtësi të plotë i ruan nëntoka. Pikërisht për këtë, qeveria ka sajuar ekipe ekspertësh, që do të merren më zbardhjen e këtyre mistereve që i fshehë nëntoka. Edhe ti pra, do të jesh njëri prej tyre!

Naçallniku nuk foli më. Në zyrë ra heshtje. Ai e shikonte ngultas me një buzëqeshje të ngrirë mbi buzë. Kurse Kekë Ymeri nuk kishte arrirë të kuptonte hiç nga të gjitha ato që naçallniku i kishte folur. Botë e vjetër. Popull plak. Popuj të shuar, të zhdukur, të vdekur. Ekspertë. Tronditja dhe drithërima që ia kishte përshkuar gjithë trupin, nuk e lejonte të përqendrohej në ato që i thoshte naçallniku. Porsa e kishte hapur gojën të thoshte „si urdhëron Zotëri," apo „e kam të qartë Zotëri," ju kujtuan fjalët e profesorit në gjimnaz kur thoshte se, pa e kuptuar esencën kurrë mos thuaj e mora vesh! Por tani nuk ishte para profesorit për t'i thënë e mora apo nuk e mora vesh por, ishte para naçallnikut. U vu të kujtonte ndonjë rregullore që kishte mësuar në shkollë, apo e kishte dëgjuar nga dikush tjetër për raste të tilla, se si të sillej para naçallnikut por, nuk ju kujtua asgjë. Naçallniku vazhdonte të rrinte me atë buzëqeshjen e ngrirë. Kekë Ymeri hodhi vështrimin nga ai. Për herë të parë pa se naçallniku kishte fytyrë rrumbullake, cullufe të gjata dhe mustaqe të kthyera spicë përpjetë.

– Tani është fillimi i stinës së pranverës, – vazhdoj Naçallniku si me përtesë – për momentin nuk është aspak kohë e përshtatshme për gërmime. Detyrë parësore e juaja dhe e shumë ndihmësve të tjerë që do të merreni me këtë punë është, që nga populli të mblidhen mbeturinat antike si, armë të vjetra, veshje kombëtare, qilima, hasra, enë të ndryshme, mjete pune, mjete të papërdorshme artizanati e të tjera të kësaj natyre. Ne do t'i blejmë antikat! Këto sqarime janë sa për fillim, kurse të tjerat do t'i mësosh gjatë ditëve të ardhshme! Bashkëpunëtor do ta kesh etnografin Dragomir Marjanoviq. Si thua?

Pyetja e Naçallnikut „Si thua?" u shoqërua me një shikim të hollë, disi depërtues, që kërkonte përgjigje të menjëhershme, sikur e hutoi edhe më tepër. Pa dashur nga goja e tij dolën fjalët:

– Si urdhëro gospodine!...

– Çestitam!... – tha ai duke ia vënë një letër përpara. – ja këtu duhet ta nënshkruash! Ashtu!... kur të dalësh nga këtu, shko në të djathtë, është zyra tjetër dhe trokit aty. Atje të gjitha janë gati.

Kekë Ymeri doli. Ishte krejtësisht i trullosur. Copa fjalësh i vërviteshin në kokë. Çfarë është vallë kështu? Pyeti për të satën herë vetën pa gjetur përgjigje. Qetësia e trishtueshme dhe e ftohët në korridor nuk ia kthjelloj aspak mendjen e trullosur bile përkundrazi e ndjente vetën edhe më të trullosur se sa gjatë kohës sa kishte qenë në zyrën e naçallnikut. Dyert e zyrave ishin të renditura njëra pas tjetrës dhe të mbyllura. Tani nuk i kujtohej më se në cilën derë duhej të trokiste. Për një copë herë mbeti duke u sjellë kuturu sa të njëra derë e zyrës, të dera tjetër. Më në fund u ndal në mes të

korridorit. Nuk e përcaktonte dot se në çfarë gjendje shpirtërore ishte. Vendosi të trokiste në një derë. Le të dalë ku të dalë! Ashtu bëri. Trokiti në një derë që ju gjend më pranë. Edhe pse e rëna e tij ju duk e lehtë, ndjeu se nga trokitja ushtoi korridori. I trembur, i erdhi që ta tërhiqte trokitjen dhe ta bënte më të lehtë duke e përmirësuar gabimin por, ishte e pamundur. Pasi qëndroj një grimë, pa se nga zyra nuk lajmërohej askush. Trokiti për të dytën herë. Kësaj radhe i ra më me forcë derës. Prapë qetësi. Provoj ta hapte por, dera ishte e mbyllur. Në momentin kur po bëhej gati të largohej nga ajo derë, dhe të trokiste në një derë tjetër, dëgjoj cijatjen e një dere që u hap. Një burrë doli që andej. Sigurisht e ka dëgjuar trokitjen time, mendoj vetëtimthi. Ai pa nga Kekë Ymeri dhe buza i shkoj në gaz. Tamam në kohën kur u mat ta pyeste se ku duhej të paraqitej, burri që shikonte ngultas pyeti.

– Kë po e kërkoni?

– Me falni por... tani sa dola nga zyra e naçallnikut dhe po e kërkoj zyrën!... zyrën e arkeologut!

– Ja kjo është... – bëri ai me dorë nga dera e zyrës që posa kishte dalë vet. – Urdhëroni!

Kjo zyre në krahasim me zyrën e Naçallnikut ishte shumë më e madhe. Në brendi pa një tavolinë të madhe dhe tre burra të kërrusur mbi të duke shikuar disa letra të mëdha të hapura mbi tavolinë. Porsa Kekë Ymeri u gjend në zyrë, ata kthyen kokat drejt tij, duke u ngritur në këmbë. Për një çast ju duk vetja madhështor. Ata ishin ngritur në këmbë sigurisht nga ardhja e tij. Zyrtari që e solli nga korridori, ju afrua pranë njërit nga tre burrat dhe diçka i pëshpëriti të veshi. Tjetri luhati kokën në shenjë pohimi. Pasi u largua, ai që e kishte

luhatur kokën doli një hap para dhe ia zgjati dorën:

– Mirë se erdhe! Unë quhem Van Joviq, jam arkeolog, kurse ky që ta hapi derën është etnologu Dragomir Marjanoviq, e ky këtu është francez. Quhet Fransua Roger. Urdhëro këtu ju lutëm!... ndoshta naçallniku ju ka njoftuar për punën tonë. Ti, në fillim do të punosh me Dragomirin. Sëbashku do të merreni me mbledhjen e antikave, të tapive të vjetra dhe të dorëshkrimeve kishtare apo të imamëve.

Tani Kekë Ymeri, më tepër ishte i hutuar me fytyrën e zyrtarit se sa edhe me fjalët e tij që, për momentin, nuk e dinte saktësisht se për çka po fliste. Ishte fytyrëvrenjtur, me pamje kuqaloshe e me pikla. Kishte një mjekër të shkurtër e me qime të rralla. Flokët i kishte të kuqërremta dhe të buta por çuditërisht, të ngritura ngatërrueshëm e frikshëm përpjetë. Nga karrigia ku ishte i ulur, zyrtari ju duk i gjatë dhe i frikshëm. Pas një buzëqeshje si të përhumbur ia kthej kurrizin. Nga tryeza matanë mori një letër dhe u nis drejt tij. E lëshoi lehtë mbi sipërfaqen e tryezës. Pastaj vërviti gishtin tregues mbi disa rrathë e vija të lakuara që ishin të skicuar mbi letër në formë të çrregullt, si dhe disa emra të shkruar në këndin e djathtë të letrës. Kekë Ymeri shikoi mbi letër, duke e përcjellë lëvizjen e gishtit të tij që rrëshqiste ngadalë mbi ato emërtime. Nuk ishte në gjendje asgjë të lexonte apo të kuptonte se për çfarë në të vërtetë ishte fjala. Megjithatë, vazhdonte ta përcillte çdo lëvizje të gishtit të tij. Për një çast, çuditërisht gishti i tij ju duk tepër i gjatë dhe i hollë. U befasua kur ai e mblodhi gishtin bashkë me gishtërinjtë e tjerë duke formuar një grusht të dobët e të thatë!

– I sheh pra! Këtu janë të skicuara disa nga vendet

arkeologjike që duhet të gërmohen. Janë kala të shkatërruara nga luftërat, kisha të rrënuara nga ushtritë barbare, vendbanime të vjetra e të tjera të kësaj natyre! – foli ai me një zë të thatë, disi të zhvendosur – kurse këtu, janë disa emërtime topografike që janë marrë nga vendësit në origjinal. Në mesin e tyre ka edhe toponime që deshifrohen përmes gjuhës tonë!

Van Joviqi u largua nga tryeza e tij dhe u afrua pranë tangarit duke trazuar lehtë prushin me mashë. Kekë Ymeri nuk dinte ende se çfarë duhej të bënte, si të sillej? Pasi i shikoj të gjithë zyrtarët me radhë, vështrimin e ndali mbi fytyrën e pashme të francezit, i cili pa të keq vuri buzën në gaz. Ashtu bëri edhe Kekë Ymeri. Me një buzëqeshje të hutuar, rrëshqitas tërhoqi vështrimin nga fytyra e tij dhe e hodhi mbi letër. Në hartë pa dy „XX" me ngjyrë të zezë dhe fare pranë germa „N". Me lartë pa një „X" me ngjyrë të kuqe e të shënuar: „Manastiri i Sveti Bogorodicës!..."

KAPITULL PA NUMËR

Sef Beli rrinte i ulur këmbëkryq në hasër, pranë ballit të oxhakut. Herë pas here thithte duhan me çibukun e tij të qelibarit. Pasi u kollit, fillojë të fliste me zërin e tij të mekur. Kekë Ymeri mbante shënim:

– Në ato kohërat e vjetra ne, i kemi pasur trojet në Krye, aty ku sot ndodhet Gurra e Sofjes. Siç kanë thënë pleqtë tanë, Galanët ishin fis më i madh se fisi ynë. Ata kishin jetuar rrëzë këtyre bjeshkëve. Thuhet se në ato kohërat e moçme e kishin ndërtuar kalanë e Golinës. Ata kanë qenë kryezot i këtyre anëve derisa janë sulmuar nga ushtritë serbe. Pas një rezistence të madhe, thyhen. Serbët, në shenjë hakmarrje e shkatërrojnë kalanë. Këtu fillon dobësimi i Galanëve dhe, dalëngadalë bie edhe lavdia e tyre.

– Edhe në Krye, rrëzë Shkëmbit të Kuq ka mure të vjetra. Kush ka jetuar atje? – pyeti Kekë Ymeri.

– Të thash më parë, fisi ynë dhe fisi i Galanëve! Ata veç kalasë, kanë ndërtuar edhe kishën në anën perëndimore të Shkëmbit të Kuq në vendin e quajtur Breg. Pran shkëmbit të kuq edhe sot ndodhët fiku shekullorë. Thuhet se ka qenë pronë e familjes së Galanit.

– Pas Galanëve, kush e mori kishën dhe kalanë në vartësi?

– Ushtria serbe në krye me Nemanjiçët[1]. Ata e kthyen manastirin në pronësi të tyre duke e rinovuar dhe duke ia dhënë emrin Manastiri i Sveti Bogorodicës. Manastirin e kishte mbrojtur njëfar Gjenevizi, i cili njihej edhe si udhëheqësi kryesor i saj. Në manastir kishin shërbyer popë dhe kallogjer[2].

– Çfarë thotë gojëdhëna për shpellën në Shkëmbin e Kuq?

– Thuhet se nga ana verilindore e kishës ishte i ndërtuar tuneli i nëndheshëm që shpinte në Shpellën e Shkëmbit të Kuq. Kallogjerët kishin mundësi të fshiheshin në rast të ndonjë sulmi që do t'i bëhej manastirit dhe, të pushonin e të kënaqeshin në nimfën e saj gjatë ditëve të paqes.

– Po për qumështsjellësin çfarë thotë gojëdhëna?

– Qumështsjellësi ishte i ndërtuar me lugje druri me gjatësi katër-pesë kilometra dhe ngjitej gjer lartë në bjeshkë. Atje hidhej qumështi dhe pastaj derdhej në kazanët e manastirit.

---

1 *Shteti serb i Rashës u krijua aty nga fundi i shek. XII dhe fillimisht përfshiu krahinën e Rashës, në veri të Novipazarit, që ishte njëkohësisht atdheu i parë i serbëve. Por, në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XII, zhupani i madh serb Stefan Nemanja mundi t'i shtrinte kufijtë e shtetit të tij në drejtim të jugut dhe të jugperëndimit.*

2 *Murg ortodoks*

– Kush e shkatërroj manastirin?

– Ushtria e Kermëtatarhanit, ose e mongolëve siç i quajnë sot.

– A pati rezistencë nga ana e Gjenevizit?

– Po, por Gjenevizi e humbi luftën. Manastiri ra në duart e ushtrisë së Kermëtatarhanit. Ata në shenjë hakmarrje, për shkak të rezistencës, e shkatërruan manastirin dhe një pjesë të kallogjerëve i shkuan në shpatë, në derë dhe përreth manastirit. Kurse një pjesë tjetër e kallogjerëve arriti që përmes kanalit sekret të nëndheshëm të fshiheshin në shpellën e Shkëmbit të Kuq.

– A arritën të mbijetojnë kallogjerët që i shpëtuan sulmit të parë?

– Jo, nuk mbijetuan. Për një kohë i mbajti nën mbrojtje në shpellën e Shkëmbit të Kuq fisi i Galanit. Pas kapjes nga ushtarët e Kermëtatarhanit të njërit nga Galanët, kur ishte duke ua dërguar ushqimet kallogjerëve, nga torturat ishte detyruar të tregonte ku ishin fshehur kallogjerët, të cilët në befasi i zënë të gjallë. Para se t'i vrisnin ju tregojnë se kush i ka spiunuar. Kallogjerët, të zhgënjyer e mallkojnë fisin e Galanit: O Galan, që na dhe bukë e na preve në besë, qofshi e rrofshi, kurrë mos u shtofshi!... pastaj i vrasin të gjithë në një përrua faqe mali, që edhe sot quhet: „Lugu i kallogjerëve!"

Kekë Ymeri pasi shënoj datën në fundin e fletës, i kredhur në mendime u ngrit. E përshëndeti plakun duke e lënë të qetë në kujtimet e tij dhe doli. Deri sa ishte duke i zbritur shkallët e drunjta të kullës, mendjen e kishte akoma të plaku dhe padashur ju kujtuan fjalët e Naçallnikut që ditë më parë i kishte thënë në zyrën e tij: Popull plak!

Ishte buzë mbrëmje. Në rrugë nuk kishte njeri. Sa po kishte kaluar një ditë plot diell, por e ftohët. Shikimin e ngriti lartë dhe për një copë herë e mbajti të ngrirë mbi zgavrën e errët që dukej si një sy i shterur e plot mistere në mes të faqes shkëmbore të Shkëmbit të Kuq. A thua o Zot, çfarë fshehët në brendi të asaj shpelle!?...

III

Pas rregullimit të sallës së madhe që ndodhej në anën e pasme të ndërtesës komunale, ishte njoftuar populli përmes tellallit, për fillimin e grumbullimit të gjërave antike. Pas njoftimit të parë njerëzit me thasë apo duqe në krahë ishin lëshuar drejt ndërtesës së re. Ata kishin pru lloj-lloj veshjesh e stolish të vjetra si japanxhe, xhubleta, jelek, tirq me gajtanë e shokë lahuri, xhamadan, xhybe, pështjellak vajzash, pështjellak nusesh, dolloma, kanac, këmisha e shamia mëndafshi të prodhuara motit nga mëndafshpunuesit e Pejës, kallçi e opinga gogishte, pëlhura kambriku, arka druri, takëme çaji e kafeje, kutia tunxhi apo bakri për duhan, eshkë, urorë, llullë, kamish… pastaj stoli si; vathë e gjerdan të moçme nusesh, pafta brezi, qostek sahati, perishane, duvak të vjetër të gjysheve apo stërgjysheve që kishin mbetur në fundin e arkave të hedhura diku

në ndonjë skaj të tavanit.

Pas seleksionimit nga ana e etnologut Dragomir Milivojeviqit, një pjesë e madhe e fshatarëve ishin kthyer mbrapsht ashtu siç kishin ardhur, por të zhgënjyer. Miliqi i kishte sqaruar fshatarët se veshjet që ata donin t'i shisnin duhej të ishin shumë më të vjetra, të ishin aso modelesh që tani nuk përdoreshin më. Më të preferuarat do të ishin armët e vjetra, heshtat, shigjetat, topuzët, mëzdrakët, mburojat, shpatat, thikat, jataganët, pastaj ndonjë monedhë e gjetur rastësisht pran mureve të vjetra.

Në fillim fshatarët kishin hezituar t'i jepnin armët e vjetra. Ata i konsideronin ato si pjesë nga e kaluara e tyre fisnike, si pjesë e shpirtit të parëve të tyre. Në tavanet e kullave gjendeshin jatagan, mëzdrak e topuz të ndryshkur, shpata të pluhurosura, kobure të vjetra, martina e pushkë karajfile. Kishte edhe kryqe druri apo tunxhi të fshehura nën dyshemetë e koshave apo të hambarëve, të ruajtura me xhelozi që nga kohërat e konvertimit. Gjendëshin edhe qypa e kupa të vjetra qeramike. Në kullën e Galanëve thuhej se ndodhej një Nakunë tunxhi. Ata e kishin ruajtur brez pas brezi dhe herë pas here e kishin përdorur në raste festash apo dasmash për zbukurimin e atllarëve. Nakuna ishte e qëndisur rreth e qark me telatin të kuq e shkëlqyes dhe anëve i vareshin mansheta, sedefe e perishane ngjyrë ari. Në mes ndodhej një emblemë si dhe rreth saj shumë skalitje në formë të shkronjave latine, të padeshifruara. Thuhej se ajo kishte qenë pronë e Galanit Kryezot.

Van Joviqi, i shoqëruar nga Roger, kishte filluar të trokiste në dyert e fshatarëve. Së pari ai kishte shkuar në kullën e kryeplakut, pastaj të bajraktarit e fill pas

tyre kishte shkuar në kullën e Mar Rexhës. Ishte parë edhe në kullën e Latifit, të Deli Turileshit e kështu me radhë. Ai kishte vizituar herë pas here edhe kullat e Dak Lamit, Cam Manit, Mak Sutit e të Keq Sykut. Rezultatet e para kishin filluar të dukeshin menjëherë pas vizitave të tij.

Të yshtur nga nevoja e madhe fshatarët kishin filluar të dukeshin edhe më shpesh pranë sallës. Në fillim kishin filluar të sillnin qilima, sixhade, hasra të vjetra, dolloma, xhamadan, xhubletë, apo ndonjë mjet pune si um apo rrogëz parmende, shul vegje apo drang dere, kerhan e gërshërë, furka e shtiza.

Dorëzimi i armëve të vjetra hala shikohej me dyshim.

Këtë imazh e theu befas një ditë xhumaje kryeplaku. Tamam në kohën kur xhemati po dilte nga xhamia, ai ishte parë, si nga hera, me plisin në cep të syrit, shokë lahuri shumëngjyrëshe dhe jelek të zi, duke zbritur sokakut me parzmore e përkrenare të vjetra bronzi. Fshatarët e panë të çuditur! Ai, duke buzëqeshur ishte afruar me nge pranë turmës kureshtare duke ju sqaruar se pasi t'i shiste këto gjëra që hidheshin nga njëri skaj i tavanit në tjetrin, do të kishte mundësi të blinte ndoshta jo një penë qe, por një ka siguristh se do të blinte. Ai nuk kishte harruar të sqaronte se gjërat e vjetra që mbanin shënime, emblema të ndryshme, pafta bronzi apo hekuri ishin shumë të çmuara. Edhe ndonjë tapi e vjetër e mbetur diku në skaje të dollapëve që tani më nuk do t'i hynte në punë askujt, pse mos të shndërrohet në para, kishte thënë pastaj kryeplaku! Parzmorja që mbante në duar ishte shumë e vjetër. Në shqyt kishte të skalitur një emblemë në formë zemre,

ku në njërën anë ishte e skalitur në mënyrë të pjerrtë një heshtë, e në të djathtë kishte një shpatë dhe në mes kishte një kokë gjarpri ku i dukej goja e hapur dhe gjuha e nxjerr jashtë, kurse bishti i dilte në fundin e emblemës i lëshuar pingul dhe i mprehët si maje shigjete. Në mes të saj ishin të shënuara disa shkronja që askush nuk i kishte deshifruar. Kryeplaku ishte larguar duke i bartur ato në dorën e djathtë, pak i kërrusur nga e majta, duke krijuar përshtypjen se nga çasti në çast trupi i tij i hollë dhe i thatë do të thyhej në mes.

Jashar efendiu kishte pru një temjanicë[3] të vjetër tunxhi. Thuhej se ajo kishte qenë pronë e Manastirit të Shën Bogorodicës të cilën e kishte ruajtur në shekuj nga fisi i Galanit. Kur e kishin ndërruar fenë duke u konvertuar në mysliman, temjanicën ia kishin dhuruar xhamisë. Temjanica kishte qëndruar e varur në kupolën e xhamisë po thuaj tre shekuj. Vlera e temjanicës kishte qëndruar në faktin se rreth e qark veç skalitjeve të bukura floreale kishte edhe shkronja nga alfabeti cirilik. Atë temjanicë e kishte kërkuar majori për t'ia dorëzuar si dhuratë kryepeshkopit të Manastirit të Pejës. Van Joviqi nuk kishte pranuar. Ai donte që ky relikt i rrallë të vendosët në muzeun qendror në kryeqytet.

Van Joviqi kishte dhënë urdhër që çdo gjë e gjetur e që mbante mbishkrime të vjetra, qofshin ato edhe në alfabetin latin apo arab, të paguheshin me çmime të veçanta.

Thuhej se bajraktari e kishte dorëzuar shpatën, që brez pas brezi e kishin mbajtur të varur në mur, në

---

3 Enë e vogël e metalt në formë kupe, me tre zingjirë të hollë të bashkuar sipër në një dorëz, që shërben për të djegur temjanin gjat riteve kishtare

ballë të oxhakut në odën e burrave. Ajo shpatë kishte qenë dhuratë nga veziri i madh që ia kishte dhuruar stërgjyshit të tij për meritat që i kishte treguar gjatë shërbimit të tij në ushtrinë turke, ku edhe e kishte marrë gradën e bimbashit. Shpata kishte qenë e skalitur me argjend. Dorëza e saj kishte qenë e praruar në ar dhe në të kishte qenë e shënuar një sure e shkurtër nga kurani. Thuhej se me të kishte fituar shumë beteja sheh Dërguti, deri sa kishte rënë dëshmor. Pastaj veziri ia kishte dhuruar shpatën bimbashit. Edhe pse bimbashi nuk kishte ditur ta përdorte sikurse sheh Dërguti, shpata magjike kishte qëndruar e varur në odë. Thuhej se falë asaj shpate familja e gjerë e bajraktarit kishte qenë gjithmonë e mbrojtur nga syri i keq dhe magjitë.

Duke e parë se gjërat me mbishkrime janë shumë të çmuara, një kohë të gjatë ishte biseduar edhe për rrasat e mermerit që ndodheshin të Gurra e Sofies, të mulliri i Mar Rexhës, të avdes'hanja e madhe pranë mejtepit të xhamisë, dhe në kullat e disa fshatarëve të bartur nga kalaja e Golinës dhe të murosur nën qemer, duke pretenduar se ata gur mermeri të shkruar do t'ju sillnin fat.

Pran mejtepit ndodhej një pille[4] e vjetër që mbushej prore me ujë nga dy lëfyte tunxhi të gurrës. Të katër faqet anësore dukeshin si korniza dekorative të ndërtuara me motive floreale dhe në brendi të tyre kishte shkronja të alfabetit latin të skalitura brenda medaljoneve. Dikush kishte thënë së këta gurë duhej të shiteshin dhe nga ato para të meremetohej ura e Delisë, që kishte zënë të shembej, apo të meremetohej një pjesë

---

4 Koritë guri katërkëndëshe dhe e thellë

e murit të xhamisë që ishte prishur. Idenë e fundit e kishte pëlqyer Jashar efendiu e kryeplaku. Bajraktari kishte mbajtur qëndrim neutral.

Keq Syku i shoqëruar nga Miliqi, ishte parë një ditë të futej në zyrën e majorit. Se për çfarë ishte biseduar nuk dihej. Keq Syku nuk fliste asgjë rreth shkuarjes së tij në atë zyre. Pastaj kishin shpërthyer thashethemet rreth tij. Pjesa më e madhe e fshatarëve ishin të një mendje se ai kishte zbuluar ndonjë qyp me lira diku në themelet e kalasë së Golinës dhe donte t'ia shiste direkt majorit i cili çmendej pas gjërave të vjetra antike, bile edhe më shumë se Van Joviqi. Disa të tjerë kishin thënë se ai ishte bërë ndërmjetës në mes të majorit dhe dy të bijve të Dautit, të cilët thuhej se kishin zbuluar një shpellë tjetër plot me xhevahir!

Në mëngjesin e ditës së premte, kur Bel Feka ishte nisur për të shkuar në xhami për faljen e sabahut, ishte tronditur kur kishte parë Gurrën e Sofies të shkatërruar. Në fillim nuk e kishte vërejtur se rrasa e mermerit mungonte. Gurët e piedestalit të gurrës ishin shpërndarë sa andej e këndej, një pjesë e tyre kishin sosur në ujin e lumit të rrëmbyer që ndodhej fare pranë, kurse lëfyti i tunxhit, që kishte nxjerrë ujin prore, ishte shkatërruar krejt dhe ishte i hedhur buzë bregut të lumit. Bel Feka kishte shkuar me vrap dhe e kishte lajmëruar kryeplakun. Ndërkohë ishin mbledhur plot burra, për ta parë katrahurën. Ata kishin vërejtur se mungonte rrasa me mbishkrim e mermerit. Nuk kishte vonuar dhe kishte arrirë Van Joviqi bashkë me vartësit e tij. Ai kishte thënë se rrasa do të gjendej shpejt sepse dikush e ka rrëmbyer për ta shitur. Në mesin e të ardhurve ishte edhe Kekë Ymeri.

Ishte jashtëzakonisht i tronditur. Me t'u hapur lajmi se rrasat kanë vlerë të madhe arkeologjike është dashur që ne, të organizonim ruajtjen e tyre në mënyrë sekrete, kishte menduar vetëtimthi Kekë Ymeri dhe mendja i kishte shkuar të Misin Kapedani. Ah sikur ai të ishte lajmëruar më parë!... kishte ofsha i dëshpëruar. Më vonë kishin ardhur xhandarët. Pasi e kishin siguruar vendin kishin filluar nga matjet. Naçallniku dukej i dëshpëruar. Me sy të zgurdulluar shikonte nga turma. Pastaj, duke shikuar me ngulmë fytyrat e heshtura u nis drejt turmës. Pasi shikoj një copë herë, ngriti dorën duke bërë me gisht nga Mak Suti.

– Ti, eja këtu! – ju drejtua ai Mak Sutit! – Edhe ti! – ju drejtua një të riu që ndodhej pranë tij. Pasi u mendua për një copë herë, ai zgjati prapë dorën, kësaj radhe duke shënuar drejt Lulit të Deli Turileshit dhe Mal Dakat. Kekë Ymerin sa nuk e lëshuan këmbët. Për një çast ju bë se pa Dinorën me ato vetullat e saj kaleshe që e shikonte qortueshëm dhe e bënte atë me faj. Ju bë se e pa atë si dikur pa ferexhe kur kalonte pranë shtëpisë së tij me bucele në dorë, duke shikuar vjedhurazi drejt dyshekllakut ku ai tërë ditën e priste aty me padurim, herë me libër në dorë, e herë duke i rënë çiftelisë. Befas, e ndjeu në shpirt se sa e kishte marrë malli për të. Ashtu i tronditur, bëri një lëvizje drejt naçallnikut duke dashur të garantonte në pafajësinë e tyre, por ai nuk i dha kohë! Duke e zgjatur dorën e majtë, bëri shenjim të ri duke i ftuar edhe katër të tjerë. – Merrini! – tha Naçallniku.

Tre xhandar ua lidhen duart dhe i shtynë përpara. Të gjithë mbetën të nemitur. Askush nuk e kishte pritur një gjë të tillë. Ata i nisën drejt qytezës. Pas tyre u nis

edhe Van Joviqi me vartësit e tij. Kekë Ymerit nga dora i ra penda. Me përtesë u kërrus dhe e mori dhe, me fytyrë të verdhë dyllë u nis pas tyre.

– Ndoshta do t'i dërgojnë në burg! – u dëgjua një zë nga mesi i turmës.

– Hej medet hej, ma morën të vetmin djalë! – u dëgjua zëri i përvajshëm i Deli Turileshit.

Kekë Ymerin e theri shikimi i tij dëshpërues. Ju bë se ata sy të fshehur nën vetullat e trasha kërkonin mëshirë prej tij. Prapë ju kujtua Dinorja!

Në heshtje varri turma fillojë të shpërndahej.

Ushtima e ujit që vazhdonte të binte e shkumëzuar duke u përplasur shkëmbinjve të shtratit të thepisur të lumit, duke krijuar një ujëvarë të vogël e të bukur, u duk se u dëgjua më e fortë se kurrë. Askush nuk e kishte mendjen të ujëvara e as të shkumëzimi i ujit të saj. Kekë Ymeri ktheu kokën dhe shikoj ngultas ujëvarën dhe për një çast ju bë se ushtima e ujit kishte një gjëmim të padëgjuar ndonjëherë. Ndjeu se në gjoks ju kishte hapur një gropë.

Rreth mesditës kishin ndodhur arrestime tjera. Kishin arrestuar kënd e kishin gjetur në arë, në livadh, në rrugë apo në hanin e babit. Thuhej se atë ditë ishin arrestuar tridhjetë e dy burra. I kishin ngujuar në një mulli. Sipas kryeplakut, i vetmi që ishte më afër ngjarjes, nga të arrestuarit nuk kërkohej se kush e ka vjedhur rrasën e mermerit, gjë që fjala kishte marrë dhen se ajo rrasë ishte bërë shkak për këto arrestime por, kërkohej dorëzimi i armëve.

*

Pas dhembjeve, lotëve dhe dënesave të ditës, nata si një perde e trashë, e rëndë dhe e ftohët e kishte pështjellur mbar katundin e shqetësuar. Njerëzit të zhgënjyer dhe të frikësuar me mundim ishin mbledhur pranë vatrave dhe, në dritën e zbehtë të pishës apo të kandilit, me shpresa të humbura, kishin bluar ato që i kishte ngrysur dita. Të arrestuarit i kishin mbyllur në një mulli të moçëm, kjo ishte e sigurt! Për fatin e tyre nuk dihej. Disi, si mënjanë kishin qëndruar elita udhëheqëse e fshatit për arsyen e thjeshtë; të mos përzierjes në punët e shtetit. Shpjegimin e arsyes së arrestimeve ata në fillim e kishin lidhur me dëmtimin dhe vjedhjen e rrasës së mermerit mbi piedestalin e Gurrës së Sofies. Pastaj siç dukej, kishte ardhur lajmi nga naçallniku se arrestimet ishin bërë për shkak të armëmbajtjes pa leje. Kjo e fundit tani përtypej dhe tundej sa në njërin kënd të katundit në këndin tjetër duke marrë forma dhe trajta të ndryshme. Kryeplaku, bajraktari dhe Jashar efendiu, buzë mbrëmjes i kishin lajmëruar fshatarët përmes tellallit të tubohëshin pranë mejtepit. Ata i kishin sqaruar në vija të trasha se të arrestuarit duhej t'i dorzonin të paktën nga një armë e pastaj do të liroheshin pa therrë në këmbë! Në fund, Jashar efendiu kishte kënduar sure nga kurani për ta.

Pas mesit të natës, kur gjumi kishte hyrë në fazën e gjysmë vdekjes, errësirën e kishte shqyer një e shtënë pushke e vetmuar dhe disi e pabesë, të paktën kështu ju kishte dukur të gjithë atyre që gjumin e bënin me ndërprerje për shkak të arrestimeve të një dite më parë. Pas një heshtje të shkurtër ishte dëgjuar e shtëna e dytë.

Ajo, në krahasim me të parën, ndoshta për shkak se e para tani më ua kishte prishur gjumin, ishte dëgjuar më e fuqishme, më e afërt dhe, shumë më e pabesë. Të lehurat e qeneve ishin shpeshtuar, kurse krismat kishin marrë një ritëm kronik duke mos ia lëshuar assesi vendin lirshëm jehonave.

Errësira ishte e trashë, e lagësht dhe e mjegullt. Përmes pamjes ishte e pamundur të përcaktoje se nga vinin të shtënat. Përmes të dëgjuarit dukej se ato vinin diku rreth mullirit të Mar Rexhës. Ishte e pamundur të gjendej një cifël sado e vogël që të shtënat kishin filluar pikërisht aty. Kekë Ymerit, mendja i kishte shkuar të rrasat e mermerit. Cili mund të jetë dëmtuesi vallë? Tamam në kohën kur ishte duke ia heqë drangun derës për të dalë të shihte se ç'po ndodhte jashtë, ishte takuar me të atin në fundin e shkallëve. Duke e qortuar, ai e kishte kthye prapa. Në raste të tilla, në errësirë, e vetmja gjë që mund të marrësh vesh është ndonjë plumb qorr. Dita është ajo që i sqaron sherret e natës, i kishte thënë i ati.

Pasi ishte dukur se të shtënat kishin pushuar, befas kishin filluar të dëgjoheshin edhe më dendur. Kësaj radhe kishin ndërruar vendin dhe ishin dëgjuar pranë mejtepit. Ashtu të shpeshta dhe të frikshme, ngadalë ishin tërhequr drejt Lugut të Madh, derisa kishin pushuar fare. Kekë Ymeri kishte ndezur zjarrin. Burrat ishin zgjuar nga gjumi dhe ishin bashkuar në odë. Plaku i kullës Ymer Ahmeti, që të gjithë e thirrshin babush, ishte zgjuar nga gjumi. Ashtu i ulur në shtratin e tij, kur njëri nga të bijtë ia kishte vënë gëzofin mbi shpatulla, kishte pyetur:

– Nga vinë të shtënat? – dhe, pa pritur të merrte

përgjigje kishte vazhduar: – prapë ia paskan nisë me grackat. Mjerë ata që do të bien pre e tyre! – dhe vështrimin e kishte ndalur mbi fytyrën e verdhë dhe të hequr të Kekë Ymerit.

*

Kur errësira si çarçaf i zi kishte mbuluar katundin, Misin Kapedani, me çetën e tij kishte zbrite nga malet. Fillimisht ishin vendosur në shpellën e vogël pran Amës së ujit. Një lukuni qenesh endacak s'ju kishte shqitur gjatë gjithë rrugës, tani ishin ndalur në distancë dhe ulërinin si të tërbuar. Kaçakët kishin urdhër mos të shtinin mbi ta, sepse do t'ua tërhiqnin vërejtjen xhandarëve. Rrugën e mbetur nga Ama e ujit, deri në kullën e Cam Manit, për të mos lënë gjurmë mbi barin e njomë plot vesë, e kishin kaluar mes për mes jazit.

Që në fillim, ishte dhënë urdhri, që rojet të vendoseshin tre nga tre pranë mullirit të Mar Rexhës dhe pran mejtepit. Pastaj të ruhej kulla e Cam Manit dhe nga një roje të vendosej në afërsi të kullës së Keq Sykut, Jashar Efendiut dhe të kryeplakut. Këta të fundit, të përgjoheshin se mos bënin ndonjë lëvizje të dyshimtë gjatë aksionit. Kurse pjesa tjetër e kaçakëve, me Misin Kapedanin në krye ishte vendosur në livadhin e Beut, matanë lumit. Pjesa tjetër nën komandën e Nak Përkiqit ishte vendosur në të hyrë të lagjeve të Vremçit e të Tëdelit, dhe në krye të lagjes së Marit duke bllokuar rrugën e mejtepit. Misin Kapedani kishte dhënë urdhër që askush mos të pinte duhan bile as me llullë. Mos të qëllonin me armë zjarri pa nevojë, por vetëm në rast se kundërshtarët do t'i sulmonin. Të

përcillet me vëmendjen më të madhe çdo lëvizje që do të paraqitej gjatë natës dhe pastaj, nëse hetohën lëvizje, të kapet viktima në befasi. Çdo njëri që do të kapet në këto rrethana, pa dallim, të lidhet mirë dhe të sillet në shtab.

Në pjesën e parë të natës nuk ishte hetuar ndonjë lëvizje e dyshimtë, përveç lëvizjet e qenve, që endeshin sa në njërin skaj të katundit në tjetrin. Vonë, pas mesnate në rrugën që vinte nga hani i Babit, për të hyrë në lagjen e Marit, ishin parë disa xhandar duke kaluar me hapat e tyre të rëndë. Fill pas tyre ishin dukur si hije nate dy silueta. Pas tyre kishin ardhur edhe dy hije të tjera duke ecur lehtë mbi rrugën e lagur nga shiu i imtë që kishte filluar të binte. Kurse tutje të hani i Babit ishin dëgjuar zëra. Pranë mullirit të Mar Rexhës, dy të parët kishin ndaluar pranë rrasës së madhe të mermerit, kurse të tjerët kishin vazhduar rrugën në drejtim të mejtepit. Tamam në kohën kur rojet i kishin sulmuar dhe e kishin lidhur një xhandar, japanxhezinjtë kishin arritur të zhdukeshin. Kaçakët kishin qëlluar në drejtim të tyre. Në ndërkohë, kishte ndërhy Misin Kapedani duke ua pre rrugën xhandarëve. Rojeve u kishin shkuar në ndihmë edhe tre kaçak të tjerë. Pas një përleshje të shkurtër xhandarët kishin arrirë të largoheshin duke e lënë një kaçak të plagosur. Pasi kaçakët e kishin kaluar lumin, se nga kishin mbirë edhe një hordhi tjetër xhandarësh nuk dihej, por sulmi kishte marrë përmasa të paparashikueshme. Misin kapedani kishte dhënë urdhër të tërhiqeshin. Me të shpejt kishin kaluar livadhin e Beut dhe kishin dalë në anën e pasme të lagjes së Tëdelit. Aty, me urdhër të Misin Kapedanit kaçakët ishin ndarë në dy grupe. Njëri bashkë me

xhandarin e lidhur dhe me të plagosurin kishte marrë drejtimin e Amës së ujit dhe ishin vendosur në shpellë, kurse Misin Kapedani kishte marrë rrugën përmes ngushticës së Tëdelit për t'i ardhur në ndihmë Nak Përkiqit. Duke lëvizur ngadalë në drejtim të mejtepit, Misin Kapedani kishte vërejtur se para tij, krejt ngadalë, po lëviznin një hordhi xhandarësh. Ata lëviznin në distancë pranë njëri tjetrit për t'ua marrë krahët kaçakëve, dhe për ta futur në qark mejtepin, xhamin dhe kullën e Jashar efendiut. Ishte befasuar kur kishte dëgjuar urdhrin e Nak Përkiçit dhënë kaçakëve, që të tërhiqeshin drejt lagjes së Vremçit. „Shpejt, shpejt se na rrethoj xhandarmëria." Pa e përfunduar mirë fjalën, xhandarët kishin shtënë në drejtim të tyre. Misin Kapedani rrufeshëm i kishte sulmuar xhandarët prapa shpine duke ua hapur shtegun kaçakëve. Ishte zhvilluar një luftë e rreptë. Pas tërheqjes, kaçakët ishin takuar në shpellën e Nezirit. Aty, pasi kishin ndezë zjarrin i kishin numëruar luftëtarët. Ndërkohë kishte arrirë edhe praparoja. Në raportin dhënë Misin Kapedanit thuhej; „Gjatë mbikëqyrjes së kullave, nuk kemi vërejtur asnjë lëvizje të dyshimtë, përveç se në kullën e Keq Sykut. Aty, pak para tërheqjes, është vërejtur një hije e zezë të hynte fshehurazi në oborrin e tij, duke u hedhur mbi mur! Nuk kemi arritur të identifikojmë se kush ishte, dhe për çfarë qëllimesh kishte vepruar ashtu. I zënë rob është një xhandar. I plagosur me thikë Tafil Shkoza."

Tamam në kohën kur Misin Kapedani po përgatitej ta merrte në pyetje xhandarin e zënë rob, heshtjen e theu një shpërthim i fuqishëm. Misin Kapedanit me shpatulla të tkurrura nga e papritura kishte drejtuar shikimin nga Nak Përkiqi sikur kishte dashur ta pyeste

se çfarë ishte gjithë kjo gjëmë, por hala pa e marrë vetën kishte ndodhur shpërthimi i dytë. Për një copë herë jehona ishte vërvitë shkëmbinjve deri sa ishte zhdukur në drejtim të Lugut të Butë. Me vrap kishte dalë tek hyrja e shpellës dhe ishte përpjekur të shikonte se nga kishin ardhur shpërthimet.

– O burra, shpejt në strehimoren tjetër! – kishte thirrur me zë të çjerrë Misin Kapedani, – xhandarit lidhjani sytë me shami!"

*

Tingujt e një muzike të padëgjuar ndonjëherë, kalonin dritaret e vogla e të mbërthyera me hekura dhe, si ogur i zi futeshin në mes të burrave të ngujuar në atë ngushtim të mullirit të vjetër. Dallgët e ujit që rridhnin me zhurmë nga butia, e bënin muzikën të zbehtë, të largët, të huaj dhe të frikshme. Mak Suti i rrinte të koka Lulit të Deli Turileshit. Atë e kishin torturuar keq. Po thuaj se krejt pasditen kishte qenë në agoni. Herë pas here kishte kërkuar ujë. Po ku ta gjenin ujin? Edhe pse disa pëllëmbë poshtë këmbëve të tyre kishte ujë me bollëk, për ta nuk kishte. Si ta merrnin!? Kur kishte ndodhë tortura e dytë, Luli nuk e kishte dëgjuar fare. Vonë pas mesit të natës ishte përmendur. Edhe të birin e Ymerit, Mahën e kishin torturuar shumë. Ai ishte më i riu nga të ngujuarit. Të gjithë kishin menduar se ai do të çirrej dhe do të qante sikur kalama por, kishte ndodhur e kundërta. Edhe kur e kishin torturuar për vdekje nuk ju kishte dëgjuar zëri. Pasi kishte ardhur pak në vete, i kishte mbledhur të gjitha forcat dhe me gjysmë zëri ju kishte thënë të bashkë ngujuarve që,

kur të vinin herën tjetër xhandarët për t'i torturuar të hidheshin në sulm. Pasi t'ua thyenin llambën, të kacafyteshin me ta. Dikush do të vritej por, siguristh se dikush do të shpëtoj. Më mirë të vdesim duke luftuar se sa të vdesim nga torturat. Mos fol çapraz o i biri i Ymer Ahmetit, je i ri e buzët të qesin tambël, i kishte thënë Sejdi Çekiçi. Ndërsa, Mal Daka, herë pas here largohej dhe në heshtje të plotë i fuste gishtat në një të çarë të dyshemesë dhe përpiqej ta largonte një dërrasë, bile sa për të pirë ujë. Më vonë, kur Luli ishte këndellë pak, ishte afruar pranë tij dhe me forcat e fundit kishte filluar t'i ndihmonte në tërheqjen e dërrasës. Tamam, kur shpresat kishin filluar të shuheshin, e kishin tërheq dërrasën përfundimisht. Në fillim kishin filluar të nxirrnin ujë. Mal Daka, herë pas here e mbushte me ujë plisin e tij të bardhë dhe ua shpërndante të tjerëve. Kur pranë derës së jashtme të mullirit ishin dëgjuar zëra, ai përmes të çarës ishte lëshuar në jazin e ujit fare pranë butisë së mullirit. Fill pas tij ishte lëshuar Luli me dy të tjerë.

– Oh!... çohuni o burra se na prenë!.... – e kishte çarë errësirën misterioze një britmë tmerri, sa që i kishte vënë në lëvizje edhe më të torturuarit, të cilët me forcat e fundit ishin ngritur në këmbë dhe kishin filluar të kërkonin nëpër errësirë ndonjë vrimë se ku të futeshin. Pasi nga dera e hapur si hije të zeza nate, hynin njëri pas tjetrit njerëz të armatosur me sëpata e thika, duke prerë e therur atë që e gjenin përpara. Dukej se në errësirë ishin ngatërruar dhe kishin sulmuar njëri tjetrin. Pastaj kishin ndezur një llambë që të shihnin e mos të thereshin ndër vete. Era e gjakut të derdhur kishte filluar të kundërmonte. Nga të çarat e dyshemesë gjaku

kishte rrjedhur mbi kokat e të strehuarve nën dysheme, duke ua futur tmerrin në palcë! Pastaj, gjaku ishte përzier me ujin e jazit. Ata që i kishin shpëtuar sulmit të parë, pasi ishte ndezur llamba, të plagosur e të mbytur në gjak, duke ulurit të egërsuar kishin sulmuar. Dikush kishte arrirë që nga njëri i vrarë gabimisht nga shokët e tij, të merrte një hanxhar e të sulej si i çmendur duke çarë drejt derës. Me goditje të shpejta kishte arrirë që tre prej sulmueseve t'i shtrinte për dysheme. Mu në prag, kur njërën këmbë e kishte hedhur jashtë, ishte goditur me sëpatë në kokë, nga njëri që kishte qenë duke ruajtur jashtë derës. Muzika kishte vazhduar me ritme të njëjta duke i shuar rënkimet e të plagosurve.

Pasi kishte përfunduar zallahia dhe në mulli nuk dëgjohej asnjë britmë apo sharje, përveç ndonjë rënkimi të venitur nga ndonjëri që ishte në grahmat e fundit të jetës, dhe ushtimës së ujit që rridhte vrullshëm nga butia, xhandarët kishin marrë urdhër nga naçallniku, i cili gjatë gjithë kohës kishte qëndruar pranë derës hipur mbi kalë duke shikuar katrahurën dhe herë pas here duke ngritur faqoren e rakisë, që t'i ngarkonin të vrarët në qerre dhe t'i dërgonin në moçalet e verrishtës.

– Nga tanët pesë xhandar kanë mbetur të vrarë! Kurse nga të ngujuarit janë vrarë të gjithë! – ishte dëgjuar një zë i thatë dhe gjithë frikë kur ju kishte drejtuar naçallnikut për raport.

– Hiqmu sysh i poshtër! S'ju vjen turp, ata të shkallmuar, të ngujuar dhe pa asnjë armë në dorë t'ju vrasin? Ikni tutje sa s'ju thera si thitë me duart e mia!...

Mal Daka kishte pri i pari. Pas tij duke e mbajtur nga krahët Lulin, kishin lëvizur Mahë Ymeri dhe Lif Leteci.

Të kërrusur nën dërrasat e dyshemesë dhe të zhytur në ujë deri në supe, kishin marrë drejtimin andej nga qemeri, ku shihej një dritë e venitur. Kur kishin pushuar zërat, të shtrirë në ujin e jazit kishin filluar të lëviznin ngadalë drejt daljes. As vet nuk e dinin se sa kohë ju kishte dashur që të largoheshin nga ai vend i tmerrit. Kur kishin filluar të këndonin gjelat e parë ata kishin sosur në katund.

*

Me të gdhirë, ishte parë gjeologu Dushko Jevtiq i shoqëruar nga Fransua Roger dhe Miliqi, duke zbritur nga vetura e majorit, e tipit: Hispano Suiza. Pasi kishin kaluar përmes Kanicave, trup fushave kishin dalë në Kryelluga. Pas tyre kishin shkuar edhe një skuadër ushtarësh. Vetura e majorit, me zhurmë ishte futur në katund. Katër skuadra ushtarësh ishin futur nga lagja e Shkozës duke marrë krahët në drejtim të qendrës. Nuk ishte lejuar asnjë lëvizje. Bastisja kishte filluar si gjithmonë e vrazhdë e me britma. Kishin arrestuar atë që e kishin takuar në shtëpi apo në rrugë. Pastaj, duke shikuar frenxhitë gjith tutë nga ndonjë tytë pushke, ushtarët me robërit e zënë ishin tubuar të hani i Babit ku i priste majori. Të lidhur ishin shtatëmbëdhjetë burra, në mesin e tyre ishin dy t'bijtë e Dautit, Shaipi e Naipi. Thuhej se ata një natë më parë kishin zbritur nga mali për të marrë bukë. Po këtë ditë ishte arrestuar edhe Keq Syku!

Tamam në kohën kur majori bëhej gati të jepte urdhrin për rreshtimin e tyre, nga lagjja e Marit ishte parë të zbriste xhandari që një natë më parë ishte

zënë rob nga Misin Kapedani. Kokë ulur, ishte nisë drejt veturës ku ishte majori. Pas përshëndetjes, me zë pëshpërime i kishte folur majorit pranë veshit. Majori kishte kërcyer nga vetura i zemëruar. Kishte dhënë urdhër për rreshtimin e të arrestuarve para skuadrës së pushkatimit. Xhandari shikonte majorin, dhe çuditej me reagimin e tij. Skuadra e pushkatimit ishte bërë gati në distancë dhe priste urdhrin për të marrë nishan. Jashar efendiu me ndrojtje i që afruar majorit. E kishte lutur që të rreshtuarve për pushkatim, t'u lejohet të paktën edhe një lutje e fundit drejtuar Allahut. Me të ishte pajtuar edhe Fransua Roger. Paksa i zbutur majori kishte pranuar. Nën përcjelljen e ushtarëve, të arrestuarit i kishin afruar pranë lumit për të marrë avdes. Pasi i kishte rrethuar ushtria nga të gjitha anët, ua kishin zgjidhur duart.

Derisa robërit ishin duke ju lutur allahut mbi barin e njomë që sa kishte filluar të gufonte në diellin e ngrohët pranveror, nga xhadeja ishin dëgjuar trokëllima e kuajve dhe zhurma mbytëse e rrotave të karrocës. Ende pa u ndalur mirë kuajt, nga dera e karrocës kishte zbrit me rrëmbim naçallniku.

– E bëtë arrestimin e atyre që kanë ikur mbrëmë nga burgu? – pyeti naçallniku.

– Jo. – ia kthej shkurt majori.

– Ku janë të ikurit nga burgu? – pyeti naçallniku kryeplakun.

– Nuk ka këtu të ikur nga burgu! – ia kthej me gjysmë zëri kryeplaku.

– Duket se janë bashkuar me çetën e Misin Kapedanit, kështu thotë xhandari i porsa liruar nga ai! – tha majori.

Xhandari shikoi i habitur majorin. Pasi hapi gojën

të kundërshtonte, shikimi i rreptë i majorit e bëri që i tulatur të ulte kokën.

Majori u afrua pranë kryeplakut. Me një shikim të rreptë u shkarkua edhe kësaj radhe urdhri i fshehët i tij. Kryeplaku e ndjeu vetën ngushtë. Si do të përgjigjej në pyetjen akoma të pashtruar, që e dinte përmendësh.

– Deri kur duhet të pres zhdukjen e atyre, ë? – pyeti majori duke bërë me kokë nga malet.

– Farën e kam hedhur gospodine! – tha kryeplaku duke shikuar drejt Keq Sykut. Pastaj, vështrimin për një copë herë e ndali mbi fytyrën vërejtur të Naipit.

– E di që e ke hedhur farën por, nuk e di se kur mbinë ajo fara jote? – pyeti majori me zë të ulët.

– E ka zor të mbijë gospodine!...

– Si?!... donë me thënë e paska zor të mbijë? E pse?

– Sepse kaçakët janë të armatosur gospodine, kurse ne!... – dhe kryeplaku rrudhi krahët duke treguar duart bosh!

– Ëhë!... kësaj radhe po! – tha majori buzagaz, duke hedhë një vështrim drejtë Kekë Ymerit që kishte zënë vend pranë bajraktarit. Pas një heshtje të shkurtër, majori vazhdoi: – Edhe ai të futët në lojë… i pari!

Kryeplaku pohojë me kokë, pastaj, për të dytën herë vështrimin plot nënkuptim e hodhi drejtë Keq Sykut, i cili shikonte drejt tij me një urrejtje të papërmbajtur. Pastaj, me një nënqeshje cinike, vështroi drejt Naipit, i cili, si të ishte fajtor uli kokën poshtë.

– Për lirimin e të arrestuarve i dua njëqind dukat! – tha papritur majori!

– Janë shumë para gospodine, nuk kemi ku i gjejmë! – tha me ndrojtje kryeplaku.

Brenda dy orësh i dua paratë! Nëse nuk i tuboni, këta do t'i pushkatoj gjithsesi! Pastaj do të jap urdhër që

nga një burrë për shtëpi të pushkatohet. Nëse ushtarët e mi nuk gjejnë burra në kullat tuaja, sigurisht se do të gjejnë gra, nuse e vajza... mua me pëlqejnë shumë nuset e bukura shqiptare dhe... e merr vesh ti se çdo të behët pastaj?! – tha buzagaz majori.

– Si urdhëro gospodine majore! – tha me gjysmë zëri kryeplaku.

Mar Rexha nuk ishte në shtëpi. Plaka e tij, e kërrusur, me dorën e majtë në ije, dhe në dorën e djathtë duke mbajtur strajcën me dukat doli në oborr. Thonin se vuante nga reumatizma. Duke tërhequr këmbën e djathtë zvarrë u afrua pranë derës së oborrit ku ishte kryeplaku me Jashar efendiun dhe me bajraktarin.

– Pa dijen e tij ua dhashë dukatet!... të shpëtojnë një herë djemtë nga plumbi, pastaj... – tha plaka me zërin e saj të mekur.

– Do t'ia kthejmë Mar Rexhës të gjitha, një për një! – e ndërpreu bajraktari me zërin e tij si bubullimë!

*

Robërit rrinin të rreshtuar para skuadrës së pushkatimit. Dukeshin si të mpirë, me fytyra të zymta e gjithë frikë. Vetëm Keq Syku mbante kokën lartë dhe vër nuk i bënte syri. Përreth tyre në distancë qanin nënat dhe fëmijët. Ukë Xhemalbashi rrinte mënjanë duke shikuar kureshtarë me sy të përlotur. Herë pas here kollitej. Sigurisht se e përgatiste zërin sepse llogaritej se pas pak do të ndodhte hataja, e pastaj ai duhej t'ia fillonte vajtimit. Qielli ishte i kthjellët. Dielli dukej se përvëlonte. Lulet dukeshin se kishin mbirë të vyshkura, disi të mjera. Tutje dëgjohej cicërima e lirshme e zogjve.

Andej nga selishta u dëgjua blegërima e një qengji.

Majori, në brendi të veturës së tij numëronte dukatet. Herë pas here vështrimin e hidhte nga Kekë Ymeri i cili dukej se ishte nën ethe. Atij nuk i pritej derisa majori të jepte urdhrin për lirimin e të arrestuarve. Por ai urdhër nuk po vinte. Si një re e zezë mbi kokat e të gjithëve vërtitej hija e dyshimit dhe e frikës. Po sikur t'i pushkatojë edhe pse i ka marrë duketët? Jashar efendiu u kthye nga Kibla. Pasi ngriti kokën drejt qiellit për t'ju lutur Allahut, në vend që nga goja e tij të dilnin lutjet tani më të mësuara përmendësh nga xhemati i tij, ai me zë të ngjirur thirri:

– Allah! Allah! Në dorën tënde jarabi!... kiameti erdhi... shikoni tutje nga Kibla... Allah mbrona nga e keqja!... si në kohën e Noas, bota po behët ujë!"

Të gjithë kthyen kokat andej nga tregonte me dorë Jashar efendiu. Vërtetë ishte një hata, e pa parë ndonjëherë. Një vrushkull i hollë uji, zgjatej nga prapa verrave dhe si një thikë e mprehët dhe e pabesë, e therte kupën e qiellit. Të gjithë për një çast harruan se ku ndodheshin. Harruan edhe të arrestuarit duar lidhur që rrinin të trishtuar dhe gjithë frikë para skuadrës së pushkatimit. Majori ndërpreu numërimin e dukateve. Me të shpejt zbriti nga vetura dhe vështrimin e hodhi nga vrushkulli i ujit që nuk kishte të sosur.

– Nafta!... jes tako mi boga!... – tha si vetë më vete, dhe këmbët e shpien drejt të arrestuarve. Në heshtje dhe me ngut bëri shënim drejt Sylë Kraqës, Tal Shulit, Naip Dautit, Cenë Mëllunganit dhe Nek Mekut. Pastaj me zë urdhërues thirri: – Këta merrini! Kurse ju të tjerët, shporruni!

– Dukatet i more për t'i liruar të gjithë gospodine!

– foli me ndrojtje kryeplaku.

– Kur të mbinë ajo fara jote, do t'i liroj edhe këta!... – ju drejtua majori kryeplakut me zë të ulët. Pastaj si i çmendur bërtiti: – Tako mi boga... nafta!

– Ndoshta ka vetëm ujë! – u dëgjua në mes të asaj zhurme të thoshte Fransua Roger.

– Ha, ha, ha!... idemo tamo!... ha, ha, ha!... tako mi boga nafta! – thirri majori dhe harroj se duhej të hipte në veturë, por ashtu i çoroditur filloj të vraponte në drejtim të verrave duke e mbajtur në njërën dorë strajcën me dukat, dhe në dorën tjetër kapelën ushtarake.

– Mbaje vetën e mos u bë qesharak para këtyre leckamanëve, gospodine majore!... – thirri me të madhe Dragomir Marianoviqi duke e mbajt nga krahu. Ai me forcë u shkëput nga dora e tij dhe si i marrë filloj të vraponte. Karroca bashkë me Van Joviqin, me Fransuan e me naçallnikun u nis pas tij. Ndërkohë, majorit ju kishte kujtuar se ndodhej me veturë, ndaj me vrap vinte drejt saj.

Derisa kryeplaku, ia zgjidhte duart Keq Sykut, i thoshte diçka më zë të ulët, dhe herë pas here e hidhte shikimin drejt Kekë Ymerit. I nevrikosur, tani më, me duar të liruara, bërtiti me zë të lartë:

– Dashtë zoti e nuk e gjënë gjë Naipin… se dikush nga ju ka me e pagu me krye! – tha kërcënueshëm duke bërë me dorë nga elita udhëheqëse e fshatit por, vështrimin plot urrejtje e kishte drejtuar nga Kekë Ymeri. Me hapa të qetë u nis drejt kullës së tij. Qëllimisht, kaloj fare pranë Kekë Ymerit. Me shikim të vrazhdë e përlau të tërin, pastaj sikur ishte duke folur me vetën e tij shfryu:

– Dikush ka me ma pa sherrin!...

KAPITULL PA NUMËR

– Të ndalët sa më parë uji!... është rrezik të shembët dheu!" – tha me dyshim e gjithë frikë gjeologu.

– Prit edhe pak! Ndoshta më vonë do të dalë vërtetë naftë! – tha majori.

– Nuk ia vlen!... të gjitha moçalet qëndrojnë pezull mbi ujë. Nëse uji del jashtë, toka do të shembët dhe kështu do të krijohet një liqe i madh, që do t'i përmbytë me mijëra hektar tokë! – foli gjeologu mospërfillës.

Majori dukej i pakënaqur. Pasi bëri me dorë në shenjë nervoze, ia ktheu krahët gjeologut. Me dukët se e ka me hile, mendoj deri sa po largohej në drejtim të karrocës ku qëndronte Van Joviqi me Fransuan. Ata shikonin indiferent.

– Të mbyllen sa më parë grykat e qyngjeve! Të hidhen sferat! – u dëgjua të jepte urdhër gjeologu.

– Keq u mashtrova!... – tha majori i zhgënjyer sikur të

ishte duke folur më veten e tij, dhe u nis drejt veturës.

Van Joviqi e shikoj me habi! Pastaj e ndoqi pas.

– Megjithatë, kërkimet duhet të vazhdojnë në zona tjera. Në bazë të shënimeve që i posedojmë, këtu duhet të ketë naftë!... mos u dëshpëro gospodine majore! – foli Fransua.

– Ikim! – tha majori dhe i pari hipi në veturë.

– S'kemi ç'të bëjmë tjetër! – u përgjigj si nëpër dhëmbë Van Joviqi dhe u nis pas tyre. Gjeologu me skuadrën e ushtarëve vazhduan përpjekjet për ta ndalur ujin!

IV

Rreth orës shtatë të mbrëmjes arriti Patriku i shoqëruar nga naçallniku. Mila u doli para. U përul me nderim dhe ia mori dorën patrikut. Pastaj i shoqëroi në dhomën e miqve. Majori, i dha shenjë patrikut, të ulej në fronin e tij të preferuar. Tamam në kohën kur majori po bëhej gati t'ju uronte miqve mirëseardhjen, në derë ia behën edhe miqtë e tij të përditshëm si: drejtori i postës me të shoqen e cila shkëlqente nga hareja, komandanti i xhandarmërisë bashkë me të shoqen. Pak më vonë erdhi drejtori i shkollës bashkë me të shoqen dhe vajzën, e cila studionte në kryeqytet dhe fill pas tyre ia behu gjeodezisti bashkë me agronomin dhe drejtorin e kadastrës. Të gjithë së bashku u vunë në pritje të ekspertëve që ditë më parë kishin arritur nga kryeqyteti. Mila i përshëndeti të gjithë veç e veç

duke përjashtuar vetëm gruan e drejtorit të postës. Majori, në shenjë mospajtimi me sjelljet e saj, tutje nga këndi, tundi kokën në shenjë qortimi. Mila as që u merakos për qortimin e tij të heshtura. Krejt në fund ajo u afrua pranë vajzës së drejtorit të shkollës, dhe për një copë herë bisedoi me të, me zë pëshpërime. Herë pas here, e hidhte vështrimin përçmues drejt gruas së drejtorit të postës, por pa e ndërpre bisedën që në një mënyrë, krijonte përshtypjen se e gjithë biseda zhvillohej kundër saj. Ajo dukej krejt e qetë. Herë pas here ngrinte vështrimin drejt majorit. Ishte hera e parë që Mila nuk bëhej xheloze edhe pse e kishte pikasur se ajo më tepër ishte e dhënë pas vështrimeve plot epsh të majorit se sa pas bisedës vesh me vesh të saj me vajzën e drejtorit të shkollës.

Edhe pse kishin kaluar plot një muaj qysh nga ardhja e ekspertëve, ishte hera e parë që Mila do të takohej me ta. Kjo ishte ngjarja më e bukur që ia sillte stina e pranverës. Parafytyrimin për pamjet e tyre, me kohë i kishte plotësuar nga gruaja e naçallnikut, e cila jo vetëm që i kishte takuar por, edhe kishte biseduar me ta për shumë tema. Ajo i kishte thënë se ekspertët do të bënin një punë të pastër, pa u futur në krime siç ishte futur burri i saj duke vrarë e masakruar njerëz!... edhe Mila nga ana e saj, ishte përpjekur që sado pak ta shfajësonte majorin a saj, se puna e tij ishte të vente qetësinë pa bërë arrestime dhe pa vrarë njerëz!

E shpërqendruar Mila, sa shkonte në kuzhinë duke dhënë udhëzimet e nevojshme kuzhinierëve dhe dy shërbëtoreve të cilat kishin filluar t'i përgatisnin pjatat, sa futej në dhomën e miqve, duke dëgjuar copa bisedash të politikës ditore që Milës i dukeshin të vjetruara.

– Janë nxituar duke dhënë lajme të pabaza se gjoja në rrethin ton qenkan kryer masakra! – fliste si me vete naçallniku.

– Ne nuk kemi dëgjuar për ndonjë vrasje të ketë ndodhur këtej pari, kurse ata pa asnjë argument na qortojnë për masakra!... – ia priste komandanti i xhandarmërisë duke tundur kokën.

Mila ndjeu neveri nga këto biseda. Ishte dëshmitare e përditshme e ngjarjeve rrëqethëse të shkaktuara pikërisht prej tyre, kurse këtu me cinizëm i mohonin, duke u përpjekur ta bindin njëri tjetrin se ishin engjëj.

E veshur me fustanin e mëndafshtë, ngjyrë vjollce që i rrinte freskët në trup, të porositur enkas për këtë mbrëmje, pa u vërejtur nga të tjerët doli në sallonin përballë. Flokët i kishte rregulluar bukur dhe i kishte lidhur lartë me fjongo, duke zbuluar qafën e butë që mbulohej vende-vende nga krelat e lëshuar enkas. E dinte se këtë stil të rregullimit të flokëve e dëshironte majori por, sonte nuk i kishte rregulluar flokët sipas dëshirës së tij. Pa dashur kthej kokën prapa për të parë nga gruaja e drejtorit të postës. U tmerrua kur e pa se edhe ajo kishte rregulluar flokët në të njëjtin stil. E hetoj vetën se nuk do të përmbahej dot nga xhelozia, ndaj doli në korridorin e gjerë. Në qetësinë e thellë që mbretëronte në korridor copat e çrregullta të bisedave, vinin deri aty. Bisedonin për dështimin në zbulimin e nxjerrjes së naftës gjë që majorin e kishte bërë si të çmendur. Për një çast ju bë se ato biseda ishin aq banale sa nuk ia vlente as të dëgjoheshin. Si me naze hyri në dhomën e saj. U afrua pranë pasqyrës. Duke menduar se krehja e flokëve në një stil tjetër do t'i merrte shumë kohë, për të dytën herë mori në dorë të kuqët dhe filloj

t'i lyente buzët. Pastaj vuri rimelin rrotull syve dhe në fund kur ishte duke e shpërndarë kremin e bardhë në faqe u dëgjua trokitja në derë. Erdhën, mendoj me vete dhe sakaq u pa pranë derës ku njëra shërbëtore kishte arritur para saj dhe ua kishte hapur derën. Me një shikim të rreptë i përlau të porsa ardhurit. Për pak sa nuk klithi nga zhgënjimi. Në dritën e zbehtë të llambës, fytyrat e të porsa ardhurve ju dukën disi të shëm... (dhe në çast ju largua fjalës "shëmtuara" nga frika se kjo fjalë ishte vulgare, dhe si fije e hollë tymi do të shpërndahej gjithandej duke ia shëmtuar vërtetë gostinë aq të pritur). Asnjëri nuk ishte siç i kishte imagjinuar. Megjithatë, vështrimi i mbeti i mbërthyer në fytyrën e bardhë të Fransuas, që në dritën e zbehtë të llambës dukej e zbehtë. Pastaj, vetëtimthi e shikoi Sergej Ivanovin. Ndërkohë në korridor dolën për t'i pritur veç majorit, edhe patriku me naçallnikun. U përpoq ta merrte vetën për të mos e vërejtur të tjerët trazimin e saj. Vërtetë nuk e dinte se cili ishte francezi apo rusi por, në bazë të përshkrimit që ia kishte bërë më parë gruaja e naçallnikut, ai duhej të ishte francezi. Kurse rusi duhej të ishte ai fytyrërrumbullaku që i rrinte për bri Van Joviqi, i cili kishte një pamje edhe më të çuditshme se të rusit; me fytyrë të gjatë, me qime të rralla e të gjata, e me pikla në faqe (disi ia kujtoj pamjen e miut). Trazimi që ju shkaktua në shpirt ndodhi menjëherë pas vështrimeve të rrepta dhe plot mirëkuptim të Fransuas. Ishin shikime epshore që nuk i kujtohej në i kishte përjetuar ndonjëherë në jetën e saj. Sakaq, mendja i shkoj të majori dhe dashuria e dikurshme ndaj tij! Vallë, si e kam dashuruar majorin dikur?... Në imagjinatën e saj tani filloj t'i plotësonte

zbrazëtirat e imagjinuese me ato reale duke nxjerrë një ndërmjetësim që në moment i erdhi aq i këndshëm sa në mes të gjoksit ndjeu një drithërimë kënaqësie. Pritej që për shkak të këtij trazimi t'i kalonte edhe disa net të tjera pa gjumë.

Me këto mendime ia zgjati dorën së pari Fransuas.

– Milica, – tha me një përulje të lehtë.

– Enchanté de vous connaître, Madame, Fransua Roger![5] – tha ai me një vështrim epshor. Të paktën kështu ju duk Milës.

S'qenkam gabuar! Ky qenka francezi!" – mendoj pas pak, derisa ata vazhdonin të përshëndeteshin me të tjerët. Ky qenka pra ai, që i shtrirë në shtrat duhej të me priste duke me shikuar plot epsh!... – oh, sa budallaqe që bëhem! – mendoj duke u skuqur lehtë, sikur mendimin e saj ta kishin kuptuar edhe të tjerët.

Ndërkohë, të porsa ardhurit kishin përfunduar përshëndetjet e zakonshme dhe kishin zënë vend rreth tryezës. Befas ra heshtje. Ishin çaste momentale që të porsaardhurit si edhe ata që kishin qenë në pritje, po kalonin minutat e vështira, ato të humbjes së fillit të bisedës. Çdo njëri mendonte në vetën e tij se cila bisedë do t'i përshtatej thyerjes së heshtjes mbytëse dhe, rrethit të miqve me ngritje ekspertesh. Van Joviqi shikoi nga Mila, dhe si pa të keq vuri buzën në gaz. Pastaj rrotulloj vështrimin edhe nga të tjerët pa e ndërruar aspak buzëqeshjen që të pranishmëve ju bë se ajo buzëqeshje ngadalë e humbiste freskinë. Sikur ta kishte pikasur i zoti i shtëpisë se akoma pa filluar darka festive që e kishte përgatitur enkas për miqtë

---

5 *Frengjisht: Gëzohëm që ju njoha, zonjë, Fransua Roger*

e tij të zgjedhur, disi kishte filluar ta merrte kahen e përfundimit të saj dhe, të pranishmëve nuk u mbetej gjë tjetër veçse të ngritshin dhe njëri pas tjetrit të zhdukeshin në errësirën e asaj mbrëmje pranvere, që sa kishte filluar të trashej. Në ndërkohë shërbëtorët kishin filluar t'i sillnin pjatat e mbushura me thela mishi të pjekur. Majori u ngrit në këmbë.

– Çfarë dëshironi të pini patër? – pyeti majori patrikun.

–Verë, ju lutëm!... – foli patriku duke e fërkuar mjekrën lehtë me pëllëmbën e dorës së majtë, kurse në të djathtën mbante gotën derisa majori ia mbushte.

– Po ju, verë dëshironi? – pyeti Fransuan që kishte zënë vend pranë patrikut.

– Ju lutëm!... – u përgjigj Fransua.

– Është verë katërvjeçare, e prodhuar nga gjyshi im! – foli majori kur ishte duke ia hedhur verën në gotë Van Joviqit.

Biseda për pijet sikur i çliroi të pranishmit. Patriku foli për prodhimin e verës. Me një mjeshtri të rrallë te të folurit ai pohonte se verën e kishin pru sllavët e ndritur kur kishin zbritur në gadishull, duke ua dhënë si dhuratë vendasve të paditur e kanibal. Van Joviqi e kundërshtoj butësisht duke thënë se sipas gjetjeve arkeologjike dhe sipas shënimeve të autorëve të lashtë grek vera kishte ekzistuar tek ilirët qysh në kohën e Homerit, bile edhe para tij. Derisa ishte duke folur Van Joviqi për Homerin dhe për verën, befas syri i zuri një vështrim të rrufeshëm që majori ia hodhi Patrikut, i cili ishte i vetmi që e dinte qëllimin e kësaj darke. Pas përfundimit të fjalës askush nuk e kundërshtoj por, as nuk e miratoj atë që Van Joviqi e tha, por nga heshtja

kuptohej se ata nuk ishin të kënaqur me fjalën e tij. Këtë më se miri e shprehnin fytyrat e tyre të thartuara. Heshtja filloj të trashej. Sikur mos të ishin shërbëtorët që tani më e kishin mbushur tryezën me pjata dhe gotat me verë, të pranishmit edhe për një kohë të gjatë nuk do të gjenin fillin e vazhdimit të bisedës.

– E përmendët Homerin gospodine Joviq? Kohë të gjatë jam marrë edhe unë me studimin e veprave të tij. Janë të mrekullueshme, apo jo? – e theu befas heshtjen vajza e drejtorit të shkollës.

– Ato janë kryevepra në letërsinë e vjetër botërore!...

– Për shëndetin tuaj! – ju drejtua majori Patrikut, duke ua ndërpre bisedën, pastaj me gotën në dorë u ngrit në këmbë. Pas tij u ngritën edhe të tjerët.

– Ziveli! – u përgjigjen të pranishmit duke cakërruar gotat së pari me Patrikun e pastaj me njëri-tjetrin.

– Si shkojnë punët me grumbullimin e antikave? – pyeti pa të keq drejtori i shkollës Van Joviqin.

– Të them të drejtën kur filluam nga mbledhjet pata përshtypjen se ky plan do të shpallej i dështuar që në fillim por, pasi u hodha vet në aksion duke përdorur autoritetin e prijësve të tyre, kam arritur të grumbulloj antikë me vlera të papërshkrueshme, dhe me domethënie të madhe për historinë!...

– Po me gërmimet kurë do të filloni? – pyeti prapë drejtori i shkollës.

– Së shpejti. I kemi edhe ca përgatitje anësore që do t'i kalojmë shpejt.

– Kam informacione se manastiret tanë në përgjithësi po dëmtohen shumë nga shqiptarët kohëve të fundit! Çmendoni ju për këtë fenomen? – pyeti drejtori i shkollës hetueshëm.

– Po, si të them! Për këtë më së miri mundë të përgjigjet patriku. A po jo patër?

– Unë i kam vizituar po thuaj të gjitha manastiret. Duke vërejtur banorët shqiptarë përreth tyre unë kam mendimin se shumë mirë janë ruajtur! Në Serbi, manastiret dhe kishat tona janë në gjendje edhe më të mjerë se këtu, kur dihet se atje nuk ka shqiptar! Kjo tregon se ndjenja fetare të ne nuk është as e thellë e as e ngrohtë. Kishat tona, në përgjithësi, janë të zbrazëta, me përjashtim të kremteve të mëdha fetare, apo kremtimeve politike! – foli patriku me gotën e verës në dorë, pastaj vazhdoi: – Ne e konsiderojmë kishën si një institucion politik, në një farë mënyre misterioz, që lidhet me ekzistencën e kombit tonë. Tani, kishat nuk sulmohen nga askush. Besimtarët megjithatë, nuk i vizitojnë! disi janë të harruara!...

– Ashtu është vërtetë! Besimtarët nuk i vizitojnë! – i përsëriti fjalët e patrikut drejtori i postës.

– Është e vërtetë se besimtarët nuk i vizitojnë kishat, por megjithatë shkatërrimet janë evidente... dhe ky shkatërrim e ka zanafillën që nga kohërat e lashta!... Do ta sjell si shembull dëmtimin e syve të afreskës së Simonidës në Manastirin e Graçanicës. Nuk e di sa e ke vërejtur ti këtë dëmtim të tmerrshëm! – foli me ironi drejtori i shkollës.

– Ky dëmtim nuk i përket kësaj kohe! Kam lexuar edhe studime arkeologjike dhe variantet e pranuara shkencërisht mbi dëmtimin e syve të afreskës. Njëri variant thotë se... – ndërhyri kësaj radhe Van Joviqi.

– E di se çfarë dëshiron të thuash! Ato janë gjepura! Variantin më të besueshëm e jep poeti ynë i mirënjohur Rakiq, kur thotë:

T'i nxorën sytë e bukura, pikturë
Një natë shqiptari, i mbrojtur nga terri
Në kishën e vjetër, aty mbi mur,
Me maje të thikës të dy sytë t'i theri.

– Mos u nxito o i uruari i perëndisë! Edhe gospodin Joviq ka të drejtë kur thotë se...

Për të dytën herë pa majorin që me një vështrim të rrufeshëm e përlau drejtorin e shkollës i cili në heshtje uli kokën. Pastaj ju drejtua patrikut duke ia ndërpre bisedën:

– Nuk dua biseda politike patër!

– Si urdhëro gospodine majore! – foli patriku me zë nënshtrues.

Midis këtyre vështrimeve edhe kësaj radhe u shkarkua urdhri i fshehët e plot nënkuptim i majorit. Hëm, bëri me vete patriku. Ky është mësuar vetëm të jap urdhra e të tjerët t'i zbatojnë!

Të njëjtin vështrim majori ia hodhi edhe naçallnikut, i cili ishte bërë gati të fliste diçka. Ai uli kokën i bindur, edhe pse akoma nuk ishte në rrjedhën e ngjarjes. Tek ai nuk kishte shoshitje dhe kthjellim të gjërave. I merrte të trasha dhe ashtu i zbatonte. Dredhitë, pusitë, grackat për të ishin tabu, jo që nuk i dëshironte por, se në këtë pikë ishte tejet i dobët. Grackat dhe pusitë që i përgatiste majori kundër atyre që i kishte vënë më parë në lojë, ishin aq bukur të kombinuara me njëra-tjetrën sa që ishte e pamundur të zbuloheshin paraprakisht. Bile kishte nga ata që edhe pasi kishte përfunduar çdo gjë, akoma nuk e kishin të qartë së çfarë ju kishte ngjarë në të vërtetë!

Mila akoma nuk kishte pasur një moment të përshtatshëm të inkuadrohej në bisedë me të huajt,

veçmas me Fransuan. Kishte vërejtur se bisedat e të ftuarve kishin pasur një dozë të tepruar nervoze. Për një çast e kishte ndjerë vetën të lumtur që Fransua nuk kishte folur. Kishte një parandjenjë të mrekullueshme për burrat e heshtur. Ata vërtetë nuk flasin në raste të tubimeve apo festave por, në raste të veçanta intimiteti ata veprojnë pa hezitim. Në rrethe të ngushta ata quhen dinak! Dhe pikërisht kjo dinakëri, e kishte joshur drejt majorit dikur, kurse sot e tërhiqte drejt francezit të heshtur!

Patriku, më në fund e pa të nevojshme ndërhyrjen e tij. Në raste të tilla kur gjatë bisedave fillonin grindjet, ai ndërhynte qetë dhe, me zërin e tij të butë, me fjalët e matura që në to kishte diçka hyjnore ua flladiste zemrat të pranishmëve. Ai në asnjë rast nuk gabonte të mbante anën e ndonjërit por, duke gërmuar në të kaluarën e lidhte bisedën më të tanishmen duke ruajtur gjithmonë neutralitetin. Pasi që, përmes mimikës mori miratimin e majorit filloi të fliste:

– Arritja e arkeologëve në këto treva është e mirëseardhur për ne! Edhe ardhja e ekspertëve nga shtetet mike kanë një domethënie të madhe. Vet puna e tyre për grumbullimin e antikave në masën e gjerë të popullit është një punë e madhe. Se për çfarë flet antika, për çfarë flet arkeologjia nuk ka ndonjë rëndësi të madhe. Rëndësi të madhe ka se çfarë do të flas gjeologjia. Këtë e thash për t'ju sqaruar se dy të parat i takojnë të kaluarës, kurse kjo e fundit i takon ardhmërisë, pra, atyre që po lindin në këto troje. Hë, si thua ti? – ju drejtua drejtorit të shkollës!

– Ashtu është Patër! – u përgjigj ai.

– Sikurse njeriu që lind, rritët, zhvillohet dhe vdes,

ashtu janë edhe popujt të cilët lindin, zhvillohen dhe në fund vdesin! Ja për shembull, Van Joviqi bënë gjurmime mbi civilizimin e një populli të lashtë i cili me shekuj ka jetuar në këto treva, kurse tani ndodhët në shtratin e vdekjes. Këtu nuk ka asgjë të keqe, përkundrazi, ka vetëm dobi. Popullit të vjetër do t'i ofrohet me zemërgjeri nga ana jonë e kaluara e tij, për të cilën ai nuk di asgjë! Gjatë shekujve të ekzistimit të tyre si etnitet ata nuk kanë treguar as më të voglin interesim për shkrim e lexim, sepse raca e tyre nuk është inteligjente. Është një racë me ca tipare të ciganit, me trup të shkurtër e të thatë që t'i kujtojnë fenikasit apo njerëzit primitiv që flinin nëpër lisa duke u mbajtur për bishti! Ju jeni dëshmitarë të përditshëm! I takoni në rrugë, në arë, në mal!... Ashtu siç thash edhe më parë, të rreckosur e trup thatë, të veshur me rroba të gjata që i përdorin për ta mbuluar prapanicën, të bëjnë përshtypjen se nuk i takojnë racës njerëzore! Gjatë shekujve ata zbritën nga malet duke pushtuar fushat tona të buta. Kulmin e barbarisë ata e arritën me fitoret e tyre në luftë, ku si shpërblim fituan jo vetëm pushtetin por edhe shtëpi dhe pasuri! Prandaj, problemi i tyre në shtetin serb nuk është i tanishëm dhe i rastit. Ky është problem që vazhdon që nga mesjeta kur ata të rreckosur e barkthatë arritën t'i shpërngulin me qindra e mijëra familje serbe drejt veriut! Tani ka ardhur koha e rikthimit të identitetit tonë! Rikthimin e pasurisë dhe tokave tona. E gjithë kjo arrihet me përpjekje dhe luftë të pandërprerë kundër tyre. Është e udhës që ne të jemi të bashkuar, e jo të ndarë në grupe e mëdyshje politike! Nuk dua të zgjatëm më shumë në këtë temë, por dua t'i falënderojë përzemërsisht miqtë tanë rus e

francez, si dhe ekspertët tanë që kanë ardhur këtu për zbulime të reja, për të cilat ka shumë nevojë shteti ynë. Në mënyrë të veçantë e falënderojë Van Joviqin i cili me punën e tij fisnike për një kohë kaq të shkurtër ka arritur, që të vërtetoj prezencën tonë shekullore në këto troje! – tha patriku dhe me nderim u ngrit në këmbë duke ia zgjatur dorën në shenjë përgëzimi Van Joviq. Të pranishmit duartrokitën.

Fill pas tij e mori fjalën majori. Vështrimin e mbante të mbërthyer mbi fytyrën e shpërqendruar të Van Joviqit.

– Shteti po merret me ri kolonizimin e tokave tona të vjetra, të uzurpuara arbitrarisht nga shqiptarët. Ashtu siç tha më parë patriku, ne duhet t'i rikthehemi identitetit tonë. Kam përshtypjen se aparati i kolonizimit është i shtrenjtë dhe i fryrë tej mase. Ky aparat është i mbushur me njerëz të pa ndërgjegjshëm, të papërgatitur nga ana profesionale, mendje mëdhenj e të paaftë. Kur i them këto kam parasysh rritjen e theksuar demografike të shqiptarëve, dhe konditat gjithnjë e më të vështira të kolonizimit serb sipas metodave të vjetra, të Karagjorgjit e Jovan Ristiqit. Në vitet e ardhshme ky proporcion do të zmadhohet duke i vënë në pikëpyetje edhe ato pak suksese të gjertanishme. Rrjedhimisht lind pyetja: Çfarë duhet bërë përveç propagandës fetare dhe shtytjes efikase nga organet kompetente për shpërnguljen e shqiptarëve nga tokat tona? E para nga të gjitha është puna e akademikëve të nderuar, puna e historianëve, e arkeologëve... – dhe vështrimin urdhërues e plot nënkuptim e ndali mbi fytyrën e hequr të Van Joviq, dhe vazhdoj: – ...të cilët kanë për detyrë që shqiptarëve t'ua shpien prejardhjen andej tutje nga Azia,

dhe aziatikët, dua të them, sllavët, t'i fusin në djepin iliro-dardan si vezët e qyqes në fole të huaj. Edhe në qoftë se këto „të arritura shkencore" nuk janë bindëse për momentin, mjafton të sjellin huti e polemika në instancat më të larta evropiane të shkencës, gjersa ne t'i sjellim gjërat në aktin e kryer. Dhe në anën tjetër, puna e atyre që veprojnë në terren është që, pa humbur kohë të riorganizohen dhe t'i vazhdojnë aksionet e vjetra çetnike dhe të njëjtat të ndihmohen fshehurazi. Të lëshohen valë malazezësh të tipit „haramash" të cilët do të nxisin konflikte e turbullira, dhe të njëjtat të shuhen pastaj me mjetet më efikase, e veçmas përmes kolonizuesve, fiseve malazeze, grupeve çetnike dhe bandave të komitëve hajdut!...

Majori vazhdoi edhe për një copë herë të fliste duke treguar numra dhe shifra të kolonëve dhe të shpërngulurve. Ishte i pakënaqur me punën e ministrisë së ndarë që merrej vetëm me kolonizimin. Shifrat dhe numrat që i jepte majori favorizonin epërsinë e shqiptarëve në krahasim me serbët të cilët akoma kishin mbetur pakicë absolute!

Pas përfundimit të fjalës nuk pati duartrokitje. Heshtja që ra pas fjalëve pesimiste të majorit dukej se gërryente edhe atë pak dritë të venitur që lëkundej trishtueshëm në faqet e mureve të heshtura.

Me gotën e verës në dorë u ngrit në këmbë gruaja e drejtorit të postës duke ju drejtuar së pari patrikut, dhe pastaj të tjerëve. Vështrimin e ndali pikërisht mbi fytyrën e Fransuas duke e shikuar me buzëqeshje.

– Për shëndetin tuaj, e mirë se na keni urdhëruar!

– Santé!... – ia ktheu Fransua me buzën në gaz, dhe vazhdoj: – Ju jeni e Zonja e shtëpisë?

– Ah, jo zotëri! Edhe unë jam e ftuar! – tha ajo pak e skuqur dhe padashur vështrimin e hodhi drejt Milës, të cilës i buzëqeshën sytë!

As kjo replikë e shkurtër nuk i shpëtoj majorit. Pasi gruaja e drejtorit të postës u ul në vendin e saj, majori hodhi vështrimin drejt Milës e cila akoma e kishte atë shikimin e papërqendruar dhe indiferent ndaj atyre që e rrethonin, e sidomos ndaj tij. Duke qëndruar në këmbë pas krahëve të Van Joviq fare rastësisht, hodhi një shikim të prushtë drejt Fransuas. Majorit i pëlqej ky stil i saj dhe, u çudit me veten që nuk po bëhej xheloz! Ato shikime të saj do ta mbanin edhe për një copë herë të mbërthyer francezin, mendoj vetëtimthi. Ajo vepronte tamam sikur ta kishte porositur vet dhe, befas ju kujtua nusja e bukur e atij fshatarit që e kishte detyruar t'i shërbente deri rreth mëngjesit. Hëm! Nuk pranoj në asnjë mënyrë i poshtri të ma lëshonte në dorë atë perri! Do ta gjejë rastin një herë tjetër dhe... Hëm! Pastaj si pa dashur shikoj nga ora e madhe e varur në mur. U çudit kur pa se koha kishte ecur aq shpejt. Ora kishte arritur në njëmbëdhjetë e tridhjetë.

Majori afrohej sa të njëri e sa të tjetri duke shpërndarë fjalë të ëmbla dhe buzëqeshje dashamirësie. Dhe kishte të drejt, kur mendonte se planet e tij do të zbatoheshin një për një nga dy spiunët e tij të regjur. Kishte vite që ata vepronin në vende e rrethe të ndryshme. Kryenin punë shantazhi e përgjimi, duke i vënë të dyshuarit në lojë, pa marrë parasysh se cilit etnitet, apo funksion i takonin. Të veshur me rroba shqiptarësh dhe të mbuluar me japanxhe të zeza vepronin nën urdhëratë e tij. Në raste të veçanta merrnin dhe zbatonin urdhra edhe nga patriku. Në rast rreziku, ishin të mbrojtur

nga një skuadër besnike ushtarësh. Në netët e errëta e pa hënë, shfaqeshin aty ku nuk pritej duke lënë lloj-lloj përshtypjesh. Shqiptarët praninë e tyre e lidhnin me besimet e tyre besëtyte, kurse serbet i kishin trajtuar si metodë e re lufte kundër shqiptarëve. Serbët kishin ndërruar mendje kur ishin goditur edhe njerëz me pozitë në sektorë të ndryshëm si naçallniku i Gjakovës, komandanti i xhandarmërisë në Pejë, hapja e varrezave të freskëta, nxjerrja e kufomave dhe përzierja me kufomat e masakruara të familjes Galiq! Pastaj, plaçkitja e karrocierit kur sillte postën bashkë me rrogat e nëpunësve. Për të gjitha këto kishin dyshuar se këto grupe vepronin të pavarura dhe qëllim kishin hajdutërinë!

– Unë mendoi se tokat e përmbytura, kënetat e moçalet nuk kanë ndonjë vlerë për ne! Prandaj, dalja e ujit në sipërfaqe nuk do të kishte gjë të keqe, nëse vërtetë aty ka puse nafte! – u inkuadrua në bisedë gjeodezisti. Ai nuk e kishte zakon të ndërhynte në biseda politike. Më tepër do t'i pëlqente të bisedonte për tokën dhe reformat agrare që ishin në zbatim e sipër. E ndjente punë të vështirë jo matjet apo ndarjet në parcela të tokave për kolonët por, sajimin e arsyes së shpronësimit të pronarëve legjitim. Kjo i kishte sjell kokëçarje deri sa ishte detyruar që kompetencat t'ia jepte agronomit dhe drejtorit të kadastrës.

– Të them të drejtën unë nuk kam kompetenca të nxjerrë ndonjë pus uji, apo nafte në sipërfaqe. Detyrë imja është të hulumtojë në ato vende që janë të skicuara në hartat që i disponoj, dhe pastaj vlerësimi: ka apo nuk ka naftë! A po jo Fransua? – tha gjeologu duke vënë buzën në gaz.

– Oui! – u përgjigj Fransua shkurt.

– Si!? Ju do të ikni që këtej? – ndërhyri Mila, duke menduar se ata do të largoheshin!

– Po zonjë! Bashkë me Van Joviqin për gërmime arkeologjike! – u përgjigj Fransua ngrohët. Për një copë herë ai lëbyri sytë kënaqshëm mbi gushën e saj të bardhë! Milës i pëlqej shikimi i tij. Një drithërimë e lehtë ia përshkoj tërë trupin. Nga fjalët e tij i erdhi zemra në vend. Duke e larguar nga vetulla ballukun e flokut, ashtu si me naze, u kërrus pak drejt tij duke larguar filxhanin e kafesë. Pa e larguar shikimin nga fytyra e tij, ajo u tërhoq prapa. Pati përshtypjen së këtë veprim të saj e kishin pikasur edhe të tjerët, ndaj largoi vështrimin nga fytyra e tij duke u skuqur lehtë. U çlirua kur papandehur foli eksperti rus.

– Në cilat vende mendohet të ketë naftë? – pyeti eksperti rus.

– Naftë!? Mendohet se ka në shumë rrethe. Shenjat e para janë inkurajuese!...”

Mila, pasi e kishte marrë filxhanin e kafesë në dorë, me përtesë u nis drejt kuzhinës. Porsa doli në korridor vërejti patrikun që nuk ishte vërejtur se kurë ishte ngritur nga tryeza, dhe kishte dalë në korridor pranë majorit. Rastësisht ia kapi veshi fjalët:

– … si shumë janë vonuar. Kam frikë mos u ka ndodhë gjë e papritur!...

– Nuk e besoj! Sigurisht se s’kanë filluar… – fjala i mbeti në grykë majorit. Një krismë pushke e bëri të tkurrej. Në saje të shikimit drejtuar patrikut u shkarkua ndjenja e gëzimit dhe buza i shkoj në gaz. Edhe patrikut i ndriti fytyra. Të shtënat sa vinin e shtoheshin.

Milës i ra filxhani nga dora! Vrapoj në dhomën e

pritjes duke vënë perdet e trasha në dritare. Pastaj, ashtu e frikësuar ia uli fitilin llambës duke krijuar një dritë të venitur sa të pranishmit mezi e dallonin njëri-tjetrin.

– Do të mbetemi sonte këtu! – tha ankueshëm gruaja e drejtorit të postës.

Mila e shikoj me urrejtje. Pasi drita ishte e dobët, shikimi i saj nuk u vërejt prej askujt, bile as prej asaj që ju drejtua. Të shtënat sa vinin e shtoheshin. Biseda ishte ndërprerë.

Mila qëndronte në këmbë pas shpinës së Fransuas. Vërtetë kishte pasur frikë nga të shtënat por, jo edhe në atë masë sa ishte dukur nga të pranishmit. Këtë e kishte bërë me qëllim që të gjente një shkak sado të vogël dhe ‚krejt rastësisht' të ishte e mbrojtur nga Fransua. Edhe Fransua sikur ta kishte kuptuar se çfarë e mundonte Milën, ishte ngritur në këmbë dhe porsa ishte kthyer në anën tjetër rastësisht ishte ndeshur trup me trup me të.

– Duket se kaçakët kanë zbritur për të plaçkitur dhe, janë hetuar nga rojet tona. – tha majori.

– Ju mos u shqetësoni aspak. Ata janë pak dhe në raste të tilla ata tërhiqen menjëherë në male. Ne do t'i intensifikojmë operacionet tona të ndjekjes derisa t'i zhdukim! – tha komandanti i xhandarmërisë.

Pas një heshtje të gjatë trokiti dera. Majori u ngrit dhe doli. Fransua u kthye, dhe u ul në vendin e vet. Që poshtë nga fundi i shkallëve dëgjohej një lloj raporti. Fjalë të ndërprera arrinin gjer në dhomën e pritjes. Milës ju bë se ishte zëri i Miliqit. Shumë herë e kishte pikasur kur ai bashkë me Keq Sykun sorollateshin rreth shtëpisë së tyre. Për këtë e kishte njoftuar majorin. Ai kishte qeshur

me të madhe, dhe pastaj i kishte thënë: „Fëmijë do të mbetesh gjithë jetën!... akoma si kupton fshehtësitë ushtarake!...” – dhe me gishtat e dorës së majtë e kishte tërhequr lehtë nga hunda me dashamirësi!

– ... pastaj kanë sulmuar zyrat e ekspertëve!... kanë dëmtuar... e sallës, … pas të shtënave, janë tërheq drejt burimit… janë vrarë civil serbë... një është zhdukur!...

– Si!?... civil serb të vrarë? – u dëgjua zëri hakërrues i majorit.

– Po, gospodine majore, ndërsa njëri nga ata, arriti të zhdukët!... – kësaj radhe erdhi zëri më kumbues i raportuesit.

– Si?... një është zhdukur? Është e mundur kjo? Të vazhdojnë ndjekjet... edhe ushtria të vihet në ndjekje! – tha majori i shqetësuar tej mase. Buzëqeshja, që pak kohë më parë ia kishte ndritë fytyrën ju zhduk sakaq dhe, vendin e saj e zuri një zymtësi e përzier më nervozë që, as nga të pranishmit nuk e fshehte dot. Kishte frikë se mos kishte ndodhur ndonjë e pa pritur dhe planet e tij do të viheshin në dyshim.

– Të sigurohet vendi i ngjarjes nga ana e xhandarëve, kurse pjesa tjetër të vihet në kërkim të arratisurit! – ndërhyri me zërin e tij të vrazhdë komandanti i xhandarmërisë, edhe pse nuk e kishte akoma të qartë se përse duhet të kërkohet dhe të arrestohet civili serb që i kishte shpëtuar çuditërisht vrasjes! Ai pa e bërë të gjatë, me pallton nën sqetull dhe me kapelën në dorë, zbriti shkallët. Pas e ndoqi majori me patrikun.

Të pranishmit, në dhomën e pritjes mbetën si të nemitur. Ata nuk dinin si të silleshin. Të rrinin e të prisnin majorin, të vazhdonin me pijet që ju kishin mbetur të përgjysmuara apo, të çoheshin dhe njëri

pas tjetrit të zhdukeshin në errësirën e frikshme e misterioze të natës. Fjalët, në këto momente frike misterioze ishin të tepërta. Pas një shikimi pyetës, Van Joviqi u ngrit i pari. Pas tij u ngrit drejtori i shkollës dhe fill pas tij, të gjithë të pranishmit! Ashtu të heshtur, njëri pas tjetrit dolën në korridorin e gjerë. Pasi i uroj natën e mirë zonjës së shtëpisë, drejtori i shkollës filloi t'i zbriste shkallët e drunjta. Të tjerët e ndoqën pas, duke u radhitur njëri pas tjetrit. Në fundin e shkallëve u dëgjua cijatja e derës që njëri nga shërbëtorët ua kishte hapur. Krejt i fundit, bile pak i vonuar nga të tjerët doli Fransua. Van Joviqi e priste në krye të shkallëve. Fransua ia bëri me shenjë që ai të ecte para tij. Pasi i uroj Milës natën e mirë, e ndoqi Van Joviqin pas. Pa i kaluar dy hapa, ndaloj dhe u kthye drejt Milës. Me një shikim të zjarrtë e mbështolli gjithë qenien e saj.

– Mirë u pafshim zonjë e nderuar! – tha si nëpër dhëmbë për të dytën herë, dhe për një copë herë mbeti si i shtangur, pa luajtur nga vendi, duke e shikuar Milën ngultas në sy! Edhe ajo vazhdonte t'a shikonte me po atë epsh. U përmend pasi dëgjoi cijatjen e derës që po mbyllej. Fransua ju dha këmbëve teposhtë shkallëve. Shërbëtori plak, i befasuar që e kishte mbyllur derën pa dalë të gjithë mysafirët, e hapi prapë. Jashtë derës e priste i vetëm Van Joviqi.

*

Mila e ndjente vetën të lodhur. E shpërqendruar u shtri në shtrat. Herë pas here si nëpër ëndërr i hapeshin pamjet e të ftuarve në sallon, ku kishin qëndruar me orë të tëra miqtë dhe kolegët e majorit, të ulur gërmuq rreth

tryezës. Një, si re e frikshme i rrinte pezull mbi kokë dhe, kishte përshtypjen se pas gjithë atyre të shtënave kishte diçka misterioze! Civil serb të vrarë?... ishte e mundur vallë? Që nga koha e ardhjes së saj në këtë provincë të humbur, nuk kishte dëgjuar ndonjëherë të kishte pasur civil serb të vrarë! Megjithatë!... nga fundi i darkës, edhe pse pati të shtëna të frikshme, e kishte ndjerë vetën mirë, disi si në përrallë!...

Errësira e plotë, dhe qetësia absolute që mbretëronte në atë kullë të uzurpuar shqiptare, i dha shkak të kridhej ne kujtime të ëmbla të dashurisë. Ju bë se zemra ju gudulis nga kënaqësia, tamam si në kohën kur ishte vajzë. Pasi u rrotullua në krahun tjetër, si pa dashur pyeti vetën: „Vallë, ç'bënë ai tani? Ku ndodhët? A me kujton?!... Je vous aime, Madame!"

V

Kodra në krye të katundit ju duk e lartë, disi e pa arritshme. Rruga që shpinte atje, ishte me gurë të imtë dhe e veshur me një shtresë të hollë pluhuri të lagshtë nga vesa. Gjurmët e opingave të mihësve, që tani më kishin pushtuar kodrën, ishin të dukshme. Padashur shikoj nga patriku. Edhe ai ishte mbushë frymë. Sikur shikimi i tij ta kishte urdhëruar që të ndalej, patriku për një çast ndaloj hapat. Pas tij u ndal edhe vet. Pasi u kthye nga fshati, shikimin e hodhi poshtë. Kullat me frëngji ju dukën edhe më të frikshme, disi të pabesa. Poshtë pranë portës së xhamisë, pa një grumbull burrash. Ata qëndronin në këmbë duke shikuar drejt tij. Ju dukën të shkretë me ato fytyrat të rreshkura, disi të patrajtë. Si me zor hoqi vështrimin prej tyre, duke lëshuar butësisht drejt përroit që gurgullonte lehtë, sa mezi dëgjohej. Pasi e largojë vështrimin, ju bë së

dëgjojë një zë. Ishte tingulli i shurdhër i kazmës që kishte goditur tokën. Me mendime të mbledhura, buza i shkojë në gaz. Për të dytën herë pa nga patriku, i cili si i përhumbur bëri kryq. Thellë në shpirt ndjeu gëzim. Filloi më në fund, mendoi buzagaz.

Plisat e parë të dheut të përzier me gurë e rërë u hodhën në anën e djathtë, në drejtim të përroit.

Gërmimet kishin filluar në fundin e bregut, ku mendohej se kishte qenë rruga e shtruar me kalldrëm që shpinte në portën kryesore të manastirit. Mihësit, të mbuluar në djersë vazhdonin të godisnin me forcë. Tutje, përtej telave rrethues shikonin fshatarët kureshtar. Në anën tjetër të përroit kullosnin tufa delesh.

Van Joviqi shikonte ethshëm punëtorin që tani më ishte futur gjer në bel në gropën e hapur prej tij. Ai doli nga gropa për t'ia lëshuar vendin tjetrit që priste në breg me lopatë në dorë, për ta larguar dheun e mihur. Dheu tani dilte i shkrifët, i përzier me gurë të gdhendur e horasan, të mureve të rrënuara të manastirit. Van Joviqi me fletat e skicave në dorë u afrua pranë bregut. Pasi e mati thellësinë e gropës shikoj shifrat e shënuara në skicë. Ju afrua punëtorit që pushonte në breg, mbështetur në bishtin e kazmës.

– Tani e tutje të jesh i kujdesshëm! Jemi shumë afër!

– Si urdhëro! – u përgjigj punëtori duke heqë plisin për t'i fshi djersët.

Çfarë mendojnë këta për këto gërmime? Pyeti vetën Van Joviqi, deri sa shikonte punëtorët që mihnin të heshtur. Dukën të qetë por, sigurisht se fshehurazi na urrejnë. Në fytyrat e tyre nuk mund të dallosh gjë. Dukët se kanë karakter të fortë. Po të pranuan si mik, janë në gjendje të flijohen me gjithë çfarë kanë

për të mbrojtur. Kështu thotë kanuni i tyre! Njerëz të çuditshëm!

Vonë pas mesditës u panë shenjat e para. Rrasa guri të radhitura pranë njëra-tjetrës në mënyrë të rregullt përbënin kalldrëmin e rrugës që shpinte në portën kryesore. Vende-vende kalldrëmi ishte i dëmtuar. Van Joviqit i ndritën sytë. Patriku akoma kishte atë qëndrimin e përhumbur, e plot dyshim.

Sa më shumë që i afroheshin vendit ku duhej të ishte porta, aq më shumë ndesheshin në skelete dhe kafka njerëzish. Nuk kishte mbetur ndonjë gjë e frikshme nga ato skelete. Ishin aq të vjetruara sa që dukeshin si copa druri që kishin filluar të kalbeshin. Njëri nga punëtorët, gjeti një përkrenare tunxhi me kafkën brenda saj. Dukej se ushtari kur kishte vdekur kishte rënë përmbys. Fragmentet metalike të armëve dhe sendeve tjera të gjetura si fibula, pafta brezi të skalitura, kryqe tunxhi që i kishin pasur të varur në qafë kallogjerët, maje shtizash në formë gjethi, maje shigjetash të shkapërderdhura në brendi të skeleteve, tregonin se të vrarit pas betejës kishin mbetur të pavarrosur, por të mbuluar me mbeturinat e mureve të shkatërruara të manastirit.

Gjatë javës së dytë të gërmimeve u ndeshën në qyngjet e ujësjellësit. Shenja për ekzistimin e qumësht sjellësit nuk i kishin hasur akoma. Sipas gojëdhënës thuhej se qumësht sjellësi kishte qenë i ndërtuar nga lugje druri. Vrimat e gjetura në mur nga ana veriore i përligjnin këto thëne. Nga ana verilindore, ngjitur për muret e jashtme të manastirit, ishin gjetur fragmente muresh të punuara me tekniken "opus mixtum" në formën e një korridori me gjerësi rreth tetëdhjetë

centimetra. Në brendi të manastirit, në anën e majtë të absidës, në drejtim të verilindjes ishte një e çarë në mur, që në pamje të parë dukej si e ndarë dollapi. Kjo e ndarë kishte një dalje të jashtme që i bashkëngjitej fragmenteve të mureve që kishin zgjatje deri të përroi. Aty muret treteshin. Dukej të kishte qenë një jashtë dalje sekrete, ndaj kërkimet duhej të vazhdonin edhe në anën tjetër të përroit.

Gërmimet vazhduan edhe për disa ditë me radhë. Në fundin e kodrinës ku dyshohej se do të gjendej vazhdimi i murit të ndërprerë, nuk u gjend asnjë shenjë dyshuese. Kishin vazhduar me matjet dhe me skicat, por pa asnjë rezultat. Sipas matjeve që i kishin bërë, duhej të ekzistonte një bashkëngjitje e murit në një pikë matanë përroit, sepse muri që zgjatej nga manastiri në drejtim të përroit ashtu i pa mbështetje nuk do të kishte ndonjë kuptim.

Bënte vapë. Zhurma e kazmave vinte si e mbytur. Poshtë në përrua rridhte uji i pakët. Matanë përroit, bregorja dukej e blertë dhe me bar të shkurtër. Tek tuk shiheshin disa shkurre shkoze. Një tufë delesh kullosnin të qeta faqe shpatit. Krejt në krye të kodrës ishte një qarr i madh. Thuhej se ishte shumë i moçëm.

Van Joviqi kishte kohë që rrinte para çadrës. Shikimin si gjithmonë e mbante drejt kullave të katundit të vogël që shtrihej para pamjes së tij. Poshtë, në rrugë pa malësorë që shkonin diku. Rrugica e ngushtë në të majtë, ishte mbushur çuditërisht me një grumbull njerëzish. Në mesin e tyre kishte gra dhe fëmijë. Kishte edhe vajza të reja me gërshetin hedhur prapa shpine, dhe me ato veshjet e tyre të larmishme. Ju bë se pa edhe nuse. Herë pas herë, të heshtur, disi të akullt,

vështrimin e hidhnin drejt tij. Deshi ta ngrinte dorën për t'i përshëndetur, por në çastin e fundit ndërrojë mendje. Ndoshta një përshëndetje e papërcaktuar nga larg do të binte ndesh me zakonet e tyre dhe do të merrej si provokim. Turma fillojë të lëvizte e qetë tatëpjetë, derisa u zhduk prapa mëgjeve. Nga larg, të venitura u dëgjuan ritmet e tupanëve.

Padashur buzëqeshi me vete. Tani kishte filluar të delte jashtë përcaktimeve të tij. Ato që i kishte planifikuar dhe që i kishte menduar dikur, kishin qenë thjeshtë iluzione. Edhe pse vetja ju kishte dukur se mundë të rrëshqiste si gjarpër dhe të futej në mes të themeleve të vjetra, në varreza të harruara nga motet, në themele manastiresh e kalash, në rrugë të vjetra të mbuluara me plot mister, në shpella të mbyllura nga erozioni, në shtrat të shterura lumenjsh, në burime uji, në shkëmbejë e kullota bjeshke të pashkelura prej kohësh nga këmba njerëzore... dhe që andej, tani i bëhej se rrokullisej në trajtë gurore, dhe pritej të binte aty nga ishte nisur dikur, pa gjetur asnjërën nga ato, për të cilat ishte përcaktuar. Ndërsa gjëmimet e tupanëve vinin si të ndërprera!

Ndërkohë, Van Joviqin e lajmëruan se kishin hasur në një stelë[6]. Dy punëtorë përpiqeshin ta nxirrnin nga dheu. Ata nuk punonin me kazma e lopata por duke e gërryer dheun me mistri, e pastaj duke e pastruar me brushë, që të mos dëmtohej rrasa e mermerit të bardhë të tipit oniks. Van Joviqi ju erdhi në ndihmë.

– Kujdes anën tjetër! – foli njëri nga punëtorët që e kishte tërhequr rrasën nga dheu, dhe me gjithë forcë

---

6 Gurë varri

e mbante me të dy duart. Ndërkohë punëtori tjetër e kapi në anën e kundërt dhe përfundimisht e nxorën në sipërfaqe. Për një kohë, Van Joviqi u mor me pastrimin e saj. Arriti të deshifronte shkronjat CIL që nuk ishte i sigurt, në ishin vetëm shkronja apo ndonjë numër nga koha e lashtë romake. Ndërkohë, punëtorët e tjerë e thirrën për të parë një pllakë tjetër të posa nxjerrë në sipërfaqe. Ajo ishte më e pastër, ndaj nuk që i vështirë deshifrimi: M. Ulpius, duket të ishte municipium[7] i panjohur, që lidhet me vendbanimet e Pejës, mendoi Van Joviqi. Ndoshta edhe këto do të kishin një lidhje me rrasën tani më të zhdukur që me shekuj kishte qëndruar mbi piedestalin e gurrës së Sofjes, e cila i kishte takuar një pjese të një përmendoreje të madhe me mbishkrimin: Kursus Honorum. Ndërsa pllakat pranë mejtepit, dhe pranë mullirit të Mar Rexhës, tani më të shkatërruar me dinamit, që kishin qenë me ornamente zbukurimi, dukej se kishin një lidhshmëri, dhe i takonin kohës romake.

I zbrazur nga çdo mendim u kthye sërish në çadër. Pasi u ul në stolin e tij të drunjtë, i shikoi skicat mendueshëm. Kishte kohë që i mbante të hapura mbi sipërfaqen e tavolinës. Hëm! Bëri, si të ishte duke u përgatitur të fliste me dike. Pasi i rrotullojë disa faqe, nxori listat e emërtimeve arkeologjike! Ishin të njëjtat lista që me dhjetëra herë i kishte lexuar e rilexuar. Në krye të listave lexonte kalimthi titujt e shënuara me germa të mëdha: „Fortesa e Gegjës." „Fortesa e Pejës," „Kështjella e Gjytetit," „Kalaja e Durmanit," „Kështjella

---

7 *Vendbanime me banor vendas që i gëzonin të drejtat nën perandorinë romake.*

e Jerininës," „Bazilika e Bajës," „Kalaja Gjenovizit," „Manastiri i Stupenit…" këtu u ndal për disa çaste. Pastaj e tërhoqi fletën nga dosja. Rrotullojë në anën tjetër dhe pa nga skicat. Vijat e lakuara me ngjyrë të zezë që paraqisnin vijat kryesore të ngritjes së kodrës ju dukën të vrazhda. Pastaj vija e trashë dhe e zezë që paraqiste muret rrethuese dhe shenjat e tjera dalluese brenda mureve disi ju duk kryeneçe, e ngurtë e me plot domethënie. Për një çast ju bë se ajo vi e trashë dhe e zezë u shndërrua në fortifikatë gjigante dhe si me tallje i thoshte: edhe ty të erdhi radha të gërmosh mbi shpatullat e mia? Nuk me shkul dot nga këto troje, sepse rrënjët i kam thellë, thellë! Nuk me shkulën as ushtritë barbare që erdhën me zjarr e hekur... dhe ja ku jam!... dhe pa dashur nga goja i dolën fjalët: "... shumë e lodhur!..." Tani bushk me tupanët dëgjoheshin edhe tingujt e thekshëm të zurles!

Në vende të caktuara shiheshin kryqe të vogla me ngjyrë të kuqe që tregonin vendet ku dyshohej se ka përbërje arkeologjike. Jashtë vijave rrethore në skicë ishin të shënuara edhe katër kryqe me ngjyrë të kaltër që tregonin varre të vjetra. Pa dashur ngriti vështrimin nga e çara e çadrës dhe u përpoq të shihte jashtë, pikërisht në atë drejtim ku ndodhej kodra matanë përroit. Dyshohej se aty kishte varreza. Hëm, bëri me vete. Për një copë herë vështrimi i mbeti i mbërthyer mbi një kryq të kuq që ishte larg nga muret e skicuara të manastirit. Me fletën në dorë doli jashtë. Vështrimin e mbërtheu në shpatin përballë ku punëtorët gërmonin. Pastaj rrëshqitazi ngriti vështrimin duke e ndalur në mesin e Shkëmbit të Kuq. Vetëm ajo zgavër e zbulon misterin e tunelit sekret. Kot përpiqemi me matjet dhe

skicat e tanishme, mendoi.

Jashtë u dëgjuan hapa. Pas pak në çadër ia behu Kekë Ymeri.

– Gospodine!... kemi zbuluar një varr. Dukët të jetë shumë i vjetër! – tha duke i treguar me gisht mbi skicën që e mbante në dorë.

– Varr? – pyeti Van Joviqi, dhe vazhdoj: – sikur e prisja!...

– Po! Varr. Duket të jetë shumë i vjetër. Fransua po merret me të!

– Shkojmë!... Hëm! Se ç'kisha një parandjenjë! Do me thënë, varr!...

– Si the gospodine? – pyeti i habitur Kekë Ymeri.

– Asgjë. Se si e kisha një parandjenjë, thash. Ka ditë që me shqetësojnë këto dreq gërmimesh. As në gjumë nuk me lënë të qetë!

– Ndoshta e ke nga lodhja... nga puna e gjatë që bëni!

– Edhe ajo mund të jetë!

Varri kishte pamjen e një arke të ndërtuar me rrasa guri. Skeleti kishte orientim veri jug. I befasuar Van Joviqi dha urdhër të vazhdonin gërmimet. Dyshohej se krejt kodra duhej të ishte nekropol[8] tipik dardan.

Tamam në kohën kur deshi të kthehej në çadër, pa Fransuan duke biseduar me një fshatar tutje matanë telave rrethues. Ai ia bëri me dorë të afrohej.

– Shiko! Ky fshatar ka gjetur stoli të vjetra! – tha Fransua.

– Ku i more këto stoli? – pyeti Van Joviqi fshatarin.

– Dje isha me punë angari në Bajë. Gjatë nxjerrjes

---

8 Varrezë antike

së gurëve nga muret e vjetra të kishës, gjeta disa stoli, thash ndoshta do të hyjnë në punë! – tha fshatari shqip, duke lëshuar nga krahu një thes.

– Ë? – bëri Van Joviqi, duke shikuar në drejtim të Kekë Ymerit.

Kekë Ymeri i përkthej fjalët në gjuhën frënge, duke e shikuar fshatarin qortueshëm!

Van Joviqi futi dorën në thes dhe që andej nxori një përkrenare tunxhi. Pastaj nxori një diademë[9] të zbukuruar me gurë xhevahiri. Dukej se i kishte takuar ndonjë pushtetari të lartë! Kishte edhe maje shigjetash, gjerdan argjendi, rruaza qelqi, vathë, byzylyk... e shumë të tjera. Të dy dukeshin të mahnitur, kurse Kekë Ymeri shtrëngonte grushtet me nervozë.

– Gabim bërë!... – i foli me zë të ulët dhe qortueshëm fshatarit, Kekë Ymeri.

– Unë i solla për t'i shitur!... – u përpoq të shfajësohej fshatari.

– Këto gjëra nuk shitën! Këto jan të shenjta për... – deshi të vazhdonte edhe më tutje me qortimet e tij, por e ndërpreu Van Joviqi:

– Ku i gjete këto?

– Në Bajë, pranë mureve të kishës së vjetër. – u përgjigj fshatari.

– Kush të ka thënë të gërmosh atje? – pyeti Van Joviqi.

– Të thash! angari kam punuar! Sot në vendin tim e dërgova vëllain, kurse vet erdha...

– Kush të ka thënë të punosh angari atje?" – pyeti

---

9 *Kurorë e zbukuruar me gurë të çmuar, të cilën e mbanin perandorët, mbretërit etj, shenjë e pushtetit të lartë!*

kësaj radhe i nxehur Van Joviqi.

– ... kryeplaku... tellalli! – foli fshatari i skuqur, duke i rrudhë krahët dhe duke shikuar si me dyshim drejt Kekë Ymerit.

Kekë Ymeri në vend të përgjegjës e shikoi qortueshëm.

– Pranë mureve të kishës së vjetër the?

– Po.

– E muret a janë dëmtuar?

– Jo! Po, po... muret duhet të shkatërrohen! Gurët duhët të dërgohën në Lumborë për ndërtimin e kishës së re? – u përgjigj fshatari i hutuar.

Kekë Ymeri vazhdoj ta shikonte me inate. Fshatari dukej edhe më i hutuar.

– Gurët e bazilikës së vjetër?! Është e mundur kjo? Kush i drejton punimet atje? – pyeti kësaj radhe Fransua!

– ... naçallnikun e kam parë!... nuk e di kush!

– Shkojmë Fransua! – tha Van Joviqi dhe u nis në drejtim të çadrës, me thesin në dorë. Fshatari mbeti si i ngrirë! Nuk ishte në gjendje as të kërkonte para, as të largohej pa i marrë ato! – Hej, eja e merri paratë!" – thirri nga larg Van Joviqi. Fshatari vrapoi drejtë tij.

Derisa karrocieri po i mbrehte kuajt, nga rruga matanë u dëgjua rrapëllima e rrotave të një karroce që po vinte. Pas pak, karroca e patrikut e tipit Landauer[10], u ndal. Zbriti patriku i shoqëruar nga një prift i ri. Ai u nis drejt çadrës. Van Joviqi u doli para.

– Mirë se erdhe, patër!

– Mirë se ju gjejë! Si ju shkojnë punët? – pyeti

---

10 Karrocë luksoze që tërhiqej nga kuajt

patriku.

– Mirë, mirë... mora vesh se në Bajë po merreshin gurët e mureve të bazilikës së vjetër!

– Pse, nuk keni qenë në dijeni ju? – pyeti patriku i habitur.

– Jo! Unë nuk di asgjë! – u përgjigj Van Joviqi, derisa ishte duke i pastruar duart të gurra.

– Po, por!... mendoj se do të ishte mirë të vazhdosh më këto gërmime që i ke filluar... të zbulohet kultura jonë!... Unë nuk erdha për këtë por, për erdha të njoftuar se është marrë vendim, që para se të dërgohen në kryeqytet gjetjet antike dhe arkeologjike do të behët një seleksionim paraprak. Data është caktuar me 13 korrik. Ne kemi përpiluar një listë të atyre që do të marrin pjesë në këtë seleksionim. Në mesin e të ftuarve do të ketë njerëz të kulturës, ushtarak, gazetar... me një fjalë njerëz të besuar!

– Ashtu?! – pyeti i habitur Van Joviqi.

– Po! Është mirë t'i ndërpresësh gërmimet dhe të merresh me përgatitjen e referatit mbi zbulimet e deritashme!

– Është vështirë të flitet për referate, pa caktimin e vjetërsisë së objekteve!

– Mund të behët me përcaktime të përafërta! Thash, është vetëm seleksionim!

– Mirë! Me përcaktime të përafërta mundë t'a përgadisish edhe ti një referat! Unë nuk kam asgjë kundër!

– Ashtu? Do të bisedojmë edhe një herë tjetër pra! – foli patriku pa e fshehur gëzimin.

– Me fal patër, por me duhët të ju lë vetëm. Ne jemi përgaditur të shkojmë në Bajë!

– Mirë, mirë! Si të dëshironi! – foli qejfprishur patriku, dhe pastaj ia ktheu shpinën.

Patriku hyri në çadër. Prifti që e shoqëronte, zuri vend në karrigen e Van Joviqit. Në dorë mori bllokun e tij të shënimeve që pak më parë e kishte lënë të hapur mbi tryezë Van Joviqi. Filloi t'i lexonte me zë të lartë. Patriku ju afrua edhe më afër!

– Stela e Stupenit, municipium kushtuar Jupiterit, municipiumi anonim, stelë me ornamente zbukurimi... i takojnë periudhës ilire... qendra ilire, fortifikatë ilire, kala ilire, banesë ilire me peristil, orakull[11] *pagano-ilir, bazilikë para krishtere ilire, nekropol ilir, veshje ilire, zbukurime ilire...*

– Të gjitha ilire? Nga kultura serbe nuk ka shënuar asgjë, edhe pse manastiri i kishte takuar periudhës më të ndritur të kulturës serbe?...

– Kam informata se Van Joviqi, ka lidhje gjaku me arbëreshët e Zarës. Ata kanë pas hapur edhe shkolla shqipe dikur!... – foli qetë patriku.

– Ky njeri e paska mbushë kupën! E paska hak... – e ndërpreu prifti i nxehur, duke prekur me meje të gishtave fytin e vet, në shenjë prerje!

– Mos e humb durimin o shërbëtori i perëndisë! Zoti është i madh e na shikon!… këtu jemi në vendin tonë, në tokën tonë të shenjtë! Lutu të zoti e mos i merr mbi vete mëkatet e kaçakëve të mallkuar, e atyre…

Në çadër hyri Dragomiri. Patriku e ndërpreu bisedën.

---

11 Prift pagan që parashikonte të ardhmen

– Patër, dy fshatar e kërkojnë arkeologun, çfarë t'ju them?

– Le të vijnë! I pres unë!

– Ata kanë ardhur me një karrocë! Kanë të ngarkuar diçka që duan t'ia tregoinë atij!

– Ashtu? – pyeti i befasuar patriku. Pasi i dha shenjë priftit ta ndiqte pas, patriku u nis drejt daljes.

Në fundin e rrugës pa dy fshatar serb. Njëri, ai më i riu qëndronte përpara qeve, kurse tjetri rrinte i ulur mbi qerre. Jo larg tyre punëtorët gërmonin me kujdes. Fare pranë gardhit Kekë Ymeri bënte disa matje pranë një kenotoafi[12] të porsahapur. Për një kohë të shkurtër patriku lëbyri sytë mbi një përkrenare tunxhi pastaj, sëpatë dytehëshe, thikë, kallçi tunxhi e disa maje shtizash të porsa nxjerra.

Vëmendjen ia tërhoqi fshatari serb që kishte qëndruar ulur mbi qerre. Me t'u shfaqur patriku, me një kërcim të beftë, ai u hodh para këmbëve të tij duke u përulur me nderim.

– Patër, kemi gjetur dy rrasa guri të shkruara, duken të jenë të vjetra, shumë të vjetra! – foli fshatari.

– Rrasa? – pyeti patriku i habitur.

– Si urdhëro patër, janë të shkruara. Vendosëm t'i sjellim...

– Ku janë rrasat biri im? – e ndërpreu patriku

– Ja, këtu! – tha fshatari duke larguar me dorë disa tufa gemash e gjethesh shkoze.

– Aha! Dale një herë t'i shoh! – foli patriku i çuditur tej mase.

---

12 Varr i zbrazët i ngritur për të vdekurit larg vendit apo për të zhdukurit!...

Rrasa e parë nuk ishte aq e madhe. Në të kishte të gdhendur një figurë auguri[13], me duart pak të ngritura, duke treguar shenjat e natyrës. Në pjesën e poshtme të saj ishin të shënuar dy shkronja: M.L. pastaj rreth e qark kishte ornamente florale të lakuara, me gjethe hardhie, të gdhendura brenda kornizave, ndërsa në të katër skajet ishin të gdhendura nga një kalavesh rrushi. Kurse rrasa tjetër ishte më e bukur. Dukej se ajo ishte një stelë varri, e cila në pjesën e sipërme brenda kornizës, kishte të skalitura portrete qifti bashkëshortor. Në brendinë e kornizës së mesme ishin të skalitur siç dukej emrat e tyre. Shkronjat ishin të alfabetit latin. Kurse në kornizën e fundit ishin të skalitura dy figura të pëllumbave me sqepa të bashkuar!

Patriku u kthye nga fshatarët. Pas një shikimi të shkurtër, por të akullt foli:

– Keni bërë shumë mirë që këto gjëra m'i sollët mua. Këto nuk i takojnë kulturës tonë të lavdishme... – dhe me zë të ulur vazhdoi: – janë të atyre! – dhe bëri me kokë drejt shtëpive shqiptare. – Zhdukni, Shkatërroni, Copëtoni... sa më parë që të jetë e mundur... dhe shshsh, askujt asnjë fjalë! Pagesën e merrni nga prifti, por jo këtu, atje! – dhe bëri me kokë në drejtim të patriarkanes – shkoni tani! Rrugë të mbarë bijtë e mi!

– Hooo! – i thirri fshatari kafshës dhe u kthyen nga kishin ardhur.

*

Deri në rrugën kryesore dëgjoheshin goditjet ritmike

---

13 Prift që parashikonte shenjat e natyrës.

të kazmave mbi tokën e fortë. Dy qerre të ngarkuar me gurë dolën në rrugë. Dy burra përpiqeshin të ngarkonin mbi qerre një gur të madh. Pran tyre ca të tjerë gërmonin pa asnjë kujdese. Van Joviqi e ndjeu vetën keq. O zot, çfarë paskan bërë! E paskan shkatërruar krejt! Në mesin e dheut pa copa qeramike të olpave[14] apo kupave të thyera. Sigurisht se kishte pasur edhe gjëra të bukura dhe me vlera të mëdha arkeologjike por, që kishin përfunduar në xhepat e mihësve. Me vrap u fut në mesin e punëtorëve. Pasi shikoi majtas e djathtas sikur ishte duke kërkuar dikë, ju drejtua një burri që rrinte në këmbë, nën hije, mbështetur për lis.

– Çfarë behët këtu?! – pyeti Van Joviqi pa e përshëndetur.

– Nxjerrim gur! – ju përgjigj burri mospërfillës.

– Çfarë gurësh... ju po i shkatërroni themelet e Bazilikës së vjetër...

– Po! Kështu e kemi urdhrin! – tha ai i çuditur.

– Kush të ka dhënë urdhër të tillë? – pyeti Van Joviqi hetueshem.

– Naçallniku! Po ju kush jeni që me pyesni kaq shumë? – pyeti burri hetueshem.

– Unë? Unë jam arkeolog! Unë merrem me gjurmimin e lashtësisë, bëj gërmime të kalave... të kishave të vjetra. Kurse ky është eksperti francez!...

– Aha! Ti qenke arkeologu. Kam dëgjuar për ty, edhe për këtë francezin... Bonjuor Monsieur! – ju drejtua Fransuas dhe vazhdoj: – Unë merrem me mbikëqyrjen e punimeve këtu. Këta gurë që po nxirën do të përdorën për ndërtimin e kishës së re ortodokse në Lumborë!

---

14 Enë qeramike.

Kurse këtu do të ndërtohet një spital.

– Ku është naçallniku? – pyeti pas pak Van Joviqi.

– Nuk e di! – u përgjigj ai duke e nxjerrë nga xhepi dorën e majtë. Van Joviqi lëbyri sytë. Ju bë se ai nga xhepi po nxjerrtë ndonjë letër për t'ia treguar atij se vërtetë kishte urdhër nga dikush që të nxirreshin gurët e vjetër. Por nga xhepi ai nuk nxori asgjë, përveç dorës boshe që e zgjati nga e majte dhe e mori kukëzën. Vetëm atëherë, Van Joviqi e vërejti se atij i mungonte njëra këmbë. Pasi u mbështet në kukëzën, i dha trupit duke lëvizur në drejtim të tij. Van Joviqi ia lëshoi rrugën. Fransua e ndoqi pas.

– Prapë qenkan ndeshur me ndonjë gjë interesante! Ejani edhe ju! – tha i çali pa ju drejtua askujt, duke shikuar punëtorët të grumbulluar në një vend. Duke u mbështetur mbi kukëza bëri hapin e dytë.

Van Joviqi u fut në mes të punëtorëve. Fransua u hodh në gropë. Nën këmbët e tyre ndodhej një rrasë. Edhe pse gropa ishte e madhe akoma nuk ishin zbuluar këndet e saj. Kryepunëtori dha urdhër, mos të dëmtohej rrasa, por të zbulohej e plotë. Në ndërkohë Van Joviqi bashkë me Fransuan filluan nga matjet dhe përpilimin e skicave:

Bazilika i takon përiudhës paleokristiane, e ndërtuar me planimetri qendrore, me mbizotërim të boshtit vertikal, e mbuluar me kupolë. Pronaosi[15] i ndarë në tri nefe[16] me sistem arkadash mbi kolona. Ptera[17] mesatare

---

15 Paradhomë e tempullit
16 Salla
17 Korridori

midis kolonadës dhe mureve. Tepidariumi[18] i banjës në anën veriore. Kapela[19] e vogël e ngjitur për mur. Hyrja nga ana perëndimore e paraprirë nga një narteks[20]. Në anën lindore është absida[21] ku kishte qenë i vendosur temenosi[22]i rrethuar, dhe altari[23]. Peristili[24] që qarkon oborrin e bazilikës. Tuma[25] jashtë mureve, dhe në fund dalja sekrete...

Van Joviqi ishte i mahnitur. Ishte hera e parë që kishte para vetës një banjë elegante romake. Edhe pse e dëmtuar, pas matjeve arriti në përfundim se banja ishte e përbërë nga tre dhoma që duhet të kishin pasur temperatura të ndryshme. Ishin zbuluar kalidariumi[26] me qyngjet e ujësjellësit që zbrisnin nga kodra ku ishte burimi i ujit të ngrohët. Kishte një pishinë, që furnizohej nga i njëjti burim. Frigidariumi[27] me në një lëfyt qeramike, siç dukej, për sjelljen ujit të ftohët, kurse paradhoma ishte përdorur si pushimore para, apo pas banjës.

Pak më tutje, ishin gjetur themelet e një orakulli. Gjatë matjeve të ngutshme kishte arritur në përfundim se ky tempull nuk kishte qenë asgjë tjetër veçse një e ndarë e bazilikës ku priftërinjtë pagan në emër të hyjnive kishin paraparë zhvillimet e rrjedhave të ardhmërisë!

---

18 Ambient i banjës romake me temperaturë normale
19 Kishë e vogël që i bashkëngjitej kishës kryesore kryesisht për varrosje
20 Parasallë
21 Pjesa fundore e harkuar e kishës e orientuar nga lindja
22 Hapësirë e rrethuar ku gjendej tempulli kryesor dhe altari
23 Rrasë mbi të cilën në kohërat e lashta u bëhëshin flijime përëndive
24 Kolonadë që qarkon një oborr apo një tempull
25 Varrezë në formën e një kodrine, e krijuar nga mbi vendosja e varreve
26 Ambient i ngrohët i banjës romake
27 Ambient i ftohët në banjat romake

Ishte i sigurt se këtu, nëse nuk do të ishin dëmtuar themelet e bazilikës, të banjës romake, të orakullit pagan, të varrezave princërore e shumë përbërjeve të tjera arkeologjike që nuk dihen, do të zbuloheshin depo epokale arkeologjike! Këtu do të fillonte fama e tij, karriera... pa dashur mendja i shkoi në Vjenë ku i kishte mbaruar studimet. Aty për herë të parë ishte ndeshur me një pasuri të rrallë arkeologjike gjetur në Janjevë të Kosovës. Që nga ajo kohë, kishte ëndërruar që një ditë të shkonte në ato vise të pasura, për kërkimin dhe gjetjen e relikteve të rrallë arkeologjikë. Pastaj ju kujtuan studiues të huaj e vendas, si Bue, Hahn, Arpad, Karapangjiq, Boshkoviq, Gjeçovi e shumë të tjerë, të cilët, kishin dhënë vlera monumentale epigrafie[28], deri sa ishte arrit kulmi i të gjitha zbulimeve të deritashme, me nxjerrjen në dritë të thesarit të Janjevës të cilin e kishte marrë Knez Pavli për muzeun e tij.[29]

Duke i kaluar nëpër mend të gjitha këto, ju bë se më tepër e rënduan mendimet, se sa përpjekjet për nxjerrjen e një përkrenareje ilire nga një varr princërorë. Ndërkohë vendosi të mos mendonte asgjë. Filloi t'i lëvizte duart më shkathtësi, sepse vetëm tani e vërejti se dielli kishte perënduar.

Vonë në mbrëmje, kur muzgu kishte filluar të mbështillte çdo gjë në gjirin e saj të freskët, Van Joviqi la punën. Pas përfundimit të skicave planimetrike dhe caktimin e teknikës poligonale, letrat që i mbante në dorë i futi në dosje. Fransua i fuste në thes njërën pas tjetrës gjetjet e asaj dite si figura antropomorfe, fibula,

---

28 Shkencë që merret me studimin e mbishkrimeve të vjetra
29 Thesar arkeologjik i grabitur nga Knez Pavli në vitin 1934

vathë ari dhe argjendi, rruaza qelqi, pafta tunxhi, urna guri, figura bronzi, skulptura mermeri, terakotë gruaje me veshje ilire etj. Kishte hasur edhe në fosilet e një mozaiku në hyrje të pronaosit por të dëmtuar rëndë.

Tamam në kohën kur po bëhej gati të hipte në karrocë, si në vegime pa majorin të shoqëruar nga patriku. Pranë tyre qëndronte naçallniku, i cili fliste diçka dhe shikonte në drejtim të tij. Van Joviqi ngriti dorën për t'i përshëndetur. Nuk kishte aspak dëshirë të takohej me ta, por majori ia bëri me dorë të priste.

– Hë, si shkojnë punët? – pyeti majori pasi ishte afruar pranë tij.

– Disi!... – ia ktheu Van Joviqi qejfprishur, dhe vazhdoj – është shkatërruar një relikt i rrallë arkeologjik!...

– Po… si të them? Është kohë urbanizimi! Pastaj, këtu nuk shoh ndonjë vlerë për kulturën e popullit tonë!...

– Kurse unë, këtu i shoh vlerat të përkryera arkeologjike… – ia priti me inat Van Joviqi.

– Unë mendojë se tani për tani, nuk është koha për hulumtime të tilla, – e ndërpreu majori. Pas një heshtje të shkurtër ai vazhdoi: – Arkeologët si Patch, Vuliq, Karapandiq, Gjeçovi e shumë të tjerë, i kanë kaluar kufijtë e hulumtimeve të tyre në këtë drejtim. Ne, jo njëherë ua kemi tërhequr vëmendjen që të jenë të ndërgjegjshëm dhe të punojnë në hulumtimin e vlerave të trashëgimisë kulturore serbe. Të hidhet dritë mbi qendra të pasura arkeologjike që nga mesjeta e hershme që flasin për kulturën tonë. Të nxirren në pah themelet e manastireve të shkatërruara nga barbarët, të gjenden themelet e kalave të mbretërve, dhe carëve serbë. Të hulumtohen vendbanimet topografike serbe që flasin vet për ekzistimin dhe banimin e popullit tonë në këto

troje... pra me një fjalë, të gjendën edhe aty ku nuk janë gjurmët e lashtësisë kulturore serbe! Kurse gërmimet e këtushme, nuk flasin për një kulturë të tillë prandaj, në mos të shkatërrohen, duhët të ndërpriten!

Van Joviqi nuk foli. Nuk dëshironte të kujtonte asgjë. Fjalët e majorit ju vërtitën si shtëllunga tymi rreth kresë. Bëri një lëvizje sikur donte t'i shpërndante ato shtëllunga, por nuk i shpërndante dot. Ju bë se gjithë ato lëvizje rreth e qark, ato klithje njerëzore, të përziera me krrokatie korbash, hingëllima kuajsh e lehje qenesh ishin ngritur mbi dëshirimin e tij. Edhe skeletet e porsa nxjerra nga nekropoli tumular u sulën drejt tij. E shanin, e quanin gënjeshtar, e gërvishtin, e godisnin pa mëshirë, dhe porsa ua kthente shpinën të ikte, ata i suleshin me shpata duke ia vërgëllyer mbi kokë, e gjuanin me shtiza dhe në fund, të lidhur me litar nga këmbët, e tërhiqnin zvarrë dhe pastaj... ju shpëtonte nga dora... duke u kthyer në kohën e tashme që ishte edhe më tragjike... dhe binte në pritë... krisma e pushkës dhe rrokullisja nëpër bokërima të thepisura... sikurse Gjeçovi!... o zot!

– Ndodhemi në një vend ku jeta e njeriut matet me vlerën e një plumbi! – tha pa pritur majori.

– Ashtu duhet të jetë! – foli kësaj radhe patriku.

Van Joviqi uli kokën si fëmija fajtor! Goja e majorit, deri sa fliste, bashkë me fjalët kërcënuese, nxjerrtë jashtë edhe një erë të rëndë përzier me hudhër e raki. Ishte e mundur vallë, që nga një gojë e tillë që nxjerr jashtë vetëm ndyrësira, të përlyhej emri i një kulture të rrallë, pavarësisht se cilit popull i takon? Ishte e kotë të përpiqej t'i mbante të fshehura përcaktimet e tij, e aq më tepër duke e gënjyer vetën. Edhe pse kishte bërë

përpjekje që ato përcaktime të mbeteshin të ndryrë thellë në brendinë e qenies së tij, befas, kur nuk e kishte pritur fare, kishin filluar të qartësoheshin, nga një gojë që të mirat e huaja i kapërdinë me shije, pastaj të konvertuara i vjellë me erë të rëndë kërme!... duke e ndyrë pastërtinë, nderën dhe fisnikërinë e një populli të tërë!...

Largimi që andej i erdhi si shkarkim i një pjese të shikimeve të rënduara të majorit. Ju bë se ato shikime të tij kërkonin nënshtrim, përulje. Vetja ju duk i pa bindur, kryengritës! U përpoq të sillte ndërmend format e ndëshkimeve kundër atyre që nuk ju bindën urdhrave. Nëpër mend ju sollën pranga të ndryshkura dhe zinxhirë të rënd, fytyra të mavijosura, të çara e me vija të lakuara gjaku. Njerëz të kërrusur nga pesha e gurit, nga pesha e fajeve, që silleshin vërdallë rreth tij, me ato veshjet e tyre të zhgunit të bardhë me shiritat e zi pështjellur si gjarpinj, në gjoks, rreth duarve, rreth këmbëve, rreth qafe... që nuk i linin të lëviznin, të ecnin, të shfajësoheshin... sikur zoti t'i kishte krijuar, këto qenie të mjera, për t'ua lehtësuar të tjerëve shkarkimin e fajeve, hedhjen e akuzave, denoncimin... Ujku mishin e vet e lëpinë, por të huajin e han!

Karroca, mori të përpjetën pasi kishte kaluar përroin e katundit të vogël Lumborë. Porsa ishin futur në një rrugë malore. E përpjeta ishte e madhe. Kuajt i ngadalësuan hapat. Trokëllimat e patkonjve filluan të rralloheshin, derisa u shndërruan në ecje normale. E përpjeta vazhdonte duke kaluar kthesat njërën pas tjetrës. Muzgu kishte rënë me kohë, kurse rruga as që dallohej më nga errësira që krijohej në mes të lisave. Van Joviqit ju bë se jashtë trokëllimës së hekurt të

rrotave, dhe dihatjes së kuajve, herë-herë dëgjohej një zë që vinte tutje nga mali. Assesi nuk e kishte përcaktuar se çfarë zëri ishte. Ishte ndonjë bari që tutje në thellësi të malit ju thërriste bagëtisë, apo ndonjë zë i mekur shpendi. Sido që të jetë, në mesin e atyre njerëzve e ndjente vetën të sigurt. Mendja i vajti te kaçakët kryengritës, që nuk e pranonin fajin, që nuk donin të ndëshkoheshin. Ata sigurisht se tani e kishin përfunduar kohën e gjumit ditorë, dhe tani sa ishin zgjuar dhe bëheshin gati të dilnin nga ato bokërima të errëta të malit dhe t'i sulmonin ata që i kishin bërë me faj. Një drithërimë frike ia përshkojë trupin. Ju bë se edhe vetë ishte një anëtarë i asaj orkestre që i bënte malësorët shqiptar me faj!

Karroca doli nga errësira malore. Ishte një hapësirë e rrethuar me ara të mbjella me të lashta, dhe livadhe. Kuajt kishin zënë të vraponin. Hëna kishte nxjerrë faqen e ndritshme prapa malit. Van Joviqi lëvizi pak nga vendi për të zënë vend më mirë. Mendja i shkojë të stolitë dhe të disa gjetje të tjera të rastit që tani ashtu të grumbulluara dhe në errësirë të plotë kishin zënë vend në thesin e tij, që e mbante të shtrënguar në dorë, sikur të kishte frikë se nga lëkundjet e karrocës mund t'i humbiste.

– E kujt i takonin vallë këto stoli? – pyeti befas Fransua.

Van Joviqi shikoi vëngër fytyrën e tij që nuk shquhej dot në dritën e zbehët të hënës, se çfarë shprehje kishte! Nuk ishte në gjendje të përcaktonte as shprehjen e fytyrës së vet së në cilin anë ndodhej! Në anën e nënshtrimit servil, apo të kundërshtarit kryengritës! Për të dytën herë imagjinoi siluetën kryengritëse të

arkeologut të shquar shqiptar Shtjefen Gjeqovit.

– Ndonjë familje mbretërore dardane. – tha pas pak, dhe ju duk se vetvetiu mori anë e kryengritësit.

Karroca ndalojë pranë ndërtesës së bashkisë. Van Joviqi zbriti i pari, duke u mbajtur pas krahut të Fransuasë. Hëna derdhte rrezet e argjendta mbi kullat e heshtura të katundit të vogël. Që nga larg, si të venitura vinin damë-dumet e tupanit. Dasma vazhdon, mendoi. Dita e dasmës nuk shtyhet, thotë kanuni i tyre. Krushqit nuk kthehen pa nuse, edhe nëse ajo ndodhët ne shtratin e vdekjes! Krushqve s'u ndalët udha, por as nuk lëshojnë udhë!...

Si e hutuar u dëgjua e lehura e një qeni. Para ju doli kantinjeri. Thesin e mori dhe e dërgoi në sallën e madhe prapa ndërtesës, pastaj ju priu drejt kantinës. Aroma e këndshme e fasules ia gudulisi hundët. E ndjeu se kishte uri. Zuri vend në ballë, aty ku ishte vendi i tij i preferuar.

– Doni verë gospodine? – pyeti kantinjeri me ndrojtje.

Van Joviqi pohoj me kokë. Derisa ai u largua për ta sjellë kungullin me verë, Van Joviqi e shikoj nga mbrapa. Kishte kohë se i bëhej se në strukturën e trupit të tij kishte diçka hileqare. Sa herë vinte për të marrë ndonjë porosi, kurrë nuk e shikonte në sy, por shikimin e vërtiste diku anash. Ndoshta edhe ky i takon orkestrës servile.

Pasi kishte përfunduar së ngrëni, kantinjeri i mori enët nga tryeza dhe u largua. Para se të largohej si zakonisht pyeti:

– Doni edhe gjësendi zotërinj?

– Jo, jo! tani mund të shkosh. – ju përgjigj Van

Joviqi.

Stolitë duhet të kenë trajta ilire dhe trako-kimere, filloi të shkruante në bllokun e tij Van Joviqi. Tuma duhet të jetë princërore dhe shumë luksoze për kohën. Për këtë më se miri flet diadema! Dukej se i takonte shekujve të shtatë apo gjashtë para erës së re! Kjo duhet të restaurohet dhe të konservohet në laboratorët e specializuara të Zagrebit. Edhe stolitë e tjera si vath ari me koka negroide, byzylyk me mbërtheckë ari, shishë parfumi... kokat amfore antropomorfe, urnë, enë, fibul gjyslykore, përkrenare nga bronzi, vath ari, olpë, kupë, sëpata dytehëshe, drahmë të Dyrrahut, apo e Apolonisë... të gjitha duhet të dërgohen atje! Një thesar i pakrahasueshëm për arkeologjinë!...

*

Koha u prish. Van Joviqi arriti në qytezë. Shiu sa kishte pushuar. Pasi zbriti nga karroca, hyri në zyrën e postës dhe kërkoi një lidhje për bisedë telefonike. Pastaj iku në dhomën e tij.

Pas një dushi të ngutshëm, u gjend në ndërtesën e postës. Mori telefonin që ia zgjati telefonisti. Që andej, të shpërndara vinin copa fjalësh.

Pas përfundimit të bisedës, doli buzëvarur. I trishtuar u nis drejtë kafenesë. Dita e vërejtur dhe e pa trajtë, që nuk dallohej dot se çfarë kohe ishte, ia zymtoi, jo vetëm pamjen, por edhe mendimet. Të rrahurat e tupanit, i erdhën si bubullima nga qielli. Dikush kishte dasmë. Edhe në kohë luftash martohen njerëzit, mendoi. Martohen edhe në kohë sëmundjesh apo zie! Ju kujtua dasma e tij. Edhe ajo kishte ndodhë në kohë trazirash.

Nusen ia kishin sjellë një grusht njerëzish fytyrëngrysur si rresht kortezhi. Në oborrin e vogël të shtëpisë, një tufë vajzash ishin hedhë në valle... dhe asgjë më tepër!

Me shpirt të vrarë, e hapi derën e kafenesë. Në atë gjysmerrësirë dallojë silueta njerëzish. Para se t'i shihte njerëzit, ndjeu erën e rëndë të tymit të duhanit. Pastaj i pa edhe ata vetë, që rrinin në këmbë pranë banakut të vjetër e plot zdralë. Kurse të tjerët rrinin të ulur kruspull në ndenjëse druri. Në atë gjysmë errësirë ju dukën si trungje të kalbura mali. Një copë herë vërtiti shikimet sa majtas e djathtas, duke kërkuar një vend të lirë për t'u ulur. Befas, në qoshe pranë dritares, pa Fransuan i shoqëruar nga etnografi. Pasi u afrua, pa se pranë tij kishte zënë vend Miliqi. Pas një përshëndetje të vrarë, zuri vend pranë tyre. Kamerieri, një i ri thatak, ju gjend pranë. Porositi raki. Të pranishmit, pasi ishin ngopur së shikuari në drejtim të tij, ia krisën muhabetit me zë të lartë. Tani e vërejti së aty ishte tollovi. Kthehu kokën andej për t'u siguruar se tollovia kishte qenë e pranishme aty para se të hynte vet në kafene, apo ishte krijuar pas arritjes së tij!? Duke i shikuar ato fytyra të vrazhda, mendja i shkoi të programet e qeverisë për kolonizimin e tokave shqiptare. Këta njerëz ishin pjesë e atyre programeve, kurse vet ishte pjesë e këtyre njerëzve! Dallimi ishte se loja me ta, kishte filluar pa arritur ata këtu, kurse loja me të po fillonte tani! Ende pa e përfunduar mendimin, në këndin tjetër ia zuri syri ekspertin rus të gjeologjisë, Sergej Ivanovin. Ai ngriti dorën në shenjë përshëndetje. Van Joviqi i dha shenjë të ulej në tryezën e tyre. Ai erdhi menjëherë. Dukej i gëzuar. Pas përshëndetjeve të zakonshme ra heshtje. Ndërkohë, kamerieri e solli rakinë.

– Si shkojnë punët e gërmimeve? – pyeti Sergej Ivanov sa për ta thyer heshtjen.

– Mirë! – u përgjigj shkurt Van Joviqi.

– I keni rënë në gjurmë shtatores së Shën Bogorodicës?

– Jo! Nuk kemi gjetur asgjë, përveç disa thyerjeve. Nishea[30] dhe krepisi[31] janë zbuluar. Gjurmët tregojnë se shtatorja është zhdukur gjatë kohës së shkatërrimit të manastirit nga ushtritë mongole! Po nga ana e juaj, si shkojnë punët?"

– Jo sa kemi pritur! Jemi duke u përgatitur për një shpim të dytë. Shpresat janë të vogla në krahasim me këmbënguljen e majorit!

– Majori mendon të bëhet i pasur me zbulim nafte! – tha buzagaz Fransua.

– Ka të drejt, kur një pjesë të financimeve e bënë vet!

– Ashtu!?... – shqeu sytë i habitur Van Joviqi.

Ra heshtje. Rreth tyre dëgjoheshin copa bisedash. Van Joviqi e ndjeu vetën të huaj në këtë qytezë gri, po ashtu të huaj. Edhe në mesin e atyre njerëzve – kolonizator, ndjehej i huaj! Edhe ata sigurisht se ndjeheshin të zhgënjyer dhe të huaj! Këtu çdo gjë ishte e huaj, e largët, dhe e pakapshme përveç gënjeshtrave. Ato nuk ishin të huaja. Ishin pjesë e atyre që i kishin pjellë me kohë, dhe tani çuditërisht të rritura, të stërholluara në mënyrë shkencore dhe të sjellura nga larg për tua servu vendasve, kolonëve, nëpunësve e xhandarëve... dhe në fund edhe vetvetes! Për t'u bërë të besueshme gënjeshtrat, ishin falsifikuar dokumente të

---

30 Pjesë e harkuar e një muri për vendosjen e skulpturës.

31 Bazament i një monumenti.

vjetra duke filluar nga sundimi i Millutinit, „Regnum Rassia," deri të perandoria Nemanjiqe. Edhe miti serb i Kosovës ishte zier në kazanët e gënjeshtrave ruse. Për ti detyruar shqiptarët t'i besojnë këto gënjeshtra, përdoret kamxhiku, shkopi, burgu dhe plumbi... dhe pastaj të gjitha besohen! Besohen edhe gënjeshtrat e xhandarëve, gënjeshtrat e vojvodëve, gënjeshtrat e mësueseve dhe të akademikëve... kurse të vërtetat rrinë të fshehura në epikën e tyre legjendare, në dokumentet e huaja, në depot e shumta arkeologjike të mbuluara nën dhé në tokën e tyre, të fshehura pas veshjeve të tyre mijëvjeçare, dhe të struktura nën plisat e tyre të bardhë si në kullat e ngujimit... gënjeshtrat e kanë radhën për të marrë gjak!

Tani e kuptonte se misioni i tij ishte i vendosur në dy shtylla, të kundërta me njëra tjetrën. Duhej të gërmonte e të hidhte dritë mbi gjurmimet arkeologjike siç e kërkon kultura arkeologjike, apo të gërmonte, e pastaj t'i zhdukte ato gjurmë siç e diktonin? Ishte e kotë të gënjente vetën me iluzione. Këtu ndryshonte çdo gjë. Ardhja e tij, dhe fillimi i parë i gërmimeve kishte qenë vetëm pjesa fillestare e atyre rregull-gënjeshtrave të heshtura. Të tjerat, dhe ato më kryesorët, kishin filluar t'i shfaqeshin gjatë qëndrimit të tij në zonat e gërmimeve. Kurse e vërteta, zakonshmja, e papërlyera kishte mbetur e ndryrë në kasafortën e tij bashkë me shënimet, dhe skicat planimetrike. Tamam si në kullën e ngujimit! Athua vallë, kush e ka radhën tani!

Dallimi në mes të kolonëve, ushtrisë dhe xhandarmerisë kundrejt ekspertëve nuk ishte i madh. Që të gjithë ishin të lidhur ngushtë me njëri-tjetrën, sa që askush nuk e dinte se ku fillonte pjesa e të parëve

dhe ku mbaronte pjesa e këtyre të fundit. Që të gjithë kishin ardhur për të njëjtin qëllim: për tua hedhur fajin vendasve, për t'i gënjyer, për t'i vrarë dhe për t'i degdisur tutje në Azi e gjetiu!

Van Joviqi ktheu me fund gotën e rakisë.

– Pas përfundimit të gërmimeve në Manastirin e Shën Bogorodicës, ku do të gërmoni pastaj? – pyeti Sergei Ivanov.

– Së pari do të bëjmë konservimin e mureve të manastirit, e pastaj... në plan kanë qenë varrezat tumulare dhe bazilika para krishtere në Bajë, por...

– Ah, po! Me ka folur patriku për të. Është manastir i vjetër serb!

– Unë nuk kam bërë hulumtime për ta përcaktuar se e kujt ishte bazilika para krishtere. Kam bërë ca matje sipërfaqësore dhe kujtoj se teknika e ndërtimit të mureve i takon shekujve të gjashtë e të katërt para erës së re.

– Kështu mendohej edhe për manastirin e Sveti Bogorodicës. Po, ja që doli një monument origjinal serb, i shkatërruar nga vendasit barbarë gjatë dyndjeve të mëdha serbe! – foli etnografi duke ngritur gotën e rakisë.

– Këto janë zbulime gazetarësh!... unë nuk kam thënë asgjë në këtë drejtim! – u përgjigj Van Joviqi duke tundur dorën në shenjë nervoze.

– Si? – pyeti i habitur Sergej Ivanov.

– Këto s'janë asgjë! Themelet e një manastiri mesjetar në krahasim me qendra arkeologjike të shekujve gjashtë para erës së re, janë hiç! Sikur të nxirreshin në sipërfaqe përbërjet arkeologjike në Bajë, atëherë po! Atëherë do të mburresha edhe unë!

– Edhe ato do të nxirren në sipërfaqe! – tha Miliqi dhe vazhdoj: – por jo tani. Duhet të presim një kohë tjetër, mendoi një kohë që do të na përshtatet ne!

– Nuk ju kuptojë zotëri! Me duket se nuk jeni të kënaqur me punën tuaj? – foli kësaj radhe si me qortim etnografi.

– Aspak! – ia kthej prerë Van Joviqi.

– Si aspak?... Pak të dukët ty, që sa kohë mbushën faqe të tëra të gazetave me tituj sensacional!?: U zbuluan themelet e manastirit të Sveti Bogorodicës! U hodh dritë mbi shkatërrimet barbare gjatë dyndjeve të mëdha serbe! Manastirin e Sveti Bogorodicës e shkatërruan shqiptarët... pak të duken këto ty? Unë do të krenohesha po të isha në vendin tuaj!

– Këto që ju i thoni zotëri, janë zbulime gazetarësh! Manastiri është ndërtuar shumë shekuj para se të zbrisnin sllavët në Ballkan! Pas okupimit të Kosovës së sotme nga ushtritë e Zhupanit të Rashës, vllaho-ilirit Nemanja, është bërë edhe adoptimi i kishave e manastireve nga ana e kishës së Shën Savës. Ndryshimet e dallueshme janë shfaqur pasi besimi roman-katolik ishte shpallur herezi nga ana e Car Dushanit. Me një fjalë, nuk ka pasur ndërtime të reja të kishave apo të kalave, siç pretendohet të flitet sot, por ka pasur vetëm renovime dhe përshtatje të kishave e manastireve shqiptare, në ato serbe! Këto gjenden të shkruara edhe në krisobulat e kryepeshkopit serb Gulielm Adam! Edhe zbulimet e mia në Manastirin e Sveti Bogorodicës i përligjin këto thënie! – foli krejt qetë Van Joviqi, duke e kthyer me fund gotën e rakisë.

Për disa çaste mbajti shikimin të mbërthyer në një pikë të pacaktuar. Mendja i sillej vërdallë. Shikimet

vëngër të kolonëve i bëhej se e shponin me ato pyetjet e tyre të heshtura: „Le që ne na sollën këtu me lajka e gënjeshtra, po ty kush të solli?" i bëhej se e pyeste një zë nga brenda tij. Pastaj një zë tjetër, po ashtu brenda tij sikur i përgjigjej zërit të parë: „Gënjeshtrat më sollën edhe mua! Është kohë e gënjeshtrave! Ndaj, gënjeni edhe ju! Ç'më shikoni ashtu? Gënjeni... çfarë prisni?" ju bë sikur ju thoshte me zë të lartë kolonëve serb që e rrethonin! Pastaj, sikur të ishte qetësuar, vuri dorën mbi faqe duke e shtrembëruar pak kokën.

Pas pak, vështrimin gjysmë të fjetur e hodhi jashtë dritares. Në rrugën matanë, dalloi dy malësorë të veshur me rrobat e tyre karakteristike. Në dorë mbanin instrumente muzikore. Deri sa i shikonte malësorët, prapë ju kujtua dasma e tij, me atë grup njerëzish të zymtë që e kishin pru nusen! Kjo kishte ndodhur në dhjetorin e ftohët të vitit 1918, pak pas krijimit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene. Njerëzit kishin qenë të pakënaqur me një aleancë të tillë, e cila ua vente në pikëpyetje lirinë! Kishin kaluar pesëmbëdhjetë vjet që nga ajo kohë. Populli i tij kishte rënë në gjumë! Flinte! Kurse këtu? Që nga ajo kohë lufta vazhdon! Pasi lëvizi pak kokën të rënduar nga rakia, si nëpër ëndërr bëri një krahasim në mes të popullit të tij që e kishte dhuruar lirinë dhe, popullit shqiptar që e kishte humbur atë në fushë të betejës. Ju duk i pamundur rikthimit i lirisë së dhuruar, në krahasim me rikthimin e lirisë së rrëmbyer, për të cilën, me pushkë në dorë, ky popull, edhe sot e kësaj dite, e vazhdon luftën për liri!

– Janë rapsod shqiptar, shkojnë në Dasmë! – i sqarojë Miliqi.

– Guslla dukët sikur... – foli si më vete Van Joviqi.

– Është lahuta! Me të përcjellën këngët e tyre epike! – sqaroi Miliqi.

– Ku ka dasmë? – pyeti Sergej Ivanov.

– Në katundin e parë... jo larg nga këtu! – u përgjigj Miliqi.

– Kjo do të ishte në interes për studimet e mia! – foli Fransua Roger.

– Si do të reagonin ata, sikur edhe ne të shkonim në dasmën e tyre? – pyeti Van Joviqi.

– Do të na presin si miq! Do të na e lëshojnë kryet e vendit!... shtëpia e shqiptarit, është e zotit dhe e mikut! kështu thotë kanuni i tyre! – tha Miliqi, dhe pas një heshtje të shkurtër pyeti: – Dëshironi të shkoni?

– Me gjithë qejf! – u përgjigj Van Joviqi.

– Mua të me ndjeni se nuk vi dot! Nuk ndjehem mirë! – foli si me ankim etnografi.

Miliqi nuk foli, por vetëm e miratojë me kokë. Pastaj vështrimin e hodhi nga etnografi duke ia shkelë syrin tinëzisht Miliqit. Me buzën në gaz, u ngrit dhe priu i par drejt daljes.

*

Rruga ishte e ngushtë, me lisa e gjerdhe anash. Tutje shiheshin ara të mbjella me misër. Pa livadhe të kositura. Gjatë rrugës takoj fshatarë, të cilët porsa i diktonin, kokulur ua lironin udhën.

Asnjëri nuk fliste. Dëgjoheshin vetëm zhurma e guralecëve që krijohej nën peshën e çizmeve të tyre. Rruga, pas një bërryli, mori kah në të djathtë, duke u futur nëpër disa bokërima të shkreta, e pastaj në një mal të dendur e plot dushk. Ju bë se tutje, në thellësi

të malit, diku prapa ndonjë shkëmbi kishin zënë pusi kaçakët, të cilët të heshtur prisnin shfaqjen e tyre, dhe...

– ... Janë varre krushqish, – ia ndërpreu mendimet Miliqi dhe vazhdoi; – këtu në kohëra të vjetra që askush nuk i mbanë mend, thuhet se kur janë takuar dy palë krushq, asnjëra nuk kanë pranuar t'ia lëshojnë rrugën tjetrës, dhe janë vrarë të gjithë!

– Ishin shqiptar apo serb? – pyeti Van Joviqi.

– Jo, jo! shqiptar ishin! – u përgjigj Miliqi.

Van Joviqi kthej kokën andej. Në një shesh të mbushur me filiza të rinj shkoze, pa varre të vithisura. Ju bë se i pa ata krushq-kalorës, të veshur me tirq e xhamadan, kur shkonin kaluar për ta dërguar në shtëpi nusen e re dhe pikërisht këtu, ishin takuar me krushqit e një krahine, apo katundi tjetër dhe, asnjëra palë nuk kishte pranuar të skajohej në anën e poshtme për të hapur rrugë! Pastaj kishin krisë pushkët. Krushqit malësorë kishin zbrit nga kuajt për të zënë pozita më të mira duke shti pa ndërprerje, deri sa ishin vrarë të gjithë!

Përballë ju shfaq një kodër e vogël. Në fundin e saj u panë shtëpitë e para të katundit. Tupanët tani dëgjoheshin shumë afër, të shoqëruar me zërin gërryes të zurnave. Një turmë të rinjsh rrinin në këmbë buzë rrugës. Ata kthyen kokat drejt tyre. Pastaj, të heshtur ua lëshuan rrugën për të kaluar. Në fytyrat e tyre nuk kishte ndonjë shenjë urrejtje edhe pse dukeshin të ftohët. Akoma pa u afruar, njëri nga të rinjtë iku me vrap dhe u zhduk pas një dere të vogël, e cila u mbyll me kërkëllimë. Ndërkohë pushuan tupanët. Vendin e mbërtheu një heshtje hutaqe. Po nga ajo derë u pa të dilte një plak. Pasi ndalojë në prag të portës, vështrimin

e hodhi drejt tyre.

– A pret miq, o i zoti i shtëpisë! – thirri me zë të lartë Miliqi.

– Mirë se ju pruni Zoti!... – u përgjigj plaku po me atë shikim të akullt.

– A je burrë i fortë?! – pyeti Miliqi duke ia zgjatë dorën, në shenjë miqësie.

– I fortë e me faqe të bardhë! – ia ktheu plaku duke ua shtrënguar dorën me radhë.

Deri sa e ndiqnin pas plakun, Miliqi u përpoq t'ua përkthente fjalën „a je burrë i fortë," e veçmas fjalën „burrëri."

– Kjo fjalë e thjeshtë, – vazhdoi ai, – të shqiptarët ka domethënie të madhe, që nënkupton besën, guximin, qëndresën, mikpritjen, mbrojtjen e mikut nëse ai rrezikohet si dhe, faljen e armikut kur ai e kupton fajin dhe mbetët i dobët nën mëshirën e tij. Kjo fjalë të shqiptarët është e shenjt, e cila e shtynë shqiptarin të fiket me rob e pasuri vetëm për mos shkeljen e virtyteve të saj!...

Në oborrin e gjerë, kishte shumë të rijnë të cilët kthyen shikimet drejt tyre. Ashtu siç i kishte përshëndetur plaku më parë, edhe ata, me dorën në gjoks, me një përulje të lehtë i përshëndetën. Plaku siç ishte duke ju pri, ndaloi për një çast dhe u kthye nga Miliqi, i cili e kuptoi mimikën e tij, ndaj hoqi pushkën nga supi dhe ia zgjati plakut. Ai me pushkë në dorë, priu i pari drejtë derës së madhe të kullës.

Çarmatosjen aq të lehtë të Miliqit nga ana e një plaku, nuk e kishte menduar askush. Frika nga ndonjë grackë tani lëvizte lirshëm në fytyrën e çdonjërit. Miliqi, përkundrazi, e ndjente vetën shumë më të fuqishëm se

sa më parë kur e kishte pushkën në krah.

– Pra, – vazhdoi Miliqi me të njëjtin ton – tani ne, jemi në besën e të zotit të shtëpisë dhe fisit të tij. Për besën, apo fjalën e dhënë, shqiptari e vë në shërbim të saj jetën, plëngun dhe gjithë çka ka! Për shembull, nëse ne do të sulmoheshim nga dikush, këta do të vriten deri në shfarosje për të na mbrojtur ne, dhe fjalën e dhënë! Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut, – kështu thotë kanuni i tyre!

Në divahane kishte shumë burra. Me t'u shfaqur para tyre, u ngritën të gjithë në këmbë, dhe u kthyen drejt tyre. Me dorë në gjoks, dhe me përulje të lehtë i përshëndetën. Plaku u priu deri në odë. Edhe aty kishte shumë burra. Edhe ata i pritën në këmbë, me gjestet të njëjta. Në atë gjysmerrësirë, nuk ju dalloheshin fytyrat. Zunë vend në ballë, aty ku ua liruan të tjerët.

– U trashëgofshin! – foli Miliqi, duke ju drejtuar plakut.

– T'u rritë ndera! – ia ktheu plaku.

– Nderë e besë paq! – ia ktheu Miliqi.

Miliqi foli edhe për një copë herë me plakun. Plaku nuk fliste, por herë pas here luhaste kokën në shenjë miratimi. Pas pak, plaku bëri me shenjë tutje nga burrat. Njëri ju afrua pranë. Pasi i pëshpëriti diçka pranë veshi, ai iku në drejtim të derës.

Miliqi u kthye nga ata dhe me zë të ulët filloi të fliste:

– Ndera, të shqiptarët ka kuptimin e ruajtjes së moralit, zakoneve, traditave dhe gjuhës së të parëve. Këto janë virtyte të shenjta për ta, po i preke në këto virtyte, do t'i kishë armiq të përbetuar! „Dy gisht nderë në lule të ballit, na i dha i Madhi Zot!" – është thëne

nga kanuni i tyre.

Malësori plak ju dha shenjë valltarëve. Fare pranë tyre zuri vend një burrë, i cili në supe mbante të varur tupanin. Përkrah i rrinin dy burra me zurna në duar. Derisa ishte duke shikuar drejt tyre, pa dy valltar që kishin zënë vend në mes. U befasua kur pa së në shokat e tyre shumëngjyrëshe ju vareshin jataganët!

– Është valle epike dyluftimi, që karakterizon forcën e burrërinë. Kjo valle luhet kryesisht nga burrat! Ka ndonjë rast të rrallë që, në këto valle inkuadrohen edhe...! – u dëgjua të shpjegonte Miliqi.

E goditura e tupanit sikur i treti fjalët e fundit të Miliqit. Lëvizjet e valltarëve në fillim u dukën të ngathëta, të ngadalshme, të hareshme dhe sipas ritmit të rënave të tupanit, lëvizjet sikur u gjallëruan. Pothuajse në të njëjtën kohë ata nxorën jataganët nga brezi, duke ndryshuar stilin e kërcimit miqësor, në atë luftarak. Lëvizjet e gjymtyrëve dhe të trupit, mimika, shprehjet përmes lëvizjeve, shprehja e mllefit kundër kundërshtarit, reflekset, të gjitha këto ju dukeshin Van Joviqi sikur ishte duke ndodhur një gjakderdhje e vërtetë. Ishte drama e tyre tragjike e vënë në lojë!...

Ritmet e shpejtuara sikur filluan të ngadalësoheshin. Valltarët lëviznin ngadalë, duke i ndeshur në të rrallë jataganët që i mbanin në duar. Dukej se ishin të lodhur nga dyluftimi, dhe nga çasti në çast do të rrëzoheshin. Tamam në kohën kur Van Joviqi priste që njëri nga valltarët të mundej, të rrëzohej, të jepej apo të përfundonte vallja pa të mundur, u dëgjua një zë i tmerrshëm femre! Muzika pushojë. Qetësja dominonte, ngrirja e valltarëve në pozita kryengritëse e bëri Van Joviqin të mendonte vetëtimthi së vërtetë po ndodhte

diçka e tmerrshme rrotull tyre. Akoma pa u tmerruar nga ndonjë e papritur, filluan gjëmimet e tupanëve dhe zëri kumbues i zurnave. Në arenën ku ishte zhvilluar dyluftimi, u pa të futej triumfalisht një vajzë! Në të njëjtën kohë burbulluan të goditurat e tupanit të përcjella me zërin gërryes të zurnave. Vallja mori hov. Valltarët sikur përpiqeshin të gjenin një rast të përshtatshëm për të goditur kundërshtarin por, po në atë drejtim hidhej vajza duke ia kursyer valltarit të goditurën. Pastaj, po me të njëjtin ritëm kthehej nga valltari tjetër duke e penguar edhe atë, dhe në fund pasi mori dy shamia që i kishte të lidhura në tojat e pështjellakut, dhe me duart lart, njërën ia dhuroi valltarit që e kishte përballë, dhe pastaj ajo u kthye nga ana tjetër dhe, gjithnjë duke kërcyer sipas ritmit të tupanëve, ia dhuroj shaminë tjetrit valltar. Ritmi i të rënave të tupanit u ngadalësua dukshëm duke i ngadalësuar edhe lëvizjet e valltarëve. Pasi i futën shpatat në brez u përqafuan me njëri tjetrin në shenjë pajtimi! Ndërkohë, edhe muzika pushoi.

Van Joviqi i shikonte i mahnitur malësorët valltarë, të cilët kishin zënë të largoheshin. Pastaj e kërkoi me sy vajzën që kishte kërcyer pak më parë, por nuk e pa gjëkundi! Ndërkohë, dëgjoi zërin e Miliqi!

– Po u fut gruaja në mes të dy burrave të cilët janë në kacafytje e sipër, ata nuk guxojnë të vazhdojnë përleshjen por duhet të ndahen menjëherë! Gruaja nuk bie në gjak, thuhet në kanun.

Në arenën e krijuar më parë për valltarët, ia behën dy malësorë të tjerë. Zunë vend në mes të sheshit rrethuar me burra. Njëri, mbi gju e vendosi lahutën. Pasi pështpëritën diçka në mes tyre, vështrimin e hodhën nga plaku. Ai kishte një pamje të ngurtë. Siç dukej

nuk donte assesi të miratonte atë që rapsodët e kishin ndërmend të këndonin.

– Do të këndojnë për Betejën e Kosovës! – sqaroi Miliqi, me zë të ulët.

Van Joviqi pa nga afër gusllën e rapsodëve shqiptarë. Ishte shumë e ngjashme, për të mos thënë identike me gusllën sllave. Befas, ju kujtua libri i Aleksandër Gilferdingut, ku shkruante se serbët nuk ishin në dijeni jo vetëm për mitin e Kosovës, por as për Lazarin e Jugoviqët.

– Të shqiptarët akoma është i gjallë miti për Luftën e Kosovës. Në netët e gjata të dimrit, të ulur buzë vatre, pleqtë me krenari, ua rrëfejnë të rinjve legjendën e betejës së Kosovës dhe vrasjen e Sulltanit nga ana e Millosh Kopiliqit. Këtë gojëdhënë edhe unë, shumë herë e kam dëgjuar nga malësorët shqiptarë. Nuk ka shqiptarë që nuk e di këtë legjendë! – fliste Miliqi me zë të ulët, deri sa rapsodët përgatiteshin për t'ia nisë këngës.

Rapsodët, çuditërisht vazhdonin të rrinin këmbëkryq. Vështrimet e tyre të qelqta, herë-herë i hidhnin në drejtim të mysafirëve të paftuar. Pamjet e tyre të dyzuara, jepnin një tablo mospërfillëse ndaj grupeve që e rrethonin. Këto vinin si shkarkim i dyshimit ndaj të paftuarve dhe zhgënjimit ndaj të zotit të dasmës, i cili dukej të ishte i pasigurt nga prania e të paftuarve, ndaj vazhdonte ta shtynte sa më larg urdhrin për t'ia filluar këngës.

– Mund t'ia filloni! – ndërhyri Miliqi me një zë të butë, pasi i kishte vërejtur dyshimet e tyre.

Rapsodët, sikur ta kishin bërë me fjalë, të dy hodhën vështrimet e tyre drejt të zotit të dasmës, i cili miratoi

me luhatje koke.

Ai që e mbante lahutën në prehër, lëvizi pak për të zënë vend më mirë. Ngriti dorën. Pasi e tundi lehtë harkun, e vuri mbi fillin e lahutës. Tingulli doli kumbues, me një zik-zake të zgjatur sikur vinte nga një kohë e vjetër, e humbur nga lashtësia. Van Joviqit ju bë se ai ton i zgavruar i lahutës, e mori nga kjo kohë dhe e degdisi në një kohë të lashtë, ku nga çasti në çast pritej të fillonte beteja. Pas pak, lahutari hapi gojën të këndonte. Van Joviqi ndjeu një lehtësim, pasi zëri i tij, i njëjtësuar me tingullin e lahutës, sikur e solli prapë nga ajo kohë e lashtë! Zëri filloi të shkoqitej vetëm atëherë kur fjalët filluan të ndahen në rrokje.

M'ish kenë Sulltan Murati...

...dhe akoma pa përfunduar zëri i rapsodit të parë, një me zërin e zgjatur të lahutës u ngjit zëri i rapsodit të dytë.

Mirë avdes kish pas' marrë,

Miliqi arriti përmes pëshpërimës t'i përkthente ato që rapsodët i thoshin njëri pas tjetrit.

Kënga epike vazhdonte. Van Joviqi, ia kishte ngulë vështrimin kapakut të lëkurtë të lahutës, që mbulonte atë zgavër druri, sikur ishte duke u përpjekur t'i ndrynte brenda asaj zgavre rënkimet mijëvjeçare të një populli, që nga larg i vinte, si pjesë e shpirtit të tij!

Ishte e mundur vallë që ajo copë druri e vogël e mbështjellë më lëkurë, të mbante mbi vete shekuj të gjakosur, ushtarë dhe kalorës të molisur, shpata e shtiza

të skuqura nga gjaku. Ju bë se nga goja e rapsodëve tani nuk vinin ritme muzikore por klithje e britma të dhimbshme ushtarësh, hingëllima kuajsh, copa urdhrash, gjëmë dhe dënesa të padëgjuara ndonjëherë në jetën e tij. Ashtu sikurse edhe valltarët më parë, edhe lahutarët, këndonin tragjedinë e tyre të përmotshme të vënë në epos!

Millosh Kopiliqit fjalë i ka çua,
E teslim ti me mu ba!...

Van Joviqi ju afrua Miliqit. Ai ishte duke ia përkthye Fransuas pikërisht at varg. Përshtypje i bëri se edhe Miliqi sikurse edhe rapsodët shqiptarë, mbiemrin e Milloshit e thoshin Kopiliqi. Ishte hera a parë që e dëgjonte këtë, dhe jo nga shkrimet e emisarëve serb të „Naçertanies", por nga goja e rapsodëve analfabetë shqiptarë!

Një burrë ju afrua pranë Miliqit dhe i pëshpëriti diçka të veshi. Miliqi e miratoji me kokë, pastaj vështrimin e hodhi nga i zoti i shtëpisë. Pa u vënë re u ngrit dhe u zhduk në mesin e burrave.

Çojke kamën Sulltani me ja dhanë,
Ky Milloshi, në dorë hanxharin e kish pas,
Me hanxhar Sulltanit i ka ra...

I humbur pas fjalëve të eposit, i bëhej se ato zëra nuk ishin të kësaj bote, por ishin zëra të ardhur nga një kohë e largët, e harruar nga populli sllav. Ishin të kota përpjekjet e naçertanistve për sajimin e tyre! Ato i kishte shkelur koha, i kishte mbuluar pluhuri i errët e harresës

shekullore. Ju bë se e pa Millosh Kopiliqin, i veshur në tirq me gajtanë, me përkrenare e parzmore tunxhi, me hanxharin e tij të gjakosur që e godiste Sulltan Muratin, pasi ai ia kishte zgjatur këmbën në shenjë nënshtrimi, e jo dorën për pajtim! Pastaj, pa njerëzit rrotull tij, pasardhës të po atij populli kryengritës që kishin jetuar nëpër male e shpella duke prerë sulltan e vezir, për t'i ruajtur virtytet e të parëve të tyre, pa i këmbyer me liri e pasuri nënshtruese, sikur të populli sllav, që pas humbjes së betejës së Kosovës kishin pranuar nënshtrimin e sulltanit. Ndërsa sot, priftërinjtë dhe naçertanistët vajtojnë si mëllenjat disfatat e të parëve të tyre!... Këto virtyte të shqiptarëve, të ruajtura me xhelozi ndër shekuj, krijuan eposet e famshme, dhe ja tani, nga dy malësorë rapsodë, riktheheshin me shekuj prapa, duke u takuar në fushën e betejës me Millosh Kopiliqin! I bëhej se i dëgjonte vringëllimat e shpatave mbi kokën e mbrojtur të Milloshit, dhe aty fillonte ikja, zhgënjimi, tradhtia... por tani nuk e ndante dot, ishte ikja e Millosh Kopiliqit të tradhtuar nga shkina plakë, apo ishte ikja e tij nga rapsodët shqiptarë, të armatosur me epin e tyre plot gjak!

VI

Shiu kishte pushuar. Retë ishin shpërndarë. Qielli kishte marrë një pamje të kristaltë. Tutje nga kopshti vinin të gëzuar cicërimat e zogjve. Dielli, sa nuk ishte fshehur prapa maleve të Rugovës. Avulli i nxehtë që vinte nga toka e ngrohët dhe e lagur nga shiu, të përzier me aromën e trëndafilave, jepte erë të këndshme. Mila zbriti shkallët e drunjta dhe doli në oborr. Ashtu e vetmuar, u ul në stolin e drunjtë prapa kullës. Shikimin e hodhi nga kopshti, që kishte marrë një pamje të freskët pas shiut. Të rënat e tupanëve vazhdoni! Si nuk u lodhën vallë?

Sikurse çdo mbrëmje, edhe kësaj radhe mendja i shkoi të arkeologët. Qysh nga ajo natë, kur kishin qenë mysafir në shtëpinë e tyre, nuk i kishte parë më. Thuhej se ishin përqendruar në themelet e një kishe të vjetër, dhe nuk shqiteshin dot. Kishte pasur një parandjenjë

se ditët me shi vetvetiu do t'i sillnin drejt qytezës, do t'i afronin shumë afër saj por... sikurse edhe herëve të tjera, do t'i kapërdinte kafeneja e madhe në qendër të qytezës, dhe prapë do të ktheheshin prapa pa i parë, mendoi e trishtuar!

Disa herë e kishte dëgjuar të shoqin të fliste i zëmëruar kundër tyre, e veçmas kundër Van Joviqit. Siç dukej ai nuk i përmbushte urdhrat e tij, ose nuk ju përmbahej rregullave ushtarake për zbulimin e atyre vjetërsirave të përlloçura. Mos vallë, kishte nuhatur diçka nga ajo mbrëmje, kishte menduar sa e sa herë me vete Mila, dhe tani nga xhelozia, gjithë inatin e shfrynte kundër Van Joviqit, duke e kursyer me qëllim fajtorin! Ky mendim e pickonte si gjarpër i pabesë, duke ia helmuar kujtimet e këndshme!

Pastaj, në imtësi i kujtonte ato çaste të pa përsëritshme në jetën e saj: Largimin në korridorin e errësuar pikërisht prej saj, dhe shtrëngimin nga duart e tij. Shumë herë i kishte kujtuar ato çaste duke i ngatërruar me imagjinatën e saj. I bëhej se atë natë, pas të shtënave të gjithë kishin ikur të frikësuar dhe, aty kishte mbetur vetëm për vetëm me Fransuan… pastaj, për t'ju ikur shikimeve kureshtare të shërbëtorëve, ishin futur në kthinën gjysmë të errët në fundin e hajatit dhe aty... Në ditët pasuese e kishte vizituar kthinën. Ishte një kthinë që e shtynte drejt imagjinatës. Më pas, i kishte urdhëruar shërbëtorët ta rinovonin dhe të vendosnin aty tryezën dhe minderin, për të pushuar në freskun e saj, në ditët e verës plot vapë. Edhe pse nuk donte assesi t'ia pohonte vetës gjithë veprimet e gjertanishme në lidhje me kthinën, e ndjente se motivi për rregullimin e saj lidhej pikërisht me kujtime të këndshme për të huajt...

në fund të fundit, mendonte ajo, nëse do të hetohej, mbrojtjen e kishte të siguruar. Mjaftonte të thoshte se dikush kishte bërë përpjekje për dhunim, dhe nga ana e saj çdo gjë do të mbyllej. Do të vazhdonin hakmarrjet e heshtura të majorit kundër atyre që kishin guxuar t'ia përlyenin nderin! Kaq!

Sikur t'ia kishte pikasur mendimet i shoqi, disa herë e kishte ftuar drejt kthinës, por Mila nuk kishte pranuar. Një frikë tinëzare kishte filluar t'i depërtonte në çdo pjesë të trupi. Aq shumë kishte qenë e dhënë pas të huajve sa që kishte pasur raste që nuk e ndante dot nëse vetëm i kishte menduar, apo kishte folur me zë të lartë për ta gjatë dremitjeve, duke e zbuluar sekretin. Pastaj, si me zor e shqiste atë mendim të frikshëm, duke e lidhë me dëshirat tekanjoze të majorit.

Ndërkohë, ju bë se dëgjoi hapjen e portës së oborrit. Pastaj dëgjoi kërkëllimën që u mbyll, dhe hapat e dikujt që po ecte drejt hyrjes. Dëgjoi zëra. Eci ngadalë deri të këndi i kullës sa për të parë se kush ishte. Në mesin e luleve të trëndafilit, pa si të thyera siluetën e Miliqit, dhe fare pranë derës së hyrjes mezi e dalloi majorin. Tamam në kohën kur po bëhej gati të shfaqej për t'ju uruar mirëseardhje, dëgjoi Miliqin:

– … Van Joviqin me dy të huajt i lash vetëm në kullë... atje ku po bëhet dasma! Janë në besën e të zotit të shtëpisë!

– Ide e mrekullueshme, apo jo? Janë vetëm ata të tre, apo ka edhe të tjerë me ta? – pyeti pas pak majori.

– Vetëm ata! Me një gurë do t'i vrasim dy zogj! – u përgjigj Miliqi me zë të ulët!

– Shumë mirë! Nesër do të arrijnë edhe gazetarët… rast i mrekullueshëm! – tha majori, pa e fshehur

entuziazmin. Pastaj me zë serioz pyeti: – në çfarë kohe kthehen?

– Krejt varet nga ne! Të zotin e shtëpisë e urdhërova mos t'i lëshon të dalin nga kulla derisa unë t'ju çoi fjalë!– tha Miliqi.

– Mirë! Ku ndodhet çeta e Agë Batushës, është afër? – pyeti majori.

– Jo, ai ndodhët shumë larg! Afër e kam Naipin e Dautit me dy të tjerë!

– Mirë, atëherë të lajmërohet ai. Kurse ti rri në distancë me njerëzit tuaj! Mbaje nën kontroll situatën. Pritat të zihen të Varret e Krushqve! Ndërsa unë do të kujdesëm për thesarin arkeologjik!... Ke kujdese, nuk dua të vrarë!

– Mos ke fare merak!... ujk i vjetër jam unë! – tha Miliqi duke qeshur, dhe u nis drejt portës në fundin e oborrit. Majori hyri në kullë. Deri jashtë dëgjoheshin hapat e tij duke i ngjitur shkallët e drunjta.

Për një copë herë Mila mbeti e shtangur. Mizëri mendimesh i shkonin nëpër kokë! Ishte e mundur vallë? Nga biseda e tyre e kuptoi se diçka e tmerrshme po përgatitej kundër të huajve. Pritat të zihen të Varret e Krushqve... pastaj thesari!... o zot! Ndoshta i ka rënë në erë punës tonë!... ndoshta i di të gjitha... ndoshta ai ka biseduar për mua në rrethe të ndryshme dhe ato fjalë i ka dëgjuar majori… tani do të hakmerret kundër tij!... Nuk dua të vrarë tha! Medoemos, i do të gjallë, për t'i marrë në pyetje! Ata do të kthehen natën vonë, të shkujdesur dhe, në dritë të hënës diku në mes të varreve do të ndodhë përleshja! Do t'i zënë si lepujt në qark, dhe me duar të lidhura do t'i fusin në burg! Aty, pastaj duke i marrë në pyetje naçallniku do të më përmendin

mua... jo, jo! nuk bënë të rri kështu! Do të ndërmarr diçka për t'ju dalë në ndihmë atyre edhe vetës! Te fundi i fundit, vetëm emri im mos të përmendët. Po thesaret?... gazetarët... çlidhje kanë këto me mua? Pyeti vetën e hutuar!

*

Mila hyri lehtë në studion e majorit. Ai, si gjithmonë rrinte ulur në kërrigën e tij pranë shkresave të shpërndara në mënyrë të çrregullt mbi sipërfaqen e tavolinës.

– Ishte Miliqi këtu? – pyeti Mila derisa ulej në kolltuk.

– Po, pse? – foli majori pa interes.

– Sikur biseduat rreth një pusie me njerëzit e tij! – tha Mila me një vështrim zhbirues.

– Pse e lodhë vetën kot me këto gjëra? – pyeti majori i habitur duke u kthye i tëri drejt saj, dhe vazhdoi: – fshehtësi ushtarake... punë shteti!... ende s'u mësove me to?" – tha me buzëqeshje. Pastaj u ngrit nga karrigia e tij dhe zuri vend pranë saj, duke zgjatur dorën për t'ia ledhatuar faqen! Mila largoi kokën në anën tjetër me neveri. Ashtu e inatosur, u ngritë në këmbë dhe doli jashtë.

Koha ecte shpejt. E vetme, nuk bënte dot gjë! Disa herë i shkoi mendja të gruaja e naçallnikut. Sikur të shkonte deri të ajo. T'ia tregonte hallin, dhe së bashku të gjenin ndonjë zgjidhje. Por, ja që shkova! Çfarë ti them? Çfarë ti tregoi e çfarë ti fshehë?... ata ndodhën në kullën e një malësori shqiptar! Si të futemi në atë kullë ku ka dasmë, në mes të atyre njerëzve? Për çfarë

do të na marrin? O zot... e pamundur! E trishtuar u ulë në minderin e madh në dhomën e miqve. Tani u bë ç'e kishte ndërmend të bëhej! Ata, sigurisht tanimë i kanë zënë pritat! Le të dalë ku të dalë!

Mendimet ia treti kuisja e derës së zyrës së majorit. Ai, si hije e zezë nate doli. Si gjithmonë, në raste të aksioneve të tilla nuk fliste fare. Edhe kësaj radhe doli i heshtur si prej varri dhe me nxitim i zbriti shkallët. Pas tij u dëgjua vetëm kërkëllima e derës që po mbyllej! Mila me të shpejt doli në dritare. Nga lartë, në atë gjysmerrësirë, pa trupin e tij të shkurtër që me hapa gjysmë ushtarak doli nga porta e oborrit.

Errësira kishte mbuluar dritëhijet e kullave. Një erë e freskët, por e ashpër tundi gjethet e pemëve në kopsht. Nga dritarja e hapur, hyri një vrushkull i ajrit të freskët, duke i përplasur kanatat. Mila mbylli dritaren. Pastaj hyri në dhomën e saj dhe filloi të gjvishej. Me ngutë donte t'i ndërronte rrobat dhe të dilet nga kjo kullë misterioze që herë-herë, i bëhej se ishte varri i saj për të gjallë! Cak ishte gruaja e naçallnikut, të cilës do t'ia tregonte hallin. Edhe ajo, jo në herë, i kishte treguar aventurat e saj! Gjithsesi ishte më mirë! Tamam në kohën kur ishte fare lakuriq, dëgjoi një trokitje të njohur dere.

– Prit pak! – thirri Mila, pastaj mori pelerinën dhe e hodhi krahëve! Me nxitim e hapi derën dhe me inat pyeti: – Hë, çfarë do tani?!

– Darkën zonjë... ua solla darkën! – foli me ndrojtje shërbëtori duke mbajtur në dorë tabakun.

E hutuar, vështrimin e hodhi mbi tabak. Era e këndshme e mishit të pjekur ia gudulisi lehtë hundët por nga hutimi ajo nuk e pa mishin, por vetëm copën

e prerë të djathit, që ditë më parë ua kishte sjellë nga bjeshka Keq Syku.

– Keq Syku!... ah... ai!... – mërmëriti si me vete, sa mezi u dëgjua. Pastaj me një shpejtësi marramendëse në trurin e saj skicoi Keq Sykun, i veshur me rroba të zeza që qante me shpejtësi drejt atyre bokërimave për t'u futur në atë kullë të rrezikshme, në mes të asaj zallahie, në mes të zhurmës e klithjeve, në mes vallesh e këngësh, për t'i lajmëruar...

– The gjë zonjë? – ia ndërpreu mendimet shërbëtori!

– Mundë ta gjesh... tani menjëherë më duhet? – pyeti Mila krejt e hutuar, pasi instinktivisht nga dora ia kishte marrë tabakun me ushqime.

– Cilin zonjë? – pyeti i hutuar shërbëtori.

– Keq Sykun thash...

– Tani sa e lash në kafene! Pse, të ka ndodhur gjë zonjë? – e ndërpreu shërbëtori plak.

– Shko e gjeje! Urgjentisht sillma këtu!... dhe shshsh, askujt asnjë fjalë! Kur të vini, hyni nga dera e kopshtit, a more vesh!

– Si urdhëro zonjë! – tha shërbëtori dhe filloi t'i zbriste shkallët me nxitim.

Koha deri sa u dëgjua dera e kopshtit të hapej, ju duk tmerrësisht e gjatë. Disa herë doli në dritare duke shikuar jashtë. Nata kishte mbështjellë çdo gjë në gjirin e saj. Xixëllonjat endeshin të qeta në kopshtin e saj me barkun e tyre të prushtë. Ju bë se edhe barku i saj po digjej nga i njëjti prush. Qindra mendime të tmerrshme i shkuan nëpër kokë. Një njeri i huaj, krejt i huaj për të, por, tepër i afërt me burrin e saj, një natë të bukur vere hynte fshehurazi nga dera e kopshtit, kalonte përmes xixëllonjave dhe i shoqëruar nga shërbëtori plak, futej

në shtëpi pa dijen e të shoqit, por me urdhrin e saj! Dhe pikërisht atij njeriu duhej t'ia tregonte një sekret që nuk ia kishte treguar askujt, bile ndonjëherë ishte përpjekur t'ia fshihte edhe vetvetes... duhej t'i tregonte lidhjet e fshehta të saj me një të huaj... lidhje që sa kishin filluar por... tani nuk ishte koha të merrej me ëndrra të kota, duhej t'i shpëtonte ata nga më e keqja pastaj... pastaj! E çfarë pastaj? Unë nuk kam ndonjë lidhje me të! Ishte vetëm një simpati çasti e asgjë më tepër! Megjithatë, tani duhej t'i shpëtonte nga tmerri që ua kishte përgatitur burri i saj me shokët e tij të pistë!

Trokitja në derë e tmerroi edhe më tepër. Çdo t'i thoshte shërbëtorit për këtë ftesë? Çdo t'i thoshte Keq Sykut kur të hynte në dhomën e saj?

– Urdhëro! – tha me një zë të dridhur sikur nuk ishte zëri i saj.

Derën u hap ngadalë, nga një dorë e ndrojtur. Kur e pa shërbëtorin të vetmuar në derë, sa nuk klithi nga zhgënjimi.

– Ai të pret në fundin e shkallëve zonjë! – foli shërbëtori me zërin gjysmë të mekur nga lodhja.

– Të faleminderit. Je i mrekullueshëm! – tha Mila e lehtësuar. Nga komodina mori një bankënotë dhe ia zgjati shërbëtorit. – Tani shko e çlodhu në dhomën tuaj, Natën e mirë!

– Natën e mirë! – tha shërbëtori i gëzuar duke shikuar bankënotën, dhe u nis drejt dhomës së tij.

Mila zbriti shkallët me nxitim. Poshtë e priste Keq Syku. Në dritën e zbehtë të llambës, pa rrobat e tij të zeza. Kishte dëgjuar se ai sa herë që udhëtonte natën vishej me rroba të zeza. Këtë e bënte me qëllim të mos dallohej nga errësira.

– Me keni ftuar zonjë? – pyeti ai, porsa Mila i kishte zbrit shkallët.

– Po!... të thirra për një punë urgjente! Do ta them një fshehtësi, nëse me premton se çdo gjë do të mbetët mes nesh! – tha Mila e ndrojtur, por e vendosur.

– Si urdhëro zonjë. Jam i tëri nën urdhrat tuaja! – foli Keq Syku duke e shikuar në sy.

– Arkeologët ndodhën në kullën e dasmës... janë në rrezik! – tha me ndrojtje Mila.

– Në rrezik? – pyeti Keq Syku i hutuar.

– Kërkoi nga ju që t'i njoftosh...

– Zonjë!... ata janë në besën e...

– Tani duhet lajmëruar... – e ndërpreu Mila.

– Do t'i lajmëroi zonjë... por...

Mila ndjeu peshën e vështrimit të tij në gushën e saj gjysmëlakuriqe. Fjalët e tij nuk i dëgjoi për një çast. Ngriti dorën dhe tërhoqi jakën duke e mbuluar më mirë gjoksin. U përqendrua të dëgjonte se çfarë thoshte, por ai nuk po fliste më. Vështrimit të tij nuk i iku as kësaj radhe. Ai me sytë të ndezur prush, me këmbëngulje kërkonte sytë e saj. Mila disa herë ngriti kokën në përpjekje për t'ia sqaruar rrethanat, por gjithmonë ndeshej në ata sy si thëngjij të ndezur që e bënin të ulte kokën pa mundë t'i thoshte asnjërën nga ato që i mendonte.

– Jeni shumë e bukur zonjë! – foli me zë të dridhur Keq Syku.

O zot, mendoi Mila me vete, edhe kjo me duhej tani. Një drithërimë e lehtë, e përzier me frikë ia përshkoi tërë trupin. Çdo gjë mundë të kishte menduar! Çdo gjë mundë të kishte planifikuar por, që një copë fshatar i leckosur, i tulatur, e plot nënshtrim para burrit të saj, t'i

thoshte fjalë të tilla, kurrë nuk i kishte shkuar mendja.

– Si guxon të flasësh kështu? – pyeti Mila, por dukej se më tepër këtë pyetje ia kishte shtruar vetës së sa atij.

Në çast, një drithërimë tjetër ia përshkoi tërë trupin tani më të drobitur. Në katin sipër, ishte shërbëtori plak. Ajo dyshoi se ai e përgjonte çdo bisedë apo lëvizje të saj! Këtë, ai e kishte bërë edhe herë të tjera! E shqetësuar, vuri gishtin të hunda që tjetri mos të fliste, dhe në heshtje të plotë ia kthej shpinën. Edhe pse nuk e ftoi, Keq Syku e ndoqi pas. Para kthinës ndaloi. Ajo u kthye vrullshëm, duke i dhënë pushtet vetës para tij, por Keq Syku, edhe kësaj radhe ia mori fjalët nga goja!

– Kohë të gjatë të kam ëndërruar zonjë... kam qenë i bindur se do të vijë ky çast një ditë, dhe ja erdhi!

– Si guxon?!...– tha për të dytën herë Mila, por kësaj radhe me zë të ashpër. Në vend të përgjegjës, ndjeu dorën që ia mbështolli belin. Në atë gjysmerrësirë nuk ia vërente dot pamjen e fytyrës se çfarë shprehje kishte, por frymëmarrjen e shpejtuar dhe drithërimën e trupit, e ndjente me trupin e saj. Pastaj, ndjeu fërkimet e ashpra të tirqve, në mes të kofshëve. Në vend që të largohej, të kundërshtonte, apo të klithte e tmerruar, siç e kishte menduar me parë, ajo e la të lirë trupin e saj të mbështillej në përqafimin e tij të zhguntë. Pastaj ngadalë, pa e shkëputur nga duart e tij, ai e tërhoqi drejt kthinës së errët. Ndjeu peshën e duarve të tij që e shtynin drejt shtrirjes. As kësaj radhe nuk e kundërshtoi vullnetin e tij. Pasi ishte shtrirë e bindur mbi minder, ndjeu peshën e trupit të tij kërleshan... Assesi nuk i kujtohej koha sa kishte qëndruar e shkalafitur nën atë peshë, përveç gulçimeve epshore të dala nga goja e saj, dhe përvëlimi në fundoin e barkut! Pastaj, si nëpër

ëndërr i kishte ndjerë lëvizjet e tij gjatë veshjes dhe cijatjen e derës.

Për një copë herë Mila qëndroi pa lëvizur. Ju bë se përvëlimi i prushit, në fundin e barkut të saj, tani ishte shuar. U ngrit ngadalë. Me pelerinën krahëve ngjiti shkallët. I vinte vapë. Hapi kanatat e dritares. Vështrimin e hodhi jashtë. Hëna, sa kishte nxjerrë faqen e plotë tutje nga mali. Në oborr, xixëllonjat lëviznin gëzueshëm. Bashkë me freskun e natës dëgjohej kënga e bulkthit. Mori frymë thellë. Disi e ndjeu vetën të freskët, të lehtë, tamam si ato xixëllonjat me barkun e prushtë, që endeshin në oborrin e saj. Pa dashur, vuri dorën mbi bark. U shtri në shtrat dhe u përpoq të flinte. Nga larg, të venitura, u dëgjuan të shtëna pushkësh!

Pas disa rrotullimeve nëpër rroba, e kuptoi se do të kishte një natë të mundimshme e pa gjumë. Ishte hera e parë që e tradhtonte të shoqin. Por, e ndjente se kjo pagjumësi nuk i vinte si vrasje e ndërgjegjes, por ishte diçka krejt tjetër. Ishte zhgënjimi që e kishte parafytyruar me muaj të tërë duke ëndërruar aventura dashurie me një ekspert francez, dhe kur nuk e kishte pritur fare, kishte rënë në duar të ashpra... e të kujt? Të një copë malësori marroq!

Ju bë së dëgjoi zëra në korridor. Hapi sytë e tronditur. Ishte zëri i majorit që fliste me dikë. Zëri i erdhi i njohur! O zot, u ulë në shtrat e tmerruar! Ai! Çfarë paska ndodhur? E paska zënë! Çfarë ti thoshte tani Dushit? Sigurisht se ai ia ka treguar të gjitha! Jo, jo. Kurrë nuk do të pranonte se e kishte ftuar vet. Do të thoshte se ai kishte ardhur për punët e majorit... ma mbylli gojën... me zor... me dhunoi dhe iku! Ju bë sikur ishte duke u arsyetuar para tij!

Nga shtrati u hodh me vrull. Zërat vinin të ulët dhe nuk ishte e mundur të dëgjohej se çfarë flitej. Nganjëherë merrnin formën e një rënkimi, pastaj dëgjoheshin si urdhra... dhe për disa çaste, çdo gjë e kaplonte një qetësi e tmerrshme si vdekja. Në korridor u dëgjuan hapa të lehtë. Zërat vinin më të qartë, disi si fjalë të prera, kërcënuese, qortuese! Gjithmonë ishte zëri i majorit! Tani nuk ishte aspak çudi të dëgjoheshin të goditura druri apo prerje thikash... të dëgjoheshin të shtëna armësh... pastaj të vinin britma të çjerra, rënkime të tmerrshme nga dhembjet, kuisje të përziera me dënesa mëshire! Mila rrinte si e shtangur pranë derës. Tani e kuptonte fajin që e kishte bërë, dhe ashtu, e pështjellur me po atë pelerinë të ndyrë nga fërkimet e zhgunta, që e kishte pasur të veshur sa kishte zgjatur faji, sikur e priste dënimin e hakërryer të majorit.

Nga jashtë, zëri erdhi më i theksuar, disi i shkoqur. Mila mbështeti veshin pranë derës.

– ...sot të veprosh! Nëse nuk e vret sot... do ta paguash me kokë! Qartë? – arriti të dëgjonte zërin urdhërues të majorit.

– Si urdhëro gospodine... – dëgjoi zërin e tulatur të Keq Sykut.

– Shko tani! – dëgjoi urdhrin e majorit. Pastaj ndjeu hapat e tij që po i zbriste shkallët.

Nuk qenka për mua, ofshani e lehtësuar! Tani nuk i bëri asnjë përshtypje urdhri për vrasjen e dikujt. Disi e ndjente vetën larg atyre ngjarjeve, sikur ishte diku në një botë tjetër. E lehtë si pendël, u shtri në shtrat. Lëvizi edhe një herë duke zënë vend më mirë dhe u bë sikur flinte. Ndjeu derën e zyrës së majorit që u mbyll. Për disa çaste mbajti vesh, por pasi nuk i dëgjoi më

hapa në korridor, e kuptoi se ai ende kishte punë, dhe do të qëndronte në zyrën e tij. Edhe më mirë, mendoi me vete duke e mbuluar edhe kokën me batanije. Nga jashtë erdhi zëri i gjelit. Po gdhinë, mendoi derisa ishte duke u përpjekur të flinte!

*

Van Joviqi i hidhte hapat me kujdes në rrugën e përgjumur e plot guralecë. Nata kishte kohë që kishte rënë. Tutje nga lindja sa kishte nxjerrë faqen e ndritshme hëna e plotë. Yjtë në qiell regëtinin. Instinktivisht ngriti kokën dhe shikoi nga qielli. U përmirësua moti, mendoi. Mendja i shkoi të relikt dhe eksponatet antike, të radhitur bukur nëpër rafte. Një thesar i rrallë! Nesër do të hapet ekspozita, mendoi me bezdi! Ekspozitë seleksionimi! Ide e marrë e patrikut. Çmenduri, tha me vete.

Për një çast vetja ju duk i lirë, sikur kishte dalë nga një kullë e ngujimit. Me gjithë këmbënguljen e të zotit të kullës, nuk kishte pranuar të priste deri sa t'i çonte fjalë Miliqi. Pastaj për mbrojtjen e tyre, i zoti i dasmës, ua kishte dhënë tre burra për t'i përcjellë deri të kufiri i fshatit. Çka është e vërteta, Van Joviqi nuk e dinte se ku ndahej kufiri, por kishin rreth pesëmbëdhjetë minuta që po udhëtonin të shoqëruar prej tyre. Herë pas here, në kokë i vlonin mijëra mendime të tmerrshme. Tani sa e kishin lënë kodrën prapa krahëve dhe po futeshin në bokërimat, ku fill pas tyre ishte mali i dendur, me Varret e Krushqve në mes. Një drithërimë e lehtë ia përshkoi tërë trupin. Po sikur këtu të jetë kufiri dhe malësorët të kthehen prapa? Si do ta bënin udhën të

vetmuar deri në qytezë? Për një çast sikur u pendua për rrugën që e kishte marrë.

– Epos i mrekullueshëm, apo jo? – pyeti Fransua pa ju drejtuar askujt.

– Vërtetë ishte i mrekullueshëm! – foli me zë të ulët Van Joviqi, pa e pas mendjen aty.

Rrugën e vazhduan në heshtje. Asgjë nuk dëgjohej veç hapave të tyre dhe këngës së bulkthit. Rreth tyre pështilleshin fluturimthi xixëllonjat. Rruga sa kishte hyrë nëpër një bokërimë. Pastaj zgjatej drejt malit të lartë, që dukej si hije e një kodre misterioze. Van Joviqi u drodh i tëri. Sa më shumë që i afroheshin malit, aq më tepër ndjente frikë. Mendja i shkonte të kaçakët, të cilët tani sa kishin dalë nga ndonjë shpellë e errët, dhe në dritën e rrezeve të arta të hënës kishin mësy fushave për t'u futur vjedhurazi nëpër katunde, për të zënë ndonjë pritë karvanëve të vonuara apo, për t'i sulmuar patrullat e xhandarmërisë. A nuk i përngjante një karvani të tillë, udhëtimi ynë? Pyeti vetën gjithë frikë! A nuk ngjajmë edhe ne sikur të ishim tregtarë të vonuar? Kurse malësorët, a nuk ngjajnë sikur shoqërues të karvanëve? Pastaj përpiqej t'ia largonte vetës këto mendime ogurzeza. Jo, jo! Askujt nuk do t'i shkonte në mendje se njëfarë Van Joviqi i shoqëruar nga dy shtetas të huaj dhe tre malësorë shqiptar, po kthehej nga një dasmë shqiptare përmes një rruge gjysmë malore e gjysmë fushore për të arrirë në qytezë! Edhe nëse do të na sulmonte dikush, menjëherë do të merrej vesh se cilët ishim dhe do të na linin të qetë në rrugën tonë. Të paktën, kështu i kishte thënë i zoti i dasmës! Ai i kishte thënë se kaçakët nuk e kishin inatin me ta, përkundrazi, sikur të dinin se ata do të udhëtonin në një kohë kaq të

vonë, do t'i merrnin nën mbrojtjen e vet.

Kishte kohë që ishin futur në mes të malit. Nga errësira që krijohej nga hijet e rënda të lisave, mëzi dallohej rruga. Tutje para tyre ndodhej një bokërimë, të paktën ashtu i dukej nga errësira. Kur u afrua edhe më afër, pa se ishin duke kaluar pranë Varreve të Krushqve. Në çast ju bë së dëgjoi një lëvizje tutje nga lëndina e varreve. Drita e zbehtë e hënës, krijonte nuanca të pa qarta duke u shfaqur si figura njerëzish mbështetur për rrasat e varreve. Pastaj ju bë se një rrasë e tillë lëvizi pak nga vendi. Pastaj lëvizi edhe një tjetër. Këto lëvizje nuk ju kishin shpëtuar as bashkudhëtarëve. Sikur t'i kishte urdhëruar dikush, të gjithë ndaluan një herësh. Lëvizja e rrasave vazhdoi edhe për disa çaste. Ende pa u tmerruar nga lugetërit, lëvizjet e ngadalta të rrasave sikur u gjallëruan duke u shndërruar në një sulm të beftë e me britma. Van Joviqi, dalloi rrobat e tyre malësore që u kacafytë me malësorët përcjellës. Gjatë përleshjeve dëgjoi të shara në të dy gjuhët. Mu në kohën kur ishte duke u tërhequr për t'u fshehë prapa një lisi, pa malësorët përcjellës që e rrëmbyen një malësorë tjetër dhe duke e tërheq zvarrë u tretën prapa lisave. Ndërkohë, vërejti një malësor me një hu në dorë duke ardhur drejt tij për ta goditur. Instinktivisht u ulë dhe mori një gurë. Me gjithë fuqinë që e pati, gjuajti drejt tij. Guri e goditi sulmuesin në lule të ballit. Ai duke u rrëzuar bërtiti dhembshëm „O majko moja... kuku lele!" Pastaj shkëputi një të sharë, që nuk e dëgjoi të tërën por vetëm fjalët e fundit! „... shiftarsku majku!" Akoma pa arrirë të çuditej se si një malësorë shqiptarë rënkonte dhe shante në gjuhën serbe, prapa krahëve ndjeu një dhembje të tmerrshme

sa e bënë të klithte trishtueshëm. Pastaj, ndjeu goditjen e dytë në kokë, diku mbi vetullën e majtë, sa që drita e hënës u shua menjëherë nga dritat që i dolën nga sytë. E ndjeu se nuk qëndronte dot në këmbë. Pa mundur të kontrollonte vendin se ku mundë të rrëzohej, ndjeu se u përplas mu në mesin e atyre bokërimave. Të rënat e tjera nuk i numëronte dot. Në agoni të thellë që nuk e përcaktonte në ishte i gjallë apo kishte vdekur, ndjeu të shtëna pushkësh. Fill pas tyre dëgjoi zërin e hakërryer të Miliqit. Sulmuesit u zhdukën sakaq. U përpoq të ngrihej, por qe e pamundur. Disi, edhe qepallat ju kishin rënduar. Mbylli sytë dhe sikur të ishte duke dremitur, ju bë se e zuri gjumi!

Kishte kohë që rrotull tij dëgjonte zëra. Biseda zhvillohej rreth tij, dhe shokëve të tij. Flisnin me urrejtje të papërmbajtur kundër malësorëve shqiptarë. Si në agoni dëgjoi zërin e Miliqit të thoshte se gjithë thesaret antike dhe arkeologjike ishin zhdukur. Pastaj dëgjoi mjekun të thoshte se plagët nuk ishin të rrezikshme, por ishte mirë që të plagosurit, pas ndihmës së parë, të dërgoheshin në spital.

Si në ëndërr dëgjoi zërin e patrikut. Me mundim hapi sytë. Pa fytyrën e tij plot lesh, në atë dritë të fortë qielli. Disi ju duk e deformuar, por nuk e caktonte dot ishte e deformuar fytyra e patrikut, apo e deformonin sytë e tij me atë pamje të mjegullt.

– Si e ndjen vetën tani? – pyeti patriku me zë të ëmbël.

– Pak me mirë! – u përgjigj Van Joviqi me zë të mekur.

– Kanë arritur gazetarët, mundë të flasësh me ta? Ja ku janë! – foli patriku.

– Si ndodhi? – pyeti një burrë, po ashtu me fytyrë të deformuar.

Van Joviqi vetëm e vështroi me dyshim.

– Jam gazetar i gazetës Novosti, a mundë të më thuash si ndodhi? – pyeti një burrë tjetër, nga a majta.

Van Joviqi e shikoi hetueshëm fytyrën e tij. Pas një heshtje të shkurtër, me zë të mekur tha:

– E tëra duket të jetë e kurdisur!...

– Nga shqiptaret? – pyeti gazetari.

– Jo, nuk besoi të ketë kurdisje nga shqiptarët!

– Nga kush pra? – pyeti gazetari i hutuar.

– Nga ata që historia e njerëzimit, fillon në mesjetën e hershme!

– Po zhdukja e eksponateve antike? – pyeti prapë i njëjti zë.

– Pikërisht, zhdukja e eksponateve antike i përligj sulmet kundër nesh!...

Në çast ndjeu marramendje. Objektet filluan të lëviznin në mënyrë rrethore, duke e marrë edhe atë me vetë në atë vorbull. I mbylli sytë me shpresë se do të pushonin edhe ato lëvizje që i sillnin për të vjell, por edhe ashtu, vorbulla vazhdoi. Prapa krahëve të tij ndjeu zërin e majorit duke pyetur për gjendjen e tij. Pastaj dëgjoi të thoshte se edhe dy të huajt kishin marrë plagë të lehta.

Si në ëndërr të tmerrshme, ndjeu trupin e tij që u shkëput nga toka dhe filloi të ngjitej drejt lartësive kaltroshe të qiellit. Nuk e përcaktonte dot, në ishte gjallë, apo kishte vdekur dhe tani shpirti i tij, mbi flatrat e engjëjve, ngjitej lartë drejt amshimit. Me mundim hapi sytë. Në çastet e para nuk dalloi asgjë përveç qiellit të kaltërt dhe trupit të tij që rrinte pezull mbi

ajër. Me mundim lëvizi kokën nga e majta. Pa se ishin duke e mbartur trupin e tij mbi vig. Tutje pa veturën e bardhë të majorit. Pak më tej pa një togë malësorësh të armatosur të rrethuar nga xhandarët. Në mesin e tyre dalloi Miliqin, i veshur me këmishë të bardhë. Ju bë se flladi i lehtë ia mënjanoi kravatën që i fërgëllonte me triumf. Në atë gjysmë agoni, arriti të befasohej kur e pa para tyre të vendosur fotoaparatin. Në çastet e fundit, dalloi se në mesin e malësorëve kishte të vrarë, të hedhur pranë këmbëve të Miliqit. Ishin shoqëruesit e tyre. Kurse sulmuesit, nuk i pa gjëkundi. Për një çast ndjeu dhembje për ta. Janë fajtorët, shkaktarët e kësaj gjëme... të gjithë të vriten... të masakrohen me thika... në litarë, në litarë... dëgjoi rreth tij zëra të hakërryer!

*

Karroca hyri në Bajë. Gjersa ngjitej kodrës përpjetë, Van Joviqi pa grumbujt e dheut dhe gropat e hapura që kishin mbetur nga shkatërrimet e bazilikës së vjetër dhe banjës romake. Gropat kishin mbetur të hapura si kenotoafët dardan. Ju bë se ato gropa, tani prisnin varrosjen e tij bashkë me thesaret e humbura. Tutje, përtej kaçubave pa gurë të thyer, të hedhur pa kujdes, pasi nuk ju kishin hyrë në punë. Ju bë sikur ata gurë shpërndanin hije të errëta harrese mbi atë peizazh gri. Braktisja, dukej në çdo gropë. Edhe vetja ju duk se ishte një gropë e hapur dhe e xhveshur nga thesaret e bukura, që mi mijëra vjet i kishte ruajtur në gji, dhe në fund e braktisur.

Po atë ditë, pas kontrollit mjekësorë, korrieri Dan Mujani ia kishte sjellë vendimin e naçallnikut, për

lirimin e objekteve komunale që i kishte pasur në dispozicion gjatë hulumtimeve të tij arkeologjike. Kishte bërë përpjekje për një takim me të, por kishte qenë e pamundur. Ishte përpjekur të takohej me patrikun për t'i kërkuar ndihmë, por as ai nuk e kishte pritur. Një prift i ri, i kishte thënë se ai nuk ka kompetenca për të marrë ndonjë vendim. Nuk i kishte mbetur gjë tjetër vetëm t'i merrte valixhet e tij, nëse kishte mbetur diçka prej tyre, dhe të ikte nga kishte ardhur. Ndërsa, ekspertët e huaj, nën kujdesen e rreptë të ushtrisë, dhe nën mbikëqyrjen e majorit i kishin dërguar në konsullatat e tyre.

Tani e ndjente se humbja ishte shumë më e dhembshme se sa e kishte menduar në fillim. Kishte qenë aq afër zbërthimit të enigmës dardane, sa që, ky zbërthim do t'i kishte shembur të gjitha teoritë e shumë historianëve mediokër, dhe befas, kur nuk ishte pritur nga askush, kishte ndodhur shamata duke ia rrëmbyer nga duart gjithë atë thesar. Disa herë, për t'i dhënë zemër vetës, kishte menduar se pas një klime të përshtatshme politike do të vinte prapë për të vazhduar kërkimet, edhe pse e dinte se një gjë e tillë nuk do të ndodhte kurrë. Ishin të pamundura kërkimet shkencore mbi shkatërrimet e tmerrshme politike e teologjike që i behën brumit arkeologjik.

Karroca kalonte mes për mes katundit të vogël Lumborë. Van Joviqi pa muret e larta të kishës që po ndërtohej nga gurët e bazilikës parakrishtiane. Rreth saj punonin punëtorët. Për një çast ndjeu neveri. Edhe një çiban po ngulet në tokë të huaj! Testament i gjakderdhjes së ardhshme, mendoi me përbuzje deri sa karroca po ikte me vrap drejt përroit.

Nga zyrtarët komunal nuk e priti askush. Rreth gjysmë ore ndenji i ulur në një stol druri pranë kapisë indiferente të ushtarëve që ruanin para derës, në pritje për t'i marrë valixhet. Ushtarët bisedonin të shkujdesur. Edhe pse nuk shifeshin fytyrat e tyre, zërin ua dëgjonte. Njëri kishte zë të vrazhdë, kurse tjetri kishte një zë të ri, si të ndonjë të riu mitar.

– … ishin pesë të burgosur shqiptar. Katër prej tyre i veshëm me rroba civile serbe, dhe i pushkatuam. Njëri që punonte për ne, është gjetur i vrarë dje gjatë sulmit kundër ekspertëve të huaj! – pas një heshtje të shkurtër vazhdoi i njëjti zë: – more vesh ti, kush i sulmoi ekspertet e huaj, e bënë kaçakët vërtetë siç po flitet, apo janë bërë fshehurazi nga tanët? – u dëgjua të fliste me zë të ulët sikur kishte frikë se e dëgjonte dikush!

– Janë bërë nga tanët! Unë kam qenë i veshur si malësorë shqiptar. Njëri nga të huajt me ka goditur me gurë në kokë!… e sheh? – u dëgjua ai me zë të hollë dhe vazhdoi: – Pasi ndërhyri Miliqi, arritëm t'i vrasim tre, sepse ata e kishin vrarë bashkëpunëtorin tonë! Naip e quanin! E kam njohur mirë. E vranë malësorët shqiptarë që për habinë tonë kishin qenë në përcjellje të ekspertëve. Për të krijuar huti, arrestuam edhe gjashtë fshatarë të tjerë të pafajshëm! Pasi bëmë fotografi në mesin e tyre, me urdhrin e Miliqit i pushkatuam të gjithë. Për këtë kam marrë mirënjohje nga majori. Edhe dy ditë, unë po udhëtoi!... sitno! – u dëgjua të thërriste me gëzim.

Van Joviqi u irritua nga bisedat e tyre. Kurrë nuk i kishte shkuar mendja se dhuna e terrori mund të ushtroheshin në mënyrat kaq barbare, me vrasje e kurthe, dhunime e tortura, çnderime e plaçkitje, të

bëra pikërisht prej atyre që flasin për liri dhe të drejta!

Ndërkohë në derë u shfaq Dan Mujani. Pas një vështrimi të vrazhdë, hyri në një kthinë, dhe që andej doli me çelësa në dorë. Van Joviqi e ndoqi pas. Pasi e hapi derën, u gjend në ish dhomën e tij. Sa nuk klithi nga mënxyra. Çdo gjë ishte e hallakatur. Rrobat e shtratit ishin të hedhura në dysheme. Arka e drunjtë që në të i kishte mbajtur të mbyllura thesaret me vlera të larta artistike dhe shkencore, ishte shkatërruar e tëra. Thesaret ishin zhdukur. Skicat dhe hartat planimetrike, ishin të shqyera dhe të shpërndara nëpër dhomë. Blloku i tij i shënimeve ishte coptuar. Disa faqe ishin shpërnda në dysheme, kurse pjesa më e madhe, dhe pikërisht ajo më e vlefshmja ishte zhdukur fare. Rrobat e tij ishin hedhë anë e kënd dhomës. Paratë që i kishte pasur në xhepin e xhaketës nuk ishin më. Filloi t'i mblidhte rrobat dhe t'i fuste në valixhe. Në fillim, ashtu i nevrikosur siç ishte, i hidhte rrobat dhe çfarë gjente tjetër në valixhe pa kujdes. Pastaj, sikur ju kujtua diçka, i la të gjitha mënjanë dhe u ngrit në këmbë. Për disa çaste qëndroi i pa lëvizur, duke shikuar në një pikë të pacaktuar. Pastaj, si i mpirë u nis drejt derës. Pa fol asnjë fjalë zbriti shkallët dhe u nis drejt karrocës. Dan Mujani, pasi e kishte mbyllë disi valixhen, e hodhi në karrocë duke thënë me mburrje: hop he polic! Van Joviqi e shikoi i befasuar, pastaj i dha shenjë karrocierit që të nisej në drejtim të qytetit, për ta arrirë trenin e orës pesë.

VII

Kekë Ymeri u zgjua i llahtarisur nga gjumi. I mbuluar në djersë, u ulë në shtrat. Ofshani i çliruar, nga ajo ëndërr e mallkuar që nuk ju kishte shqitur gjatë gjithë natës, duke e tmerruar me ato mjekra të zeza e sy të zgurdulluar priftërinjsh, që kërkonin zhbërje, shkatërrim!...

Copat e ëndrrës, si thyerje xhami, i vërtiteshin nëpër tru. Nga jashtë erdhi zëri i një gjeli, dhe fill pas tij, si përgjigje, u dëgjua e lehura e ngadaltë e një qeni plak. Qenka gdhirë, mendoi dhe u shtriq. Pastaj u ngrit në këmbë dhe hapi kanatat e dritares. Tutje nga lindja qielli kishte marrë një ngjyrë të kuqërremtë. Rrezet e para të diellit posa kishin rënë mbi majat më të larta të Shkëmbit të Kuq. Për disa çaste e ndjeu vetën të hutuar. Ju bë se gjatë gjithë natës kishte qenë rob i zënë nga kallukanxhat, dhe tani i molisur e ndjente se e kishte

humbur krejt orientimin. Pasi u vesh doli nga dhoma. U afrua pranë gurrës, që gurgullonte qetë në fundin e oborrit, dhe fillojë të lante fytyrën.

Uji i ftohët, veç fytyrës, ju bë se ia kthjelloi edhe trurin nga ai gjumë dinak! Tani ju kujtua se gjatë natës, sikur kishte dëgjuar të shtëna të largëta pushkësh. U vu t'i kujtonte më shkoqur, kishin qenë vërtetë të shtëna, apo ju kishin ngatërruar në ëndërr bashkë me xhybet e zeza të priftërinjve hutaq! Pasi nuk ju kujtua se cila ishte e vërteta, u nis drejt hyrjes. Që kur kishte filluar të punonte në kërkim të lashtësisë, i bëhej se edhe vet ishte bërë pjesë e saj, që nuk mbahej mend nga askush se kurë, dhe si kishte vdekur… por që nga ajo kohë vërtitej si hije për ta gjetur varrin e vet të vithisur... dhe pastaj të futet aty, pranë armëve të tij të vjetra…

Nëna e priste të pragu i derës me këmishën e larë në dorë. Kekë Ymeri e shikoi me dhembshuri. Pastaj, duke e veshë këmishën, hyri në shtëpinë e zjarrit. Bashkë me kërkëllimën e derës që po mbyllej, ndjeu aromën e këndshme të bukës së valë, të porsa nxjerrë nga çerepi. Nëna, që më parë e kishte shtruar sofrën, e priste në këmbë.

– Mirëmëngjes! – e përshëndeti gjyshja duke u ngritë në këmbë! – A fjete mirë?

– Mirë, po ju? – foli më zë të ulët, sa që gjyshja nuk e dëgjoi fare se çfarë tha!

Kekë Ymeri hëngri bukë ngadalë! Pastaj, bashkë me stolin e drunjtë, shkoi afër vatrës, duke shikuar vorbën që ziente. E ëma largoi vorbën nga zjarri, dhe ia mbushi një kupë me qumësht të valë. Pasi ia dha, për një copë herë e shikoi me dhembshuri nga distanca.

– Si nuk u gjet ndonjë tjetër të futej në atë shpellë të

nemun! – tha ankueshëm e ëma, sikur ishte duke fol me vetën e saj!

*

Për të dytën herë ngriti kokën lartë. Shikimin e përgjumur e përqendroi nga masivet e maleve të larta. Pa nga shkëmbinjtë e thepisur gëlqeror, që fillonin në grykën e Lugut të Madh, duke vazhduar tutje me majat e thepisura të maleve, lugina dhe përroje me ujë të kulluar, duke trupuar nga Lama e Dakaj për t'ju bashkangjitur rrafshnaltës së blertë të Lugut të Butë. Ashtu, i kredhur në mendime, vështrimin e përqendroj në mesin e Shkëmbit të Kuq, tamam aty ku bënte hije zgavra e errët dhe misterioze. Ju bë së e panjohura e shpellës e gëlltiti drejtë brendisë së saj me galeri të shumta, me puse shkallëzore dhe të rrezikshme, me liqene e sifone nëntokësore të mbushura me ujë të dëlir, për ta nxjerrë pastaj në burimet mitologjike që i ruanin me xhelozi Zanat e Malit!

– A je gati? – ia ndërpreu mendimet zëri kumbues i Shaipit.

– Po, gati jemi! – u përgjigj si nëpër dhëmbë Kekë Ymeri.

I pari u nis Shaipi, dhe fill pas tij, u nis Kekë Ymeri. Në rrugicën e parë morën nga e djathta. Diku, në njërin nga oborret e fqinjëve kakariste një pulë. Tutje nga selishta erdhën disa blegërima delesh, të cilat, pas pak u panë të bërryli i rrugës. Pasi kaluan lumin, pikërisht aty ku më parë kishte qenë Gurra e Sofijes, u takuan me Keq Sykun. Si me zor i përshëndeti! Fytyrën e kishte të përgjumur e të bardhë si pëlhurë. Ballukët, të dalë jashtë

plisit, i rrinin hijshëm. Ndërsa marama e zezë e lidhur rreth plisit të bardhë kërkonte shpagim. Thuhej se që nga ajo ditë që kishte qenë i rreshtuar para skuadrës së pushkatimit, veç qëndrimit burrërorë, e kishte ndjerë vetën shumë të fyer. Ai kishte ç'u fjalë se herët a vonë, kanë me ma pa sherrin ata që ma kanë korit, por nuk dihej cilët ishin koritësit e tij!

– Ashtu siç jemi marrë vesh, ë?!... – foli Keq Syku duke e shikuar nga Kekë Ymeri, me atë vështrimin e tij dinak.

– Po, po!... – tha Shaipi me zë të ulët dhe vazhdoi udhën duke e lënë prapa Keq Sykun.

Pas një pushimi të kroi i Lisvidhit, ata morën të përpjetën duke i dalë nga prapa Shkëmbit të Kuq. Rrugica zik-zake malore sikur nuk kishte të sosur. Lisat e mëdhenj bënin hije. Thellë në mal dëgjoheshin cicërimat e hareshme të zogjve. Kekë Ymeri, me duqit e tij në krah, i mbytur në djersë, kishte ngelur shumë prapa. Shaipi, shumë larg tij, ishte ulur buzë rrugicës dhe e priste. Befas, ju bë së dëgjojë një shushurimë në mal. Ju bë sikur ishin hapa të dikujt që po nxitonte. Kthej kokën andej. Si në vegime, në mes shkurreve e lisave, ju bë së pa një siluetë njeriu, të thyer si copat e pasqyrës, që u zhduk sakaq në thellësi të malit. Mendja i shkoj të Keq Syku, dhe ato fjalët e marrëveshjes që i kishte ndërruar pak më parë me Shaipin. Po kush i merr vesh punët e tyre se, tha me vete, dhe u nis.

Nga rrafshnalta mbi Shkëmbin e Kuq, fusha tutje dukej si një tepsi e blertë. Nga lartë shiheshin njerëzit si milingona në rrugët zik-zake.

Lëshimi i litarëve u bë sipas planit që ditë të tëra e kishin përgatitur së bashku. I pari zbriti Shaipi. Gjatë

zbritjes, në të çarat e shkëmbit i vendoste pykat dru bredhi, pastaj me forcë i ngulte gozhdët dredhore, në të cilat pastaj i lidhte litarët.

Kishte kohë që Shaipi ishte zhdukur në brendi të Shkëmbit të Kuq. Dëgjoheshin vetëm të goditurat e çekanit. Pastaj u dëgjua edhe thirrja e tij. Zëri vinte i zgavruar e me jehonë. Ishte vështirë të shkoqitej se çfarë thoshte. Mirëpo, Kekë Ymeri e njihte atë gjuhë, ndaj u lidh me litar dhe filloi zbritjen. Duke u mbajtur pas pykave, këmbët i vente në gozhdët dredhore që pak më parë i kishte ngulitur Shaipi, i cili pasi e kishte siguruar vendin në hyrje të shpellës e priste. Pas lëshimit pezull para hyrjes së shpellës, Shaipi e tërhoqi fillin e litarit që e mbante në dorë, dhe Kekë Ymeri u gjend në brendi të hyrjes së shpellës.

*

Hyrja e shpellës ishte e vogël. Salloni ishte i gjerë, dhe fill pas tij, korridori që zgjatej derisa humbiste në errësirë. Sikur të vinte nga thellësitë e errtë të nëntokës, dëgjohej një si gurgullimë e mbytur uji, e shoqëruar me erë të freskët që vinte tutje nga galeritë. Në qendër dalloheshin mbeturinat e zjarrit. Muret përreth ishin të tymosura. Në dysheme, pas një gërmimi në mes glasash, u gjetën copa vorbash, qypash, amforash e olpash, të cilat dukej së i takonin kohërave të ndryshme. Në murin nga e djathta ishin të mbështetura disa pjesë druri si lloj vegje primitive. Në të majtë, fare pranë murit, sa mezi shquhej në atë gjysmë errësirë, kishte eshtra dhe skelete njerëzish. Pak më tutje, ku zëntë fill korridori, pa shpata të hedhura, hanxharë, dhe shigjeta. Në tavan

shifshin foletë e dallëndysheve të punuara nga balta. Befas, tutje nga errësira, furishëm fluturojë një shpend i madh, dhe me një zhurmë mbytëse, vetëtimthi doli jashtë. Nuk u dallua se çfarë qe! Për një copë herë u dëgjuan të rrahura flatrash nëpër shpellë. U panë të dilnin jashtë tufa zogjsh, të cilët me cicërimat e tyre të frikshme e mbushën shpellën.

Rrezet e diellit depërtonin lirshëm në pjesën e majtë të hyrjes së shpellës. Kekë Ymeri iu afrua murit përballë. Në një lartësi disa pëllëmbëshe, mbi një piedestal guri, qëndronte e vendosur një shtatore gruaje prej guri stalagmiti rreth gjysmë metri, në atë mënyrë që në periudha të solsticit të diellit, mbi të duhej të binin tufa rrezesh. U gjetën edhe copa poçesh, qypash, amforash, sikur i kushtoheshin Afërditës. Dukej se aty, dikur moti, ishin kryer rituale, ndoshta edhe orgji. Tutje në thellësi, ishte një gurë i madh i vendosur si lloj altari. Në pjesët anësore kishte eshtra shtazësh.

– E mahnitshme! – foli Shaipi si më vete.

Kekë Ymeri e ktheu kokën andej. Shaipi e mbante në dorë një shpatë. Forma e saj ishte e drejtë. Dorëza ishte e qëndisur me filigran, në trajtë dantelle, dhe fund tre thepash.

– Vërtetë e mahnitshme! – foli Kekë Ymeri pasi e kishte marrë shpatën në dorë.

– T'i deponojmë të gjitha gjetjet në një vend dhe në fund, pasi t'I lidhim me litar t'i lëshojmë ngadalë poshtë!

– Jo, jo! Të gjitha duhet të mbesin këtu! – foli Kekë Ymeri prerë.

– Si?! Nuk do t'i marrim?! – pyeti i habitur Shaipi.

– Jo! – u përgjigj shkurt Kekë Ymeri.

– Përse u futëm këtu pra? – pyeti Shaipi, duke e shikuar Kekë Ymerin në sy.

– Për të kërkuar kanalin sekret!... ndez urët se u bëmë vonë! – tha me ton urdhërues Kekë Ymeri.

Me urët në dorë u nisën. Korridori mori të tatëpjetën. Në një vend korridori ngushtohej, për të dalë pastaj në një sallon edhe më të gjerë se sa ai i hyrjes. Ushtima e ujit sa vinte e shtohej bashkë me erën e freskët. Në tavanin e lartë u panë lakuriqët e natës. E tatëpjeta ishte edhe më e shkallëzuar. Shaipi, që ishte duke prirë u ndal. Mori një gurë nga dyshemeja e shpellës dhe e hodhi poshtë. Të përplasurat e gurit nëpër faqet e gurta të shpellës vazhduan gjatë, derisa u zhdukën. Urët kishin filluar të flakëronin në të venitur. Kekë Ymeri, duke u përpjekur të shihte më mirë i rrëshqiti këmba. Për disa metra rrëshqiti poshtë dhe në fund u kap në një thep të mprehët guri. Flakadani i ra nga dora dhe u rrokullis tatëpjetë shpellës. Për një kohë, u panë xixat që dilnin sa herë përplasej nëpër faqet shkëmbore, dhe pastaj u zhduk fare. Shaipi e tërhoqi nga dora. U larguan në një kënd të sigurt. Kekë Ymeri tani e hetojë se ishte plagosur. Nga gjuri i majtë i rridhte gjak. Ndjente dhembje edhe në llërën e dorës së djathtë.

– Si e ndjen vetën? – pyeti Shaipi.

– Kam pak dhembje… – dhe pas pak vazhdojë: – duhet të kthehemi prapa. Është me rrezik çdo përpjekje tjetër!

– Të ngutemi pra! Edhe kjo e shkretë do të fikët!... nisu! – foli Shaipi duke e tërheqë Kekë Ymerin nga krahët.

Ngjitja ishte edhe më e zorshme. Flakadani sa nuk ishte fikur fare. Dyshemeja plot me gurë dhe glasa,

ishte e rrëshqitshme. Tani çuditeshin se si nuk i kishin vënë re këto rreziqe gjatë zbritjes. Nuk i kishin vënë re as kthinat, me skajet e errtë si galeri të ndara nga kryeshpella. Frika nga gremina e errët dhe gojëhapur, që kishte mbetur prapa krahëve të tyre, ishte pushtetshme. Asnjëri nuk e kishte besuar se pas grykës së asaj shpelle paqësore mund të fshihej një labirint i errët, dhe i rrezikshëm. Tani nuk mendonte asnjëri për bukuritë dhe vlerën e antikave të gjetura. Parësore ishte që të arrinin aty nga ishin nisur sa pa u fikë edhe ajo pak dritë e venitur, që çuditërisht, ende i qëndronte erës dhe labirintit misterioz.

Ende pa arritur të ngushtica, drita e flakadanit u fik. Errësira e kaploi çdo skaj të shpellës. Kekë Ymerit kishin filluar t'i ftoheshin plagët. Duke u mbajtur nga njëri-tjetri, filluan të ngjiteshin gjunjazi. Ju bë se e kaluan ngushticën, duke dalë në sallonin e dytë. Në muret e shpellës sikur u duk një vrushkull drite, por ishte tepër larg. Pas përpjekjeve të pareshtura arritën në korridor, pas të cilit u paraqit salloni.

Tani kishin kohë të merreshin me plagët. Shaipi i përgatiti rubat dhe fillojë t'ia lidhë. Plaga në gju nuk ishte aq e madhe sa ishte dhembja e saj. E çara në llërë ishte më e madhe, dhe akoma kullonte gjak.

– Është mirë që ti menjëherë të ngjitësh lartë! – foli Shaipi, pasi ia kishte lidhur plagët.

– Po, po! Ashtu të behët! – u përgjigj Kekë Ymeri.

– Ashtu pra, nisu tani! – foli Shaipi duke i rënë lehtë mbi shpatull, dhe sytë i shndritën nga gëzimi. Tani kishte mundësinë që të gjitha gjetjet t'i lëshonte poshtë, pa e parë askush, ku i priste Keqë Syku.

*

Ishte mesditë. Kekë Ymeri, derisa e priste Shaipin të dilte nga shpella, rrinte ulur në një lëndinë të vogël mbi majën e Shkëmbit të Kuq. I heshtur, as vet nuk e dinte se për të satën herë, e kishte hedhë vështrimin mbi fushën e blertë me nuanca të trëndafilta, që fillonte diku larg tutje tehu, dhe vinte si flutur për t'u ndalur në oborrin e Deli Turileshit. Por ajo, trëndafil-flutur, (se si i erdhi ky emërtim i beftë për Dinorën) nuk shfaqej se nuk shfaqej. Më në fund vendosi të hiqte dorë nga ajo pritje sa e marrë aq edhe torturuese. Nga xhepi nxori bllokun e shënimeve. Pasi e shfletojë duke i rilexuar ato që kishte arritur t'i shkruante sa ishte brenda shpellës, fillojë t'i plotësonte me fraza të reja që i dukeshin të arsyeshme për momentin:

Shpella dukët të ketë qenë e banuar që nga koha e paleolitit dhe e mezolitit. Në kohërat e mëvonshme shpella është banuar në etapa të ndryshme kohore, duke ju përshtatur krizave, epidemive!... ndoshta edhe është përdorë nga njerëz të zgjedhur për festa apo orgji!...

Për një çast ndërpreu shkrimin. Mendja i vajti të tuneli sekret që aq shumë ishte kërkuar gjatë gërmimeve pranë mureve të manastirit. Mos vallë ajo humnerë e tmerrshme, kishte lidhje me tunelin sekret? Me një lëvizje të ngathtë, e la bllokun anësh mbi barin e njomë.

Tutje nga mali, erdhi zëri i dredhur i vajzave baresha. Ato këndonin të shkujdesura. Ju bë se ishte duke e dëgjuar Dinorën kur këndonte si dikur, me gisht në fyt!

O-i-a-o -o-u-a-o!
O, ti në kodër moj, unë në kodër-o-i-i-a-o

Me lapsin në buzë ngriti vështrimin. Si zakonisht, ndoshta edhe pa dashjen e tij, vështrimi prapë ju ndal në oborrin e Deli Turileshit! U befasua kur atje pa lëvizje. U ngrit në këmbë dhe tundi dorën furishëm deri sa ndjeu dhembje. E kishte harruar fare plagën. Nga lëbyrja e syve ju bë se edhe ajo kishte lëvizur dorën duke e tundur në ajër! Më pa, mendoi tërë gëzim… por një shushurimë prapa krahëve të tij, ia tërhoqi vërejtjen. Ktheu kokën andej. Pa Keq Sykun të vinte drejtë tij. Akoma pa arritur të çuditej për ardhjen e tij të beftë, sa nuk klithi nga habia dhe frika bashkë, kur pa se ai me lëvizje të shpejtë, nxori koburen nga brezi.

– Më në fund të zura!... – foli vrazhdë Keq Syku, pa i dhënë kohë të çuditej më tej!

– Si?... – i doli një zë sikur nuk ishte i tij.

– Tani jemi vetëm!... vetëm unë e ti! – shfryu Keq Syku plot inat.

O-i-a-o-o-u-a-o!
O, boll e mirë veç pak e vogël – o-i-i-a-o! – erdhi refreni i këngës së bareshave.

– Çfarë kërkon nga unë?...

– Ti, me ata arkollogat tu, i hape varret e shehitve! Me ato libra të mallkuar theve udhën e Allahut dhe u bane bashkë me shki! Vrave, dogje, preve!... Na i grabite tokat, na përzure nga shtëpitë, e në fund m'qite me m'ba batare...

– Unë?!... – por nuk mundi të fliste më tutje! Gjuha ju lidh. Goja ju tha. Bëri të kapërdihej por, në vend të kapërdirjes, gulçojë trishtueshëm! Pa koburen e kthyer drejt tij, shtrëngueshëm në një dorë të fortë e të pabesë. Gryka e saj lëvizi ngadalë për të marrë nishan! Krejt jeta e tij varej nga ajo grykë e ngushtë, që nga çasti në çast, pritej të villte zjarr e vdekje. Ju bë se e tëra ishte një lojë e frikshme, si dikur me shokët e tij të fëmijërisë, kur luanin duke u fshehur shpellave! Lëvizja e ngadaltë e kobures ndaloi. Ai kishte marrë nishan në gjoksin e tij, mu pranë xhepit të këmishës së bardhë që nëna ia kishte dhënë të larë po atë mëngjes.

O-i-a-o-o-u-a-o!
O s'jam e vogël, por jam…

Lëvizjet e duarve në shenjë mbrojtje u përzien me krismën e kobures dhe me fjalën e fundit të refrenit të këngës: „tamam!" për të cilën, nuk qe i sigurt se e dëgjoi nga vajzat që këndonin thellë në pyll, apo e mendoi me vete! Kekë Ymeri, vetvetiu e vuri dorën mbi plagë. Gjatë kohës sa ishte duke qëndruar në këmbë, ju bë se dëgjoi refrenin e vajzave: „o-i-i-a-o", që i erdhi si urdhër për t'u rrëzuar. Tutje, në mes të lëndinës dallojë bllokun e shënimeve. Sikur donte të kërrusej për ta marrë, ndjeu se i tërë trupi shkonte drejt tij, ndërsa pamja e bllokut u zymtua deri sa humbi në errësirë. Rreth e çark çdo gjë u shurdhua. Pastaj si e venitur në mes të asaj heshtje, dëgjoi shushurimë. Ndjeu se dikush e preku trupin e tij të rënduar tej mase. Deshi të lëvizte, por ishte e pamundur. Një palë duar të forta e rrotulluan, pastaj disi, e mbanin pezull. Me zor arriti t'i hapte sytë. Nuk e

përcaktoj dot se ku dhe, në çfarë pozite ishte. Pa vetëm kallçi tirqish dhe thembra opingash që po lëviznin dikah. Po me bartin, mendoi. Ju bë se ishte në gjumë, në një hapësirë të mugët diku mbi shkëmbinjtë e mëdhenj të Lugut të Madh. Ishte buzë greminës, duke ecur në tehun e saj… dhe nuk shpëtoi dot! Gremina e tërhoqi. Gjatë rënies, ndjeu freski. E dinte se ishte në ëndërr. Nuk ishte hera e parë që shikonte ëndrra të tmerrshme, duke rënë nga shkëmbinjtë dhe, tamam në kohën kur përplasej mbi gurët e thepisur, i tmerruar dhe i mbuluar me djersë zgjohej nga gjumi. Edhe tani ishte e njëjta gjë… pritej vetëm përplasja dhe zgjimi nga gjumi… Dhe nëna do t'i gjendej pranë duke i thënë: „ëndërr ke parë o birë?!" Pastaj, si gjithmonë, do të ulej i tmerruar në shtrat… por kësaj radhe, në krahasim me herët e tjera, asnjëra nuk po ndodhte! E rëna vazhdoi dhe… trupi ju përplas mbi gurët e thepisur. E ndjeu çarjen e mishit dhe kërkëllimën e kockave gjatë thyerjes dhe, si i venitur, nga larg i erdhi refrenin e këngës së vajzave „o-i-i-a-o!" Pastaj bota rreth e qark u shurdhua. Kaltërsia e qiellit u nxi duke i rënë sipëri si plaf i zi!

Mars, 2005

FUND

Muharrem BLAKAJ u lind më 6 janar 1959 në fshatin Vrellë, komuna e Burimit. Shkollën fillore mbaroi në vendlindje, ndërsa të mesmen ekonomike, tri vite në Pejë, e vitin e katërt, maturën, e përfundoi në Burim në pranverën e vitit 1979. Po në atë vit regjistroi Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, degën gjuhë dhe letërsi shqipe, mirëpo ai, për shkak të veprimtarisë patriotike më, 14 dhjetor 1979 burgoset dhe kështu i ndërpriten studimet.

Në nëntor të vitit 1986, në burg, me tortura, UDB-ja ia vret vëllain Xhemailin, të cilin e kishin burgosur edhe ate për veprimtari politike.

Më 5 shkurt 1987, M. Blakajn përsëri e burgosin, por në mungesë të provave e lirojnë pas tre muajsh. Nga ndjekjet edhe persekutimet e vazhdueshme, në tetor të atij viti detyrohet ta lëshoj Kosovën dhe të kërkoj strehim politik në Zvicër, ku edhe sot jeton bashkë me familjen e tij.

M. Blakaj, shkruan prozë. Sa ishte në Kosovë mblodhi tregimet e tij në një dorëshkrim me titull „Monolog i një komiti“, si dhe dy novela, gjithashtu në dorëshkrim „Balta me gjak“ dhe „Besa“ me qëllim botimi. Mirëpo, gjatë bastisjeve të policisë në shtëpinë e tij, të gjitha dorëshkrimet i merren dhe nuk i kthehen kurrë më.

Në shtypin shqiptar të diasporës në Zvicër, ka publikuar disa tegime, ndërsa në vitin 2004, botoi romanin „Misioni seket“, në shtëpinë botuese „Rozafa“, Prishtinë.

«Thesaret e humbura» është romani i tij i dytë.